

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE  
BGJSK**

**VRHOVNI SUD KOSOVA  
BILTEN SUDSKE PRAKSE  
BVSK**

**Vëllimi/Izdanje**

**2**

**2015**

BOTUES

## Gjykata Supreme e Kosovës

KËSHILLI BOTUES

KRYEREDAKTORE:

Nesrin Lushta

ZËVENDËSKRYEREDAKTOR DHE REDAKTOR PËRGJEGJËS PËR TË DREJTËN PENALE:

Avdi Dinaj

REDAKTOR PËRGJEGJËS PËR TË DREJTËN CIVILE:

Erdogan Haxhibeqiri

REDAKTOR PËRGJEGJËS PËR TË DREJTËN ADMINISTRATIVE:

Nebojša Boričić

BASHKËPUNËTORE NË REDAKTIM:

Minire Xhambazi

SEKRETARE E REDAKSISË:

Ajna Gashi

REDAKTIMI TEKNIK:

LexLibri PRESS

PËRKTHYES:

“Lingua”

DIZAJNI DHE FAQOSJA:

Edib Agagjyshi

SHTYPI:

Adnan Rezniqui Co.

Publikimi i këtij Buletini u bë i mundur me mbështetjen financiare të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) Misioni në Kosovë. Misioni i OSBE-së në Kosovë nuk është përgjegjës për përmbajtjen.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në një sistem deponimi ose të transmetohet nga çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose ndryshe, në tërësi a pjesërisht, pa lejen me shkrim të Gjykatës Supreme të Kosovës

Përmban referenca dhe indeksa

Citim: BGJSK 2 (2015)

ISBN 978-9951-634-05-2

Katalogimi në botim - (CIP)

Bibiloteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

© 2015 Gjykata Supreme e Kosovës

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE**

**BGJSK**

**Vëllimi 2  
2015**



## **PËRMBAJTJA**

Shkurtesat	6
Parathënia e redaksisë	7
<b>Mendimet juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës</b>	<b>9</b>
<b>Praktika gjyqësore penale</b>	<b>39</b>
I.    Procedurë Penale	41
II.   Kodi Penal	58
III.  Drejtësia për të mitur	70
<b>Praktika gjyqësore e EULEX-it</b>	<b>75</b>
I.    Procedurë penale	77
II.   Kodi Penal	81
<b>Praktika gjyqësore civile</b>	<b>89</b>
I.    Procedurë kontestimore	91
II.   Marrëdhëniet e detyrimeve	96
III.  E drejta e punës	105
IV.   E drejta familjare	116
V.    E drejta ekonomike	125
VI.   E drejta pronësore	127
VII.  E drejta administrative	139
Indeksi sipas neneve	154
Indeksi i fjaleve kyçe	157

## SHKURTESAT

<b>KDAK -</b>	Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës
<b>KPDM -</b>	Kodi i drejtësisë për të mitur
<b>KPPRK -</b>	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
<b>KPPPK -</b>	Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës
<b>KPPK -</b>	Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës
<b>KPRK -</b>	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
<b>LPK -</b>	Ligji Penal i Kosovës
<b>LESP -</b>	Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale
<b>LFK -</b>	Ligji për Familjen i Kosovës
<b>LMD -</b>	Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve
<b>LMTHJP -</b>	Ligji për Marrëdhëniet Themelore Juridiko pronësore
<b>LPK -</b>	Ligji për Procedurën Kontestimore
<b>LKA -</b>	Ligji mbi Konfliktet Administrative

## PARATHËNIE

Të nderuar lexues më poshtë është një përshkrim i shkurtër i përmbajtjes së buletinit dhe se si të përdoret ai.

Buletini i Gjykatës Supreme do të botohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe si në vëllimin e parë të buletinit.

Sikur në Buletinin e parë bordi editorial i Gjykatës Supreme ka bërë edhe përzgjedhjen e Qëndrimeve Juridike të marra nga Mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Bordi Editorial i Gjykatës Supreme ka bërë seleksionimin e rasteve penale, civile dhe administrative të nxjerra nga Gjykata Supreme në vitin 2014 duke përfshirë edhe disa raste deri më mars 2015.

Çdo vendim i buletinit është edituar dhe standardizuar sipas politikave redaktuese të Bordit Editorial të Gjykatës Supreme. Është vendosur që ndarja e vendimeve të bëhet në mënyrë proporcionale për të tri fushat, përafërsisht 20 raste për çdo fushë për vëllim.

Për këtë vëllim të dytë janë përmbledhur gjithsej 50 vendime prej të cilave 19 janë vendime penale, 26 vendime civile dhe 5 vendime administrative.

Rastet e përzgjedhura janë të prezentuara nga fushat e së drejtës penale, civile dhe administrative. Brenda çdo fushe, rastet janë të ndara në nënkategori, e drejta penale e ndarë në të drejten penale materiale dhe në të drejtën penale procedurale dhe pastaj në të drejtën civile: çështjet familjare, pronësore ...) të cilat janë të sistemuara në mënyrë kronologjike.

Çdo vendim i buletinit është edituar dhe standardizuar sipas politikave redaktuese të Bordit Editorial të Gjykatës Supreme, në veçanti emrat e palëve të përfshira nuk janë cekur dhe janë përdorur vetëm inicialet.

Në çdo vëllim të buletinit është përgatitur përmbajtja dhe indekset, të cilat përpos fjalëve kyçe dhe numrit të vendimeve përmbajnë edhe referencën e neneve të ligjeve që u janë adresuar. Këto indekse janë

përgatitur si mjet plotësues kërkimor për shfrytëzuesit e Buletinit. Vendimet e Gjykatës Supreme, të cilat janë të paraqitura në Buletin, janë të përmbledhura sipas strukturës në vijim:

A) “Referenca Identifikuese” e vendimit e cila përmban emrin e juridiksionit, vendndodhjen, datën kur vendimi është dorëzuar. Kjo referencë është pjesë përbërëse e vendimeve dhe gjindet në fund të çdo vendimi.

B) “Njoftimi” i cili gjindet në fillim të vendimit, ku renditen të gjitha pyetjet, të shqyrtuara nga gjyqtari dhe të konceptuara në funksionin e çështjes ligjore në të cilën ato shtrohen.

Njoftimi është një zinxhir i fjalëve të shkruara në një mënyrë duke shprehur një gradim dhe duke shkuar nga e përgjithshme (fusha e ligjit, institucionit) në të veçantën (fakt, akt apo koncept juridik).

Qëllimi i përfshirjes së njoftimit është i dyfishtë. Së pari njoftimi do t’i mundësojë lexuesit një shikim të shpejtë në çështjet ligjore për t’iu qasur vendimit. Së dyti njoftimi përmbanë fjalët kyçe, sipas së cilës vendimi është i rregulluar alfabetikisht në tabelën e përmbajtjes ose fjalët kyçe të indeksit në buletin.

C) “Çështja e Gjykuar” e vendimit është një përmbledhje e shkurtër e zgjidhjeve që janë marrë nga gjyqtari për çështjen që ai/ajo e ka zgjedhur. Përmbledhja është vendosur menjëherë pas njoftimit.

Ky vëllim, ndërsa ka përfituar shumë nga përvoja e botimit të mëparshme të Buletinit të Gjykatës Supreme, është një përpjekje, e cilat duhet me siguri edhe të përmirësohet duke marrë në konsideratë dy pika të domosdoshme

- të nxjerrë në pah diversitetin dhe pasurinë e praktikës gjyqësore;
- të mundësojë një qasje të lehtë dhe sistematike.

Të gjitha këto përpjekje për të mbledhur, pasuruar dhe mundësuar një qasje në jurisprudencë duhet të ndihmojnë për të përmirësuar qëndrueshmërinë dhe unifikimin e praktikës gjyqësore.



**Mendimet juridike  
të Gjykatës Supreme të Kosovës**



GJA-SU-A. nr. 85-2/2014

Datë 14.12.2014

**Si duhet të veprohet nëse procedura është filluar nga paditësi subsidiar, para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale**

*Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat, më 14.02.2014 një zërit miratoi këtë:*

**Mendim juridik**

**Çështjet e ngritura me padi subsidiare, para hyrjes në fuqi të KP-PRK, duhet të trajtohen dhe procedohen në frymën e nenit 543 par. 1 të KPPRK- nga departamenti i përgjithshëm, pavarësisht se në cilin departament sipas nenit 22 të KPPRK, tani bie vepra penale e cila është ngritur me padi subsidiare.**

**Arsyetim**

Kësaj Gjykate nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda i është adresuar një kërkesë, për të dhënë një mendim juridik, lidhur më çështjet e iniciuara sipas paditësit subsidiar, para hyrjes në fuqi të KPPRK.

Çështja e shtruar në kërkesë është kjo:

Kush duhet të vendosë për çështjet penale që janë iniciuar nga paditësi subsidiar para hyrjes në fuqi të KPPRK, për veprat penale, për të cilat tani sipas nenit 22 të KPPRK, kompetent është Departamenti për Krime të Rënda?

Në situatën konkrete çështjet duhet proceduar nga departamenti i përgjithshëm e jo nga Departamenti për Krime të rënda.

Çështja e ngritur qartë është zgjidhur me dispozita kalimtare, ku në nenin 543 par.1 të KPPRK, shprehimisht thuhet “Për veprat penale që janë iniciuar sipas padisë private apo subsidiare, procedura e tillë vazhdon në kuadër të departamentit të përgjithshëm të gjykatës themelore”.

Norma ligjore nuk ka thënë se çështjet zgjidhen në departamentin kompetent për të gjykuar çështjen varësisht nga vepra penale, por në mënyrë eksplicite është përcaktuar departamenti i përgjithshëm.



*GJA-SU-A. nr. 176/2014*

*Datë 23.04.2014*

**Sa duhet të jetë vlera e shumës doganore, të cilën kryesi është shmangur ta paguaj, për tu konsideruar se është konsumuar vepra penale nga neni 318 të KPK-s**

*Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat, më 23.04.2014, me shumicë votash miratoi këtë:*

### **Mendim juridik**

**Vepra penale nga neni 318 par. 1 të KPRK, konsumohet vetëm po qe se shuma e detyrimeve doganore, me të cilat kryesi i është shmangur të paguaj, kalon shumën prej 5000 €.**

### **Arsyetim**

Drejtori i Doganave të Republikës së Kosovës i është drejtuar Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, me kërkesë për Mendim Juridik, në lidhje me veprën penale nga neni 318 të KPRK.

Sipas parashtruesit të kërkesës dilema qëndron në atë se a konsiderohet vepër penale çdo abuzim me dispozitën e nenit 318 të KPRK, apo vetëm ato veprime kur shuma e detyrimeve doganore me të cilat kryesi i është shmangur të paguaj, kalon shumë prej 5000 €.

Kur është miratuar Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës, veprimet e njëjta të kundërligjshme në segmentin e doganës që janë sanksionuar si kundërvajtje administrative doganore, njëkohësisht janë sanksionuar edhe si vepër penale (shih nenin 274 dhe nenin 298), pa vënë ndonjë limit në aspektin monetar. Kështu siç është ndërtuar ligji veprimet e njëjta janë edhe kundërvajtje edhe vepër penale.

Në situatat e tilla duke u nisur nga standardi se norma interpretohet në favor të të pandehurit, kurrë s’do mund të aplikohet dispozita që veprimet e njëjta që i ka sanksionuar si kundërvajtje i konsideron edhe vepër penale.

Tani me aprovimin e KPRK, veprat penale që ishin të parashikuara në Kodin Doganor dhe i Akcizave të Kosovës që ishte emërtuar si shmangie mashtruese nga taksa e importit dhe akciza është bartur në këtë Kod, neni 318 e emërtuar si: “Shmangia nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore”, fatkeqësisht edhe me këtë kod nuk është vënë ndonjë kriter diferencues i cili do i përcaktonte qartë se: kur veprimet e kundërligjshme janë kundërvajtje; e kur vepër penale, dmth akoma veprimet e njëjta që sipas Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës konsiderohen kundërvajtje administrative doganore neni 276, njëkohësisht konsiderohen edhe vepra penale sipas nenit 318 të KPRK.

Neni 8 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës Nr. 03/L-109, shprehet:

“Në rastet e parashikuara me nenin 273 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (kontrabandimi me mallra, tani 317), kur shuma e detyrimeve doganore të mallrave të importuara apo të eksportuara ilegalisht nuk e kalon shumë prej pesëmijë (5.000) Euro në vend të dënimit penal do të aplikohet gjyba administrative. Gjyba adminis-

trative do të konsiston në gjobë në të holla prej dyfishin e shumës së detyrimeve deri dhjetëfishin e detyrimeve, gjobë e cila do t'i jepet personit përgjegjës (kryesit) nga zyra përkatëse doganore”.

Neni 8 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës Nr. 03/L-109, abuzime doganore deri në 5000 € nuk i ka konsideruar vepra penale, nga neni 273 të KPPK, por delikte administrative.

Përkundër faktit se neni 8 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës Nr. 03/L-109, i referohet vetëm neni 273 të ish KPPK (ngase veprat tjera penale nga fusha e doganave, ishin të parapara në Kodin e Doganave dhe Akcizave) qëllimi i ligjdhënësit ka qenë që jo çdo shmangie nga pagesat e tarifave të detyrueshme doganore (abuzime me obligimet doganore) të konsiderohet vepër penale, por vetëm ato veprime, kur shumata e detyrimeve doganore me të cilat kryesi i është shmangur të paguaj, kalon shumën prej 5000 €.

Të ndodhur para një situate të tillë, kur ligji nuk ka vënë limite se kur një veprim në segmentin e doganave konsiderohet kundërvajtje dhe kur vepër penale, si dhe bazuar në faktin se Seanca e përgjithshme e kësaj Gjykate, ka marr qëndrim juridik përkitazi me nenin 317 “Kontrabandimi i mallrave”, është imponuar nevoja që të sqarohet situata edhe përkitazi me nenin 318, ngase si neni 317 edhe ai nga neni 318, të KPRK, kanë genus të njëjtë.

Me këtë mendim juridik tërhiqet paralele në mes të veprimeve abuzive doganore që paraqesin kundërvajtje administrative doganore dhe veprimeve që konsiderohen vepër penale, (ngase veprimet e njëjta abuzive që konsiderohen si vepër penale nga neni 418 të KPRK, konsiderohen edhe kundërvajtje doganore, sipas neni 276 germa k dhe l të KDAK), do evitohen paqartësitë, me rastin e zbatimit të ligjit; se një veprim duhet cilësuar kundërvajtje doganore apo vepër penale por edhe i shmangë situatat absurde, që për çdo paligjshmëri në sferën e doganave kur vlera e obligimeve të shmangura është e papërfillshme- shumë e vogël, të iniciohet procedurë penale.

GJA-SU-A. nr. 176/2014

Datë 23.04.2014

## **Kontrollimi dhe kalibrimi i njësorit elektrik, kur dyshohet se është abuzuar me energjinë elektrike**

*Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat, më 23.04.2014, me shumicë votash miratoi këtë:*

### **Mendim juridik**

**Për kontrollimin e njësorit elektrik, marrjen e tij, dërgimi në kontrollim dhe kalibrim, nuk është i nevojshme urdhri i gjykatës.**

### **Arsyetim**

Kompania KEDS i është drejtuar Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, me kërkesë për Mendim Juridik, në lidhje me atë se: a është i domosdoshme urdhëri i gjykatës për marrjen e njësorit elektrik dhe dërgimin e tij në kalibrimi në Laboratorin e Qendrës së Kalibrimit në Prishtinë?

Nga kërkesa e kompanisë rezulton se në disa gjykata kontrollimi i njësorit nga kompetentët e KEDS-it dhe kalibrimi i tij nga Laboratori i Qendrës së Kalibrimit në Prishtinë, po shpallet provë e pa pranueshme.

KPPRK në nenin 257 paragrafi 2 shprehet: “provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozitat tjera të ligjit shprehimisht parashohin kështu”.

Rrjedhimisht, në përputhje me zgjidhjet ligjore të adresuara në Kodin e Procedurës Penale, shprehimisht konsiderohen të papranueshme këto prova:

1. Deklarimi i të pandehurit në rastet kur atij i janë shkelur të drejtat e garantuara (përdorimi i gjuhës, e drejta që të heshtë, përkthimi falas, e drejta e mbrojtjes përmes mbrojtësit, e drejta në trajtim mjekësor etj.) dhe kur deklarimi i tij është rrjedhojë e keqtrajtimit, kanosjes, e premtimit të ndonjë përfitimi të paparaparë me ligj, e dobësimi të kujtesës ose aftësisë për të kuptuar etj.;
2. Kur dëshmia e dëshmitarit është marrë me forcë, me kanosje apo ndonjë mjet tjetër të ngjashëm të ndaluar me legjislacionin procedural penal;
3. Deklarimi i ekspertit në rastet kur ai sipas ligjit nuk mund të caktohet si ekspert;
4. Këqyrja ose rikonstrukcioni i vendit të ngjarjes të ushtruar nga prokurori i shtetit ose policia kur i pandehuri ose mbrojtësi i tij nuk janë njoftuar për ndërmarrjen e veprimit të tillë;
5. Kontrolli i personit, shtëpisë ose lokaleve tjera i zbatuar në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale (pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake, zbatimi i kontrollit në kundërshtim me urdhrin e zbatuar etj.) dhe
6. Prova është marrë nëpërmjet masës së fshehtë dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit e mbështetur në urdhër të paligjshëm.

Së këndejmi, konform paragrafit 4 të nenit 257 të Kodit të Procedurës Penale, ligjdhënësi ka ndaluar çdo marrje në pyetje përmes të cilës:

- 4.1 Liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit;
- 4.2 I pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj;
- 4.3 Premtohet ndonjë përfitim që nuk parashihet me ligj dhe
- 4.4 Dobësohet kujtesa e të pandehurit ose aftësia e tij për të kuptuar.



Sipas nenit 32 të Ligjit për Energjinë Elektrike nr. 3/L-201, rezulton se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, përkatësisht KEDS, ka në pronësi pajisjen matëse -njësorin.

Laboratori i Qendrës së Kalibrimit, është Laborator i cili konform nenit 30 par. 2 të Ligjit për Metrologji nr. 3/L-203 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 2006/23, është licencuar nga Ministria e Tregtisë, me vendimin datë 21.09.2012 dhe ky laborator ligjërisht mbanë të drejtën e testimit, përgatitjes dhe servisimit të njësorëve.

Marrja e njësorit nga shtëpia e të pandehurit dhe dërgimi i tij në kalibrim nuk ka të bëjë me asnjërën nga provat që u paraqitën më lart e të cilat ligji shprehimisht i konsideron të pa pranueshme (jo çdo provë e cila është marr në kundërshtim me dispozitat ligjore konsiderohet e pa pranueshme). Në rastin konkret nuk bëhet fjalë për ekspertizë (ekspertizën dihet kush e urdhëron) por për një provë materiale saktësia, e të cilës do provohet në shqyrtim gjyqësore, sipas mjeteve provuese të përcaktuara me ligj dhe nëse gjatë procedimit të çështjes në gjykatë, paraqiten dyshime për saktësinë e kësaj prove materiale, atëherë mund të urdhërohet ekspertiza nga një ekspert -institucion i pavarur.

Meqenëse KEDS, sipas ligjit është pronar i çdo njësor matës të energjisë elektrike, atij nuk i nevojitet asnjë urdhër për ta ushtruar mandatin e saj sipas ligjit për ta kontrolluar njësorin e vet e eventualisht edhe për ta dërguar në testim -kalibrim.



*GJA-SU-A. nr. 176/2014*

*Datë 23.04.2014*

**Si regjistrohen çështjet penale te bashkim veprash penale, kur njëra bi në Kompetence të departamentit të përgjithshëm, ndërsa tjetra në competence të Departamentit për të mitur**

*Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë nga EULEX-i,*

*në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat, më 23.04.2014, me shumicë votash miratoi këtë:*

## **Mendim juridik**

**Në situatën kur i pandehuri akuzohet për dy vepra penale, nga të cilat njëra bie në kompetencë të departamentit për të mitur ndërsa tjetra në departamentin për madhor, çështja që ka të bëjë me veprën penale që sipas ligjit e gjykon trupi gjykues për të mitur, regjistrohet në departamentin për të mitur, ndërsa çështja që ka të bëjë me veprën penale që nuk bie në grupin e veprave penale nga neni 145 të KPDM, regjistrohet në departamentin përkatës, varësisht nga vepra penale.**

## **Arsyetim**

Gjykata Themelore në Mitrovicë - i është drejtuar Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, me kërkesë për dhënien e Mendimit Juridik, në lidhje me aktakuzën e ngritur kundër një të pandehuri për dy vepra penale, përkatësisht veprën penale nga neni 145 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur - “keqtrajtim apo braktisje e fëmijës” dhe “vepra penale privim i kundërligjshëm nga liria” ku i dëmtuari është i mitur, e cila nuk hynë në grupin e veprave penale të parapara me nenin e sipërpërmendur të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Sipas parashtruesit të kërkesës, dilema qëndron në atë se cili departament është kompetentë për të gjykuar, pasi që kemi dy vepra penale, një që bie në kompetencën e departamentit për të mitur sipas veprës penale nga neni 145 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur, dhe vepra tjetër “Privim i Kundërligjshëm nga Liria” që nuk hynë në grupin e veprave të parapara me nenin 145 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Në situata të tilla prokurori publik, do duhej t’i paraqes në gjykatë dy çështje të ndara dhe ato çështje më pastaj nëse gjykata e gjen oportune do ketë mundësi ligjërisht t’i bashkoj, megjithatë nëse prokurori publik ka paraqitur një akt akuzues me dy vepra penale që sipas ligjit

nuk gjykohen nga i njëjti Trup Gjykues, atëherë gjykata duhet t'i formoj dy lëndë të ndara (dy çështje) dhe t'i regjistroj në departamentet kompetente.

Nëse çështja për të dy veprat penale gjykohet nga trupi gjykues për të mitur apo nga trupi gjykues për madhor, do bëhej fjalë për shkelje esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës “përbërje jo e rregullt e trupit gjykues”, me përjashtim nëse janë aplikuar dispozitat për bashkimin e lëndëve-çështjeve sipas dispozitave të KPPRK apo dispozitave të KPDM.



*GJA-SU-A. nr. 176/2014*

*Datë 23.04.2014*

- I. Sa duhet të jetë vlera e tregëtuar e mallrave pa leje, për tu konsideruar se është konsumuar vepra penale, nga neni 305?**  
**II. Deri kur i dëmtuari mund të tërhiqet nga propozimi?**  
**III. A ka të drejtë gjykata ta adresoj çështjen në ndërmjësime? dhe,**  
**IV. Kush i nënshtrohet sekuestrimit të plërkohshëm?**

*Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat, më 23.04.2014, me shumicë votash miratoi këtë:*

### **Mendim juridik**

- I. Vepra nga neni 305 të KPRK, konsumohet, vetëm nëse vlera e mallrave që tregtohet pa leje përkatëse është mbi 5000 €.**
- II. I dëmtuari mund të tërhiqet nga propozimi për ndjekje penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Në situatën e tillë, pa-varësisht asaj se prokurori shtetëror e tërheq apo jo aktin akuzues, merret aktgjykim refuzues.**

**III. Gjykata ka të drejtë që çështjen ta adresoj në ndërmjetësim, pasi që akti akuzues është dorëzuar në gjykatë edhe pa pëlqimin e prokurorit.**

**IV. Sekuestrimit të përkohshëm i nënshtrohen sendet dhe pasuria që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale.**

### **Arsyetim**

I. Gjykata themelore në Mitrovicë, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Supreme për të dhënë një mendim juridik në çështjet si më poshtë:

Në kodin Penal të Republikës së Kosovës është inkriminuar vepra penale “Tregtia e ndaluar në nenin 305 me këtë përmbajtje:

1. Kushdo që pa autorizim shet, blen apo bën shkëmbimin e mallrave sendeve apo shërbimeve, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Kur kryesi i veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni ka organizuar rrjetin e shitësve ose të ndërmjetësve apo ka realizuar përfitim që kalon shumë prej pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

3. Mallrat dhe sendet nga tregtia e ndaluar konfiskohen”. Po ashtu në Kosovë është në fuqi ligji i veçant për tregtinë e brendshme Nr.2004/18, I cili ligj tregtinë me mallra për çdo person fizik dhe juridik kur ajo ushtrohet pa regjistrim apo në vendet jo të përcaktuara e inkriminon si vepër kundërvajtëse.

Kjo pasi që nuk ka aspekt përcaktues të ndonjë element konkret që do të bënte që gjykata të mund të vendosë se kur do të kishim vepër penale dhe kur do të kishim kundërvajtje, po ashtu duke marrë parasysh nenin 3 të KPRK Zbatimi i Ligjit me të favorshëm.

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës është inkriminuar vepra penale Shmangia mashtruese nga detyrimet doganore neni 318 që parashihet: Kushdo që me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i mundësojë shmangien nga pagesa e tarifave tatimore doganore apo tarifave tjera

ose detyrimeve doganore që paguhen me rastin e importimit apo eksportimit të mallrave, ose nëse doganës i paraqet dokument të rrejshëm lidhur me prejardhjen, vlerën, sasinë, cilësinë, llojin apo karakteristikat tjera të mallit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. 2. Nëse vlera e pagesës së shmangur nga paragrafi 1 i këtij neni tejkalon pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim deri në pesë (5) vjet. 3. Nëse vlera e pagesës së shmangur nga paragrafi 1. i këtij neni tejkalon tridhjetëmijë (30.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. 4. Mallrat të cilat nuk janë deklaruar saktë apo vlera e pagesës së shmangur, cilado që të jetë më e lartë, konfiskohen. Ndërsa po ashtu elementet e kësaj vepre penale janë të njëjta në Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës ku konsiderohet Kundërvajtje doganore, e paraparë kjo në nenin 276.

II. Në disa vepra penale të parapara në Kodin penal të Republikës së Kosovës, është paraparë që ato vepra penale ndiqen sipas propozimit të të dëmtuarit. Dilemat janë paraqitur në këtë çështje se a i lejohet të dëmtuarit që të tërhiqet nga ndjekja penale dhe po që se i lejohet a nënkupton kjo se Prokurori i shtetit detyrimisht duhet të tërhiqet nga ndjekja penale, pasi që në praktikë ka raste kur edhe pse i dëmtuari tërhiqet nga propozimi, Prokurori i shtetit nuk tërhiqet nga ndjekja. Në Kodin e Procedurës penale nuk ka ndonjë dispozitë decidive që lejon të dëmtuarin që të tërhiqet nga propozimi, me përjashtim të nenit 454 ku parashihet se “I dëmtuari i cili është tërhequr nga propozimi për ndjekje penale dhe si rrjedhojë e kësaj procedura pushon, detyrohet t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale nëse i pandehuri nuk ka paralajmëruar se do t’i paguajë ato” a nënkupton kjo dispozitë se i dëmtuari në momentin kur tërhiqet nga propozimi për ndjekje edhe prokurori më nuk ka propozim për ndjekje nga i dëmtuari, dhe në rast se të dëmtuarit i lejohet tërheqja nga propozimi a ka ndonjë afat kohor?

III. Në neni 232 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës është paraparë procedura e ndërmjetësimit, ku prokurorit i është dhënë kompetenca që kallëzimin penal mund ta dërgojë në procedurën e ndërmjetësimit për veprat penale që janë të dënueshëm me gjobë apo me burgim deri në 3 vjet, mirëpo Kodi i procedurës penale

nuk ka paraparë kompetencën e tillë që gjykata në procedurë penale ta dërgojë çështjen penale në procedurën të ndërmjetësimit. Ndërsa Ligji për ndërmjetësim në nenin 9 paragrafi 6 parasheh se gjykata mundet në secilën fazë të procedurës gjyqësore, deri në përfundimin e saj, t'i sugjeroj palët në procedurën e ndërmjetësimit. Ky pra është ligj special që i jap mundësin Gjykatës që të delegojë kompetencën në procedurë e ndërmjetësimit.

A ka të drejtë gjykata që në mbështetje të dispozitës së Ligjit për ndërmjetësim kur i dëmtuari dhe i pandehuri japin pëlqimin që çështja të zgjidhet në procedurën e ndërmjetësimit ta dërgoj atë çështjen penale edhe pse nuk ekziston një kompetencë e tillë sipas Kodit të Procedurës Penale që gjykata ta dërgojë çështjen penale në procedurë ndërmjetësimi? Nëse gjykatës i lejohet që çështja të dërgohet në procedurën e ndërmjetësimit, a duhet të merret edhe pëlqimi i prokurorit të shtetit apo vetëm pëlqimi i të dëmtuarit dhe të pandehurit.

IV. Duke pasur parasysh formulimin e dispozitës së nenit 112 të KPP-ës par. 1 e cila ka këtë formulim: “sendet që përkohësisht mund të sekuestrohen janë sende që mund të jenë prova gjatë një procedure penale, sende ose pasuri që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose sende që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale dhe për të cilat ligji parasheh sekuestrimin”. Nuk ka dilemë për sa ju përket provave dhe sendeve që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale, kjo pasi që për provat kodi i procedurës penale i parasheh se sendet që shërbejnë si provë mund të sekuestrohen, po ashtu kodi penal në nenin 96 parasheh konfiskimin e dobisë pasurore.

Dilema për gjykatën ka ekzistuar dhe ekziston për sa i përket sendeve ose pasurisë që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, kjo pasi që në praktikë gjykata formulimin e dispozitës nga neni 112 par.1 pasuesi i fundit “për të cilat ligji parasheh sekuestrimin” nuk ka dispozitë të përgjithshme në Kodin penal që gjykata duhet në çdo rast të sekuestroj sendet që kanë shërbye apo kanë mundësuar kryerjen e veprës penale, përveç se dispozita nga neni 69 ku parashihet dënimi plotësues “Marrja e sendit” dhe gjykata në procedurën paraprake gjer më tani e ka bazuar vendimin për sekuestrim të përkohshëm në nenin 69 në dispozitat materiale.

I. Sa i përket veprës penale tregtia e ndaluar, të parashikuar nga neni 305 të KPRK, patjetër duhet limituar shuma e mallrave të tregtuara pa leje, përndryshe kjo dispozitë nuk do mund të aplikohet në asnjë variant, bazuar në faktin se veprimet e njëjta njëkohësisht konsiderohen edhe kundërvajtje, ashtu që në situatën e tillë do duhej zbatuar vetëm ligji që këto veprim i konsideron kundërvajtje si ligj më i favorshëm për të pandehurin.

Neni 8 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës Nr. 03/L-109, shprehet:

“Në rastet e parashikuara me nenin 273 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tani neni 305 i KPRK), kur shuma e detyrimeve doganore të mallrave të importuara apo të eksportuara ilegalisht nuk e kalon shumën prej pesëmijë (5.000) Euro në vend të dënimit penal do të aplikohet gjoha administrative.

Me nenin 273 i ish KPPK, vetëm emërtimi i veprës penale ka qenë kontrabandimi me mallra, ndërsa përshkrimi i veprës penale s’ka qenë fare kombatabël me emërtimin, por me veprën penale tregtia e ndaluar, siç është emërtuar tani me nenin 305 i njëjti përshkrim.

Me ligjin penal të Kosovës (LPK), këtë veprë penale e konsumonte vetëm ai i cili bënte tregti me vlerë ose sasi të madhe, ndërsa Gjykata Supreme me qëndrim parimor përcaktonte se kur konsiderohet sasi-vlerë e madhe dhe çdo tregti e palejuar jo me vlerë-sasi të madhe konsiderohej kundërvajtje.

II. Sipas Kodit Penal të Kosovës, për disa vepra penale ligdhënësi ka lënë në vullnetin e të dëmtuarit se don apo jo të ndërmerret ndjekje, dmth vepra penale ndiqet oficalisht, por iniciativa duhet të vij nga i dëmtuari. Meqenëse Ligji nuk ka limituar kohën se deri në cilën fazë të procedurës penale i dëmtuari mund të tërhiqet nga propozimi për ndjekje penale, ai mund të tërhiqet gjatë gjithë procedurës, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë (deri në fjalën përfundimtare). Në situatën kur i dëmtuari tërhiqet nga propozimi në shqyrtimin gjyqësor edhe nëse prokurori publik nuk e tërheq aktakuzën,

gjykata përkundër faktit se këtë nuk e thotë neni 363 i KPRK-s, duhet të marr aktgjykim refuzues duke u thirr në këtë dispozitë, ngase çështja në shqyrtim gjyqësor përfundon vetëm me aktgjykim, me përjashtim kur kemi të bëjmë me vdekjen e të pandehurit, çështja përfundon me aktvendim.

III. Gjykata ka të drejtë çështjen ta adresoj në ndërmjetësuese, kur plotësohen kushtet ligjore edhe pa pëlqimin e prokurorit të shtetit, mirëpo ka për obligim, ta informoj atë për këtë adresim. Këtë e parashihet dispozita e nenit 9 par. 6 e Ligjit për Ndërmjetësim, i cili ligj është special në raport me KPPRK, ngase ky ligj e rregullon çështjen e ndërmjetësimit në të gjitha aspektet.

IV. Me urdhër të gjykatës, përkohësisht mund të sekuestrohen edhe sendet dhe pasuria që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale. Pavarësisht se KPPRK ka përdorur shprehjen “Për të cilat ligji parashihet sekuestrimin”. Ngase me dispozitat e nenit 113 të KPPRK, taksativisht janë përcaktuar sendet që nuk mund ti nënshtrohen sekuestrimit të përkohshëm dhe do ishte absolutisht e palogjikshme dhe në kundërshtim me qëllimin e ndërtimit të kësaj norme, që sendet apo pasuria e cila kanë mundësuar kryerjen e veprës penale të mos i nënshtrohen sekuestrimit të përkohshëm kur sekuestrimit ti nënshtrohen sendet që shërbejnë si provë në procedurë penale.



*GJA-SU-A. nr. 176/2014*

*Datë 23.04.2014*

### **Kur gjyqtari përjashtohet nga një çështje penale, nëse ka qenë i përfshirë në ndonjë fazë të procedurës**

*Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat, më 23.04.2014, me shumicë votash miratoi këtë:*



## Mendim juridik

**I. Nuk mund të jetë gjyqtar i vetëm, anëtarë i trupit gjykues, kryetar i trupit gjykues, në gjykatën e shkallës së parë, gjyqtari i cili ka caktuar-vazhduar paraburgimin.**

**II. Nuk mund të jetë anëtar i kolegjit të Gjykatës së Apelit, kur shqyrtohet ankesa lidhur me çështjen kryesore, vetëm gjyqtari i kësaj Gjykate, i cili ka qenë anëtarë apo kryetar kolegji që ka marr vendim për caktimin apo vazhdimin e paraburgimit ndaj të pandehurit, (kur gjyqtari procedurës paraprake ka refuzuar t'ia caktoj apo t'ia vazhdoj paraburgimint, mirëpo me ankesën e prokurorit të shtetit, kolegji i Gjykatës së Apelit, ia ka caktuar - vazhduar paraburgimin të pandehurit). Dmth. jo çdo vendosje lidhur me ankesën për paraburgimin e apo masat tjera alternative, përjashton gjyqtarin që në çështjen e të pandehurit të njëjtë të jetë anëtar i kolegjit në Gjykatën e Apelit.**

**III. Nuk mund të jetë anëtarë i kolegjit në Gjykatën e Apelit - Supreme, gjyqtari i cili në çështjen e njëjtë, ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në gjykatën më të ulët ose në gjykatën e njëjtë i cili atakohet me mjet juridik.**

## Arsyetim

Me emërimin gjyqtar personi i tillë fiton aftësinë absolute që të ushtroj funksionin e gjykimit. Mirëpo, posedimi i aftësisë absolute për gjykim nuk do të thotë se gjyqtari me rastin e gjykimit të një çështje konkrete do të jetë objektiv. Në të vërtetë mund të ekzistojnë raste kur ndonjë raport ekzistues (personal, pasuror, familjar etj.) ndërmjet gjyqtarit dhe çështjes penale konkrete apo kryerësit të saj të shkaktojnë dyshim të arsyeshëm në objektivitetin e gjyqtarit nëse atij i lihet zgjidhja e asaj çështje penale. Në rast të tillë ekziston paaftësia relative e gjyqtarit për ushtrimin e funksionit të gjykimit. Në të vërtetë është vështirë që gjyqtari të mbetet krejtësisht objektiv në çështjen për të cilën materialisht ose moralisht është i interesuar. Sidoqoftë, edhe sikur të ishte plotësisht objektiv, nuk është e arsyeshme që në atë rast konkret atij t'i lejohet ndarja e drejtësisë, sepse opinionioni publik dhe palët mund të dyshojnë me arsye në objektivitetin

dhe paanësinë e tij. Kjo me siguri do t'i sillte dëm prestigjit dhe autoritetit të gjykatës. Për këtë arsye e drejta e procedurës penale e njeh institutin e përjashtimit të gjyqtarit në çështjen konkrete.

Në procedurë penale ekzistojnë shkaqe të ndryshme të cilat mund të sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit, nga gjykimi. Pesha e këtyre shkaqeve është e natyrave të ndryshme.

1. I dëmtuar me vepër penale. Dëmi mund të jetë i karakterit material ose moral dhe ai zakonisht lindë nga marrëdhëniet e gjyqtarit me personin konkret i cili paraqitet në cilësi të personit të akuzuar. I tillë p.sh., mund të jetë rasti kur gjyqtari është viktimë e veprës penale të lëndimit trupor;

2. Bashkëshort, bashkëshort jashtëmartesor, person në afri gjinie në vijë të drejtë në çfarëdo shkalle ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt, person në afri krushqie deri në shkallën e dytë me të pandehurin, mbrojtësin e tij, prokurorin e shtetit, të dëmtuarin, përfaqësuesin e tij ligjor ose përfaqësuesin e autorizuar;

3. Kujdestar ligjor, nën kujdestari ligjore, fëmijë i adoptuar ose prind adoptues, prind birësues ose fëmijë i birësuar i të pandehurit, mbrojtësit të tij, prokurorit të shtetit ose të dëmtuarit.

Konform zgjidhjeve të dhëna në pikën 1 dhe 2 deri te përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi vjen për shkak të interesave të karakterit pasuror e material që lindin nga marrëdhëniet e gjyqtarit dhe të afërmve të tij me pjesëmarrësit e sipërpërmendur. Të tilla janë rastet kur p.sh., një nga palët e tilla (ta zëmë mbrojtësi) është debitor apo kreditor i tij, i bashkëshortit ose fëmijëve të tij.

Rastet që lidhen me interesin në procedim janë të qarta dhe nuk kërkojnë koment. E rëndësishme është që kur pretendohen, ato duhet të provohen dhe se të njëjtat nuk mund të përdoren për të zvarritur procedurën apo për të ushtruar presion tek gjyqtari.

4. Në çështjen e njëjtë penale ka marrë pjesë në procedurë si prokuror, mbrojtës, përfaqësues ligjor, përfaqësues i autorizuar i të dëmtuarit

ose është pyetur si dëshmitar apo ekspert. Kështu, për shembull një deputet që ka votuar për heqjen e imunitetit të një deputeti dhe më vonë bëhet gjyqtar, nuk mund të marrë pjesë në gjykimin e atij ish-deputeti për heqjen e imunitetit të të cilit ai ka votuar;

5. Ekziston konflikti i interesit siç përcaktohet në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Në këtë rast, fjala është për ekzistimin e çfarëdo rrethane që e lidh gjyqtarin me ndonjë interes konkret që ndërlidhet me çështjen penale konkrete apo edhe më gjerë.

Gjyqtari përjashtohet nga gjykimi i rastit konkret nëse duke qenë gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i Kolegjit të Apelit apo Kolegjit të Gjykatës Supreme ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal. Pavarësisht kësaj, nuk do të mund të përjashtohet nga gjykimi i rastit konkret gjyqtari që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë, si dhe gjyqtari që ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues (paragrafi 2 i nenit 39 i KPPRK).

Përveç rasteve të lartcekura gjyqtari mund të përjashtohet nga gjykimi edhe në situatat kur prezantohen dhe vërtetohen rrethana që e venë në dyshim paanshmërinë e tij, ose që duken të papërshtatshme. Një mundësi e tillë e parashikuar me nenin 39. 3 të Kodit të Procedurës Penale i cili u jep mundësi palëve që të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit në çdo rast që ato vërtetojnë qëndrime të njëanshme të tij, siç mund të jetë sjellja jo korrekte ndaj njëres palë, refuzimi i pamotivuar i kërkesave të përsëritura të saj, qëndrimi i njëanshëm në marrjen dhe verifikimin e provave etj.

Pyetja që do përgjigje nga neni 39 par. 2 të KPPRK, është: Kush i nënshtrohet përjashtimit? vetëm gjyqtari i procedurës paraprake, apo çdo gjyqtar i cili në çështjen e njëjtë ka qenë i përfshirë më herët në procedurë penale; si gjyqtar i procedurës paraprake; gjyqtar i vetëm kryetar, anëtarë i trupit gjykues; (kur çështja është anuluar dhe është kthyer në rigjykim); anëtar i kolegjit në Gjykatën e Apelit, (kur çështja

ka ardh për së dyti herë në gjykatë); anëtarë i kolegjit në Gjykatën Supreme (kur çështja ka ardh për së dyti herë në Gjykatë)?

A). Vullneti i ligdhënësit nuk ka qenë që të përjashtoj nga një proces penale, çdo gjyqtar i cili në çështjen e njëjtë penale ka marr pjesë në procedurën e mëhershme, por vetëm gjyqtari i cili në cilësinë e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtari i Gjykatës së Apelit, ka caktuar apo vazhduar paraburgimin, kur në çështjen e njëjtë ka marrë pjesë në marrjen e vendimit në gjykatën më të ulët ose në gjykatën e njëjtë i cili atakohet me mjet juridik.

B). Nga kolegj për shqyrtimin e mjetit juridik, në Gjykatën e Apelit apo atë Supreme, nuk përjashtohet gjyqtari i cili ndaj të pandehurit të njëjtë, ka marr pjesë më parë në kolegj i cili ka shqyrtuar mjetin juridik, të paraqitur kundër aktvendimit, të gjyqtarit të procedurës paraprake-kolegjit të Gjykatës së Apelit, për caktimin, vazhdimin e paraburgimit, por ai nuk ka caktuar apo vazhduar paraburgimin, (të pandehurit mund me disa vendime t'i vazhdohet paraburgimi në kuadër të limiteve ligjore dhe ndaj secilit vendim mund të paraqitet mjet juridik. Për secilin mjet juridik kundër aktvendimit për paraburgimin mund të vendosë i njëjti kolegj).

Përfundimi se nuk përjashtohet nga procesi gjyqësor, çdo gjyqtar i cili në rastin e njëjtë ka marr pjesë në procedurat e mëhershme, e mbështetet neni 398 par. 2 të KPPRK, i cili nen shprehet: " Gjykata e Apelit mund të urdhëroj që të caktoj një tjetër gjyqtar të vetëm gjykues, kryetar të trupit gjykues ose trup gjykues " mbyll citatin .dmth nga ky formulim qartë rezulton se gjyqtari apo trupi gjykues që njëherë e ka gjykuar çështjen, mund ta ketë prapë në punë çështjen e njëjtë e kjo vlen edhe për Gjykatën e Apelit dhe Supreme edhe pse neni 398 të KPPRK, i referohet gjykatës së shkallës së parë, pastaj në dispozitat e nenit 40 par. 2 pika 2 e ish KPPPK, e cila përjashtonte gjyqtarin që kishte urdhëruar paraburgimi të jetë gjyqtarë për konfirmimin e aktakuzës, dmth. nëse norma ligjore nuk lejonte që gjyqtari i cili ka urdhëruar paraburgimit, të jetë gjyqtar për konfirmimin e aktakuzës, aq më pak ai do mund të jetë kryetar i trupit gjykues, gjyqtar i vetëm apo anëtarë i trupit gjykues.

Në procedurën para ngritjes së aktakuzës, janë tre grupe gjyqtarësh edhe atë; anëtarët e kolegji shqyrtues, gjyqtari që ka zbatuar hetimin e veçantë gjyqtari i procedurës paraprake dhe kolegjet (Apelit -Supreme) që vendosin për mjetet juridike ndaj aktvendimit për paraburgimin-masat tjera alternative. Ligji shprehimisht është shprehur: “se nuk përjashtohen nga procesi gjyqësor anëtarët e panelit shqyrtues e as gjyqtari që ka qenë anëtarë i panelit të një hetimi të veçantë” që shpie në përfundim të pakontestueshëm se vetëm gjyqtari i procedurës paraprake apo anëtarët e panelit të Gjykatës së Apelit që kanë caktuar apo vazhduar paraburgimin, (por jo edhe gjyqtarët që kanë vendosur lidhur me mjetin juridike ndaj këtyre vendimeve, por nuk kanë urdhëruar paraburgimin - kanë aprovuar ankesën dhe të pandehurit i kanë hequr masën, apo kanë refuzuar ankesën dhe kanë konfirmuar vendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake).

Kjo mënyrë restriktive e interpretimit të kësaj norme (nenit 39 par.2) është bërë me qëllim të funksionimit të sistemit gjyqësore, po të interpretohej norma në mënyrë ekstenzive do vihej në pikë pyetje funksionimi i sistemit gjyqësor, duke pasur parasysh edhe faktin se tani në çështje penale nuk ka gjyqtar porotë.



*GJA-SU-A. nr. 390/2014*

*Datë 02.10.2014*

### **A ka të drejtë kundërshtimi i dëmtuari ndaj aktgjykimit për dhënine e urdhërit ndëshkimor**

*Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat, më 02.10.2014 me shumicë votash miratoi këtë:*

#### **Mendim Juridik**

**Ndaj aktgjykimit me të cilin jepet urdhëri ndëshkimor, i dëmtuari nuk ka të drejtën e kundërshtimit, për grupin e veprave penale për**

**të cilat në procedurë të rregullt mund të ushtrroj ankesë për shkak të vendimit për sanksionin penal dhe shpenzimeve të procedurës penale.**

### **Arsyetim**

Gjykatës Supreme, i është drejtuar me kërkesë Gjykata Themelore e Prishtinës, për të dhënë mendim juridik lidhur me dispozitën e nenit 496 par. 2 të KPPRK, përkatësisht lidhur me atë se a do duhej që ti jepej e drejta në kundërshtim edhe të dëmtuarit, për veprat kundër jetës dhe trupit, kundër trafikut publik dhe kundër integritetit seksual, në situatën kur me aktgjykim është dhënë urdhri ndëshkimor, duke u bazuar në dispozitat e nenit 381 par. 3 të KPPRK.

Në procedurën penale ekzistojnë tre lloje procedurash: procedura e rregullt, procedurat alternative dhe procedura e veçantë. Dhënia e urdhrorit ndëshkimor bie në procedurën e veçantë dhe sipas nenit 496 par. 2 të KPPRK, e drejta e shfrytëzimit të mjetit juridik (kundërshtimit) i është lënë ekskluzivisht vetëm të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, dmth. në situatat të tilla është devijuar nga standardi që vlen në procedurën e rregullt dhe, palëve tjera në këtë procedurë duke përfshirë edhe prokurorin e shtetit si paditës, nuk u është njohur e drejta në kundërshtim ndaj këtij aktgjykimi.

Neni 381 par. 3 i KPPRK, e rregullon çështjen e ankesës e të dëmtuarit kundër aktgjyimit për kategori të caktuar të veprave penale, e cila dispozitë atij i ka njohur të drejtën e ankesës vetëm për vendimin për shkak të sanksionit penal dhe shpenzimeve të procedurës, mirëpo neni 496 par. 2 të KPPRK, bënë fjalë për kundërshtimin e aktgjyimit që është marr në procedurë të veçantë, e jo për ankesën në procedurë të rregullt.

Në rrethanat të tilla, të dëmtuarit nuk mund t'i konstituohet një e drejtë të cilën ligji nuk ia ka njohur.



GJA-SU-A. nr. 85-3/2014

Datë 14.02.2014

## **A mundet të aplikohen dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM) ndaj madhorit të ri i cili veprën penale e ka kryer si madhor i ri?**

*Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat, më 14.02.2014, një zërit miratoi këtë:*

### **Mendim juridik**

**Ndaj madhorit të ri, i cili ka kryer vepër penale si madhor i ri, mund të aplikohet procedura sipas KPDM, nëse gjykata çmon se qëllimi që do të arrihej me shqiptimin e burgimit gjithashtu do të arrihej me shqiptimin e masës ose dënimit, duke marrë parasysh rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri dhe interesin e tij më të mirë, në të kundërtën ndaj tij aplikohen dispozitat e KPPK në të gjitha aspektet.**

### **Arsyetim**

Gjykata themelore në Mitrovicë, me parashtresë, ka kërkuar mendim juridik nga Gjykata Supreme, përkitazi me atë se; cila procedurë duhet të aplikohet dhe cilat masa, dënime mund t'i shqiptohen madhorëve të ri si kryes të veprave penale?

Paraqitësi i kërkesë i është referuar një rasti konkret, ku kryes i veprës penale të vrasjes së rëndë është personi madhor i ri i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka pas mbi 19 vjeç.

Neni 4.i KPDM i cili ka krijuar dilema në praktikë shprehet; dispozitat e këtij Kodi zbatohen ndaj secilit person të dyshuar për vepër penale të kryer si i mitur, pavarësisht nga mosha e tij në kohën e fillimit të procedurës (par. 1.).dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe

ndaj çdo personi të dyshuar për vepër penale të kryer si madhor i ri (par. 2.).

Ndaj kësaj kategorie të kryesve të veprës penale mund të aplikohen dispozitat procedurale nga KPDM, neni 4-2 KPDM, (edhe pse ligji nuk ka përdorur shprehjen mund), nëse gjykata çmon se qëllimi që do të arrihej me shqiptimin e burgimit gjithashtu do të arrihej me shqiptimin e masës ose dënimit, duke marrë parasysh rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, mendimin e ekspertit lidhur me zhvillimin psikologjik të madhorit të ri dhe interesin e tij më të mirë.

Pra, aplikimi i dispozitave nga KPDM, ndaj kësaj kategorie të kryesve është çështje diskrecionale e gjykatës e jo domosdoshmëri, edhe pse fatkeqësisht ligjdhënësi me rastin e ndërtimit të nenit 4. par. 2. të KPDM, ka lëshuar ta përdor shprehjen mund, siç e kishte më parë dispozita e nenit 3 të Ligji penal për të Mitur i Kosovës, rregullorja e Unmik-ut nr. 24/8, i cili nen në paragrafin 2. shprehet; Kur ky Ligj e parashihet, dispozitat e këtij Ligji zbatohen ndaj cilitdo person të akuzuar për vepër penale të kryer si madhor i ri e këtë mundësi ligji e kishte paraparë në neni 10.

Ligji penal i RSFJ (“Gazeta zyrtare”nr. 44/1976) këto situata i rregullonte kështu: Dispozitat e veçanta të cilat i përkasin kryesve të mitur të veprave penale aplikohen nën kushtet e parapara në dispozitat e këtij krye edhe ndaj personave madhor kur gjykohen për veprat penale të cilat i kanë kryer si të mitur, ndërsa përjashtimisht edhe ndaj personave të cilit veprën penale e kanë kryer si madhorë të rinj (neni 71. par. 2.).

Ligji i procedurës penale (“Gazeta zyrtare e RSFJ” nr. 4/1977) në nenin 452. par. 2 parashihte: Dispozitat e neneve 454. deri në 456., 459. deri në 462., 471., 473., 475. al. 1.dhe 2. dhe nenit 483. të këtij ligji që kanë të bëjnë me kryesit e mitur, aplikohen në procedurën ndaj madhorit të ri, nëse deri në fillimin e shqyrtimit kryesor vërtetohet se ndaj këtij kryesi mund të shqiptohet masa edukuese në kuptim të nenit 82. të LP RSFJ e deri në atë kohë nuk ka mbushur moshën 21 vjeçare.



Neni 11. i KPDM, ka përdorur shprehjen “ndaj kësaj kategorie të kryesve të veprës penale gjykata mund të shqiptojë masë ose dënimet në pajtim me nenin 7. të KPDM, nga ky formulim qartë rezulton se ndaj tyre mund të shqiptohen edhe dënimet nga neni 42 të KPK. Pastaj në nenin 44. par. 3. të KPK thuhet se dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të shqiptohet ndaj madhorit të ri, që shpie në përfundim se ndaj tij mund të shqiptohet burgimi.

Të gjitha këto fakte që u shtruan më lartë , qojnë në përfundim të pakontestueshëm, se ndaj madhorit të ri, për veprat penale të kryera si madhor i ri, parimisht aplikohen dispozitat e KPPK, aplikimi i dispozitave të KPDM, ndaj kësaj kategorie, të kryesve të veprave penale , është çështje diskrecionale e gjykatës e jo domosdoshmëri (përkundër nenit 4. të KPDM).



*GJA-SU-A. nr. 389/14*

*Datë 02.10.2014*

**Gjykata kompetente për ekzekutimin e dënimit me gjobë i cili është shqiptuar së bashku me dënimin me burgim dhe për ekzekutimin e dënimit me gjobë të zëvendësuar me dënimin me burgim, kur nuk është shlyer në tërësi dënimi i shqiptuar me gjobë**

*Mbledhja e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilin ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë të EULEX-it, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat, më 02.10.2014 miratoj këtë:*

### **Mendim juridik**

**I. Dënimin e shqiptuar me gjobë, qoftë si dënimë vetëm apo si dënim alternativ, së bashku me dënimin me burgim, duhet ta ekzekutoj gjykata që e ka shqiptuar atë, dmth nëse gjykata në dispozitivin e aktgjykimit të akuzuarit sa i përket dënimit me gjobë i ka lënë vetëm një alternativ: “Atë të zëvendësimit të dënimit me gjobë me dënim me burgim nëse gjyba nuk paguhet në afatin e lënë”,**

**atëherë vendimin për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim duhet ta marr gjykata e cila ka shqiptuar dënimin me gjobë edhe atë pa tentuar fare që paraprakisht të bëjë përmbarimin e dhunshëm.**

**II. Nëse me dënimin e zëvendësuar me burgim, nuk është shlyer në tërësi dënimi i shqiptuar me gjobë, atëherë çështja i dërgohet gjykatës kompetente ku i dënuari e ka vendbanimin, me qëllim që pjesa e mbetur e dënimit me gjobë (të pa shlyer me dënimin e zëvendësuar me burgim) të ekzekutohet, sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore.**

### **Arsyetim**

Në kërkesën e vet gjykata Themelore në Prishtinë i ka ngritur këto dilema dhe ka paraqitur opinionet e saja si në vijim;

Në të gjitha gjykatat në Kosovë ka aktgjykime sipas të cilave është shqiptuar dënimi me gjobë si dënim i vetëm, me konstatimin se nëse ky dënim nuk paguhet brenda afatit të caktuar do të inkasohet edhe detyrimisht në procedurën e përmbarimit dhe këto aktgjykime pastaj janë dërguar bazuar në LESP, te gjykata ku i dënuari e ka vendbanimin, në procedurë të përmbarimit të detyruar. Do të thotë se ka shumë raste që janë në procedurë të përmbarimit të detyruar sipas aktgjykimeve të formës së prerë ku janë shqiptuar dënime me gjobë qoftë sipas nenit 39 të KPPK-së, qoftë tani sipas nenit 46 të KP të RK-së.

Dilema është se kush (cila gjykatë) duhet të veproj në procedurën e përmbarimit të detyruar kur është shqiptuar dënimi me gjobë - si dënim i dytë, përkatësisht kur kemi një dënim me burg (të cilin e ekzekuton gjykata që e ka shqiptuar dënimin) dhe një dënim me gjobë të cilin duhet inkasuar në procedurën e përmbarimit të detyruar.

Te dënimi kumulativ dënim me burg dhe dënim me gjobë qëllimi i ligjit nuk duhet interpretuar në formën e mundësisë që edhe dënimi me gjobë, kur nuk paguhet brenda afateve të caktuara të shëndrohet si dënim me burg. Kjo për arsye se qëllimi i dënimit me gjobë të dënimi kumulativ

është që i dënuari të ndiej edhe pasojat materiale të dënimit për veprën penale për të cilën është shpall fajtor dhe i është shqiptuar dënimi.

Së dyti, çështja e ekzekutimit të dënimit me gjobë rregullohet me nenin 135 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Sipas nenit 135 të LESP-së kur gjykata shqipton dënimin me gjobë urdhëron ekzekutimin e dënimit me gjobë. Dispozitat e Ligjit të Procedurës përmbartimore në fuqi zbatohen për kompetencën dhe procedurën e ekzekutimit të dënimit me gjobë, për faktin se te ekzekutimi i sanksionit penal dënim me gjobë aplikohet inkasomi i detyruar i të hollave qoftë në formën e pagesës nga vet i dënuari apo nëpërmes të llogarisë bankare. Kompetente për zbatimin e procedurës së përmbartimit të detyruar do të jetë gjykata ku i dënuari (debitori) e ka vendbanimin, kjo sepse edhe për sa i përket llogarive bankare të gjitha bankat komerciale në Kosovës i kanë degët e tyre në të gjitha qendrat ku edhe janë Gjykatat apo Degët e Gjykatave Themelore.

Përfundimet e Gjykatës Supreme lidhur me pretendimet e ngritura

Përkundër këtyre opinioneve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme, mendon se dënimi me gjobë duhet ekzekutuar si në dispozitiv, të këtij menidmi juridik, për arsytet që do paraqiten në vazhdim.

Me dispozitat e Kodit Penal të Kosovës (neni 46 i KPK) është parashikuar se kur gjykata shqipton dënim me gjobë, ajo cakton edhe afatin e pagimit, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë dhe as më i gjatë se 3 muaj, përveç në raste të arsyeshme, kur i lejohet të dënuarit të paguajë në këste në afat jo më të gjatë se 2 vjet. Sipas paragrafit 3. të nenit të cituar “Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, 1 ditë burgim llogaritet me 20 €, gjobë. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalohet 3 vjet.”.

Sipas paragrafit 5 të nenit të cituar më lart, nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata mund në pajtim

me personin e dënuar, të zëvendësojë gjobën me një urdhër për punë në dobi të përgjithshme.

Se a do t'i ofrojë gjykata të pandehurit ndonjërin nga alternativat e mësipërme, është e drejtë diskreionale e saj, sepse ajo ka mundësi ligjore që dënimin me gjobë ta zëvendësojë me dënim burgimi menjëherë pas kalimit të afatit të caktuar me aktgjykimin për pagesën e gjobës, pa i ofruar ndonjërin nga alternativat e tjera.

Nga arsyet e paraqitura më lart qartë rezulton se në situata të tilla me asnjë dispozitë ligjore nuk është parashikuar ekzekutimi me shtrëngim i dënimit me gjobë (për pjesën për të cilën ai mund të zëvendësohet me dënim me burgim). Norma ligjore nga neni 46. par. 3. të KPK, nuk thotë se nëse ekzekutimi nuk mund të bëhet as me shtrëngim i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, siç e thoshte norma e mëhershme (psh. neni 39. par. 3 të LPJ), për këtë arsye në situatën kur i dënuari nuk dëshiron të paguaj gjobën në afatin e lënë apo nuk mund ta bëjë atë, gjykata që e ka gjykuar në shkallë të parë mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim.

Në rastet kur dënimi me burgim nuk mjafton për të shlyer dënimin me gjobë, atëherë konform dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, lënda i dërgohet gjykatës kompetente në rajonin e së cilës ndodhet vendbanimi-vendqëndrimi i të pandehurit, me qëllim të ekzekutimit të pjesës së mbetur (të pa shlyer –mbuluar me burgim) të dënimit me gjobë, konform nenit 135 të LESP-së.



*GJA-SU-A. nr. 388/14*

*Datë 02.10.2014*

### **Kompetenca e Gjykatës për të vendosur lidhur me prapësimin kundër vendimeve të përmbarruesve privat.**

*Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, me gjyqtarë vendorë dhe ata nga EULEX-i, duke vendosur sipas kërkesës së*

*Gjykatës Themelore në Prishtinë, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat, më 02.10.2014, jep këtë:*

### **Mendim juridik**

**Kompetente për të vendosur lidhur me prapsim, ankesën, parregullsi në procedurën përmbaruese, kundër vendimit mbi lejimin e përmbarimit të përmbaruesit privat, ku si palë janë paraqitur personat juridik apo shoqëritë tregtare, është Gjykata Themelore në territorin e të cilës gjendet selia e debitorit, në kuptim të nenit 5.5 të Ligjit Për Procedurën Përmbarimore dhe nenit 11.1 të Ligjit për Gjykatat.**

### **Arsyetim**

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, i është drejtuar Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës me kërkesë për të dhënë mendim juridik lidhur me zbatimin e dispozitave të Ligjit të ri për procedurën përmbarimore nr. 04/L-139, dhe Ligjit për Gjykatat, që kanë të bëjnë me kompetencën për të vendosur me prapsim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbaruese, kundër vendimeve të përmbarueseve privat dhe kundër veprimeve ekzekutive të përmbaruesve privat, në rastet kur të dy palët në procedurë janë shoqëri tregtare apo persona juridik.

Me Ligjin për procedurën përmbarimore nr. 04/L-139 i cili ka hyrë në fuqi më 01 Janar 2014, me nenin 5.5 është përcaktuar kompetenca për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapsim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbaruese. Sipas nenit 52 dhe 67 të këtij ligji, për të vendosur çështjet që kanë të bëjnë me çdo prapsim, ankesë, parregullsi në procedurën përmbaruese ose çfarëdolloj procedure kundër veprimeve të ndërmarra nga përmbaruesi privat nëse debitori është person fizik, kompetencë ka gjykata kompetente në territorin e së cilës debitori ka vendbanimin apo nëse nuk ka vendbanim në Kosovë, atëherë në territorin në të cilin ka vendqëndrimin. Nëse debitori është person juridik, kompetencë territoriale ka gjykata kompetente ku gjendet selia e debitorit.

Ligji për Gjykatat i Kosovës, me nenin 13 ka përcaktuar kompetencën e Departamentit për Çështje Ekonomike që vepron në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, por nuk ka përcaktuar se ky Departament ka kompetencë të vendos në procedurë të përmbarimit lidhur me prapësimin e paraqitur kundër vendimeve të përmbarimit të cilat kanë të bëjnë me persona juridik apo shoqëri tregtare.

Me nenin 11 të Ligjit për Gjykatat në Kosovë, Gjykatat Themelore, janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet përpos nëse me ligj parashihet ndryshe, ndërsa sipas dispozitës së nenit 16.1 të ligjit të cituar është paraparë se Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore gjykon në shkallë të parë të gjitha çështjet, përveç nëse kjo është në kompetencë të një Departamenti tjetër të Gjykatës Themelore.

Nga kjo rezulton se në kuptim të nenit 5.5 të Ligjit Për Procedurën Përmbarimore, Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në territorin e së cilës gjendet selia e debitorit, është kompetente për të vendosur lidhur me prapësimet e debitorëve kundër vendimeve të përmbaruesve privat.

**Praktika gjyqësore**  
**PENALE**





## I. PROCEDURË PENALE

PML. nr. 79/2015

Datë 16.04.2015

### **Dorëzania - neni 179. i KPPRK - Heqja e Dorëzanisë - neni 182. i KPPRK**

*Dorëzania si masë alternative e paraburgimit caktohet me aktvendim, sipas kërkesës së prokurorit të shtetit për caktimin e masave për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurë, por edhe sipas kërkesës së të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, kur ai ndodhet në paraburgim dhe kërkon që kjo masë t'i zëvendësohet me ndonjë masë tjetër alternative.*

*Mallrat e kontrabanduara, konform nenit 273 par. 2 konfiskohen deri në përfundim të procedurës lidhur me çështjen kryesore.*

### **Nga arsytimi**

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin P. nr. 167/2004 të dt. 08.12.2014, të pandehurit R. M. ia ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për kthimin e mjeteve në shumë prej 5000 Euro (pesë mijë euro) të depozituara në emër të "Dorëzanisë", të caktuar sipas aktvendimit të Gjykatës Komunale në Mitrovicë P. nr. 66/2004 të Datë. 02.03.2004. Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendim PN. nr. 4/2015 të dt. 26.01.2015, ka refuzuar si të pabazuar ankesën dhe ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, me të drejtë mbrojtësi i të pandehurit në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, konsideron se me këtë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë të cilin si të drejt e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit gabimisht, janë aplikuar dispozitat e nenit 182 të KPPRK-s, e që ka afektuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, ngase, për tani vendimi i gjykatave të shkallës së parë me të cilën është refuzuar kërkesa për kthyerjen e parave të marra dhe asaj të Apelit janë të paqarta, pasi që nuk mund të kuptohet se cila ka qenë arsyeja që të pandehurit i janë marr 5000 €, nuk ekziston asnjë vendim i shkruar

përpos një konstatimi në procesverbal. Dorëzania si masë për sigurinë e pranisë së të pandehurit në procedurën penale që zhvillohet ndaj tij, në fazën e hetimit jepet, kur prokurori ka propozuar paraburgimin ndaj të pandehurit, ndërsa gjykata vlerëson se ai mund të mbrohet nga liria me dorëzani, ose kur gjykata veç ka caktuar paraburgimin, por ndërkohë e aprovon ofertën nga i pandehuri për dorëzani dhe urdhëron që ai të lirohet nga paraburgimi. Dorëzania caktohet me aktvendim, në të cilin theksohen arsyet e dorëzanisë, kushtet të cilave duhet tu përmbahet i pandehuri dhe pasojat e mos respektimit të kushteve nga dorëzania. Në aktvendimin me të cilën gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesën për kthyerjen e parave të marra, ka theksuar se i pandehuri nuk i është përgjigjur gjykatës në thirrjen e saj dhe me këtë gjykata e ka hequr dorëzantinë, që e bënë akoma më konfuze situatën, ngase u tha më lart nuk ekziston asnjë aktvendim për dorëzani, dhe as që ka pas propozim nga prokurori i çështjes për ndonjë nga masat për praninë e të pandehurit në procedurë.

Sipas dispozitave të KPPRK që ishte në fuqi gjykata ka mundur të aplikoj masat e përkohshme sipas Ligjit Për Procedurën Përmbartimore, në procedurën e konfiskimit të pasurisë e cila dyshohet se është përfituar me vepër penale, por edhe në këtë drejtim nuk ekziston asnjë vendim i arsyetuar për të kuptuar se për çfarë bëhet fjalë. Në shkresat e lëndës ekziston vetëm një konstatim në procesverbal: “nga i pandehuri marrën 5000 €, si garancion për 29000 kg. pleh artificial të konfiskuar” !!!!, ndërsa u tha më sipër në aktvendim e gjykatës së shkallës së parë me të cilin është refuzuar kërkesa e të pandehurit për kthyerjen e parave të marra, theksohet se dorëzania është humbur ngase i pandehuri nuk është paraqitur në gjykatë. Me ligj saktë është përcaktuar se kur mund të aplikohet kjo masë alternative e paraburgimit, procedura dhe forma e vendimit, ndërsa në rastin konkret nuk është përmbushur asnjë kriter për aplikimin e dorëzanisë. Nuk ka propozim nga prokurori për caktimin e paraburgimit (pa këtë propozim nuk mund të caktohet as masa e dorëzanisë në fazën e hetimeve), nuk ka asnjë lloj aktvendim edhe po të bëhej fjalë për dorëzantinë apo për ndonjë nga masat e përkohshme në procedurën e konfiskimit (edhe pse në arsyetimin të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë thuhet se bëhet fjalë për dorëzantinë). Në rrethana të këtilla nuk ka pas mundësi ligjore që të pandehurit t’i me-

rrën këto mjete monetare, pa e formalizuar me një vendim të shkruar, ku do ishin paraqitur arsye e marrjes së mjeteve monetare dhe ndaj të cilit vendim i pandehuri do kishte të drejtë ankimi.

Nga përmbajtja e shkresave të lëndës po rezulton se gjykata të pandehurit në vend që t'ia konfiskoj mallin e kontrabanduar - plehun artificial, sipas nenit 273 par. 2 të ish KPPK-s, deri në përfundim të procedurës i ka marr 5000 € (nuk është e qartë pse? Nuk bëhej fjalë për mall që i nënshtrohet prishjes !???), pa e formalizuar fare me vendim (vetëm në procesverbal është konstatuar se të pandehurit i merren 5000 €, ndërsa plehu i konfiskuar i kthehet), nga i cili do shihej se pse janë marrë këto 5000 €, nga kjo qartë rezulton se parat e marra nga ai nuk mund të mbahehen në emër të dorëzansisë, ngase nuk del se bëhet fjalë për dorëzani.

Këto janë shkaqet për të cilat Gjykata Supreme, në mbështetje të nenit 438 par.1 pika 1.2 të KPRK-s, anuloi aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë dhe atë të Apelit dhe çështjen ia ktheu për rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme,  
Pml. nr. 79/20015, më datë 16.04.2015)



*Pml. nr. 16/2014*

*Datë 28.01.2014*

**Personat e autorizuar për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë - neni 433 par. 1 të KPPRK - Vendimet dhe procedurat që mund të atakohen me anë të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë - neni 432 par. 1 të KPPRK**

*Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesin Kryeprokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.*

*Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë.*

## Nga arsyetimi

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin e vet PAKR nr. 899/2012 të datës 16.04.2013, ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së qarkut në Pejë P.nr.154/2010 të datës 20.10.2011 me të cilin aktgjykim i aku-zuari E. P. është shpallur fajtor dhe është gjykuar për veprat penale të vrasjes në tentativë nga neni 30 al. 1 të LPK lidhur me nenin 19 të LPJ dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa-authorized të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK. Me këtë aktvendim Gjykata e Apelit ka vendosur që lënda i kthehet në rigjykim të njëjtës gjykatë, pra, Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Gjykata Themelore në Pejë ka marrë aktvendimin P. nr. 270/2013 të datës 22.10.2013 me të cilin është shpallë inkompetente në pikë-pamje territoriale për të gjykuar këtë çështje dhe ia ka dërguar lëndën Gjykatës Themelore në Gjakovë, si gjykatë kompetente pasi që vepra penale është kryer në territorin e asaj gjykate, e në bazë të dispozitës së nenit 39 par. 2 të Ligjit për gjykatat.

Gjykata Themelore në Gjakovë më pastaj ka kundërshtuar këtë ak-tvendim, gjegjësisht ka kërkuar që Gjykata e Apelit të Kosovës te shpallë kompetente Gjykatën Themelore në Pejë si kompetente në pikëpamje territoriale për të gjykuar çështjen.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur lidhur me këtë konflikt të kompetencës, ka marrë aktvendimin PN. nr. 670/2013 të datës 25.10.2013 me të cilin kompetente për të gjykuar këtë çështje ka caktuar Gjykatën Themelore në Gjakovë.

Kundër këtij aktvendimi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka para-qitur gjyqtari, i cili ka kontestuar kompetencën e Gjykatës Themelore në Gjakovë, për të gjitha bazat ligjore.

1. Së pari kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë rezulton se është e palejueshme, ngase këtë mjetë të jashtëzakonshëm juridik nuk mund ta paraqes gjyqtari i çështjes, pasi që ai nuk e ka statusin e palës në procedurë.

2. Së dyti, edhe sikur kërkesa të ishte e lejuar, e njëjta do ishte e paprueshme, ngase sipas dispozitës së nenit 432 par. 1 të KPPRK kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë, në rast të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të ligjit të procedurës penale parashikuar nga neni 403 par. 1 të këtij Kodi dhe në rast të tjera të dispozitave të procedurës penale, kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Ndërkaq, sipas dispozitës së nenit 432 par. 4 të KPPP, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit.

Në çështjen konkrete procedura penale në shkallën e parë ende nuk ka përfunduar në formë të prerë, por është vendos vetëm lidhur me kompetencën territoriale të gjykatës.

Për arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u hodh si e palejueshme në kuptim të nenit 435 par. 2 të KPPRK.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme,  
Pml. nr. 16/2014, më datë 28.01.2014)*



*Pml. nr. 23/2015  
Datë 01.02.2015*

### **E drejta për mbrojtës dhe heqja dorë nga kjo e drejtë-neni 53 par. 3 të KPPRK**

*Nga e drejta për të pasur mbrojtës mund të hiqet dorë, përveç në rastin e mbrojtjes së detyruar, nëse heqja dorë bëhet qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë për të drejtën e të pandehurit në mbrojtje. Heqja dorë duhet bërë me shkrim dhe duhet nënshkruar nga i pandehuri dhe nga organi kompetent që zbaton procedurën.*

## Nga arsyetimi

Me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr. 564/2006 të datës 31.10.2014 i dënuari S.K. është shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 253 par. 1 lidhur me nenin 20 të KPK dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 29.04.2006 deri më datën 02.05.2006. Me të njëjtin aktgjykim është refuzuar akuza ndaj të dënuarit, për tri vepra penale të vjedhjes së rënd nga neni 253 par. 1 pika 1 të KPK.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendohet se i dënuari në shqyrtimin gjyqësor nuk ka pas mbrojtës dhe se i është pamundësuar të ketë mbrojtësin ngase në kohën e shqyrtimit gjyqësor ka qenë në paraburgim për një vepër tjetër penale dhe lirinë e lëvizjes e ka pas të kufizuar që do të thotë edhe mundësinë e angazhimit të mbrojtësit dhe se në këtë mënyrë është shkel e drejta ligjore e të dënuarit të ketë mbrojtës, që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nënparagrafi 2.3. të KPPK. Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore nuk e ka evituar këtë shkelje por përkundrazi, ka theksuar se “në rastet kur i akuzuari e pranon fajësinë, mbrojtja nuk është obligative”.

Gjykata Supreme konstaton se në kohën e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor- më datën 31.10.2014. ndaj të dënuarit nuk ka qenë i caktuar paraburgimi në këtë çështje konkrete penale, por ekziston aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren Pp. nr. 139/2014 i datës 29.10.2014. nga i cili del se paraburgimi i është caktuar në një çështje tjetër penale, më datën 29.10.2014. Konform nenit 57 par. 1.1 të KPPK një prej rasteve të mbrojtjes së detyruar është gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa i pandehuri gjendet në paraburgim. Mirëpo, të dënuarit, paraburgimi nuk i është caktuar në këtë çështje dhe për këtë arsye kushti për mbrojtjen e detyruar nuk është plotësuar.

Mirëpo, nga procesverbali i shqyrtimi gjyqësor del se i dënuari është njoftuar me të drejtat e tij procedurale, e në mesin e tyre edhe me të drejtën e angazhimit të mbrojtësit, por ai fare nuk është deklaruar se

a ka angazhuar mbrojtës apo a dëshiron që t'i mundësohet angazhimi i mbrojtësit. Nuk ka mjaftuar të konstatohet në aktgjykimin e shkallës së dytë se i dënuari është njoftuar për të drejtat të cilat i takojnë në bazë të ligjit dhe se nuk ka pas vërejtjeje në këtë drejtim. Përkundrazi, konform nenit 53 par. 3 të KPPRK, nga e drejta për të pasur mbrojtës mund të hiqet dorë, përveç në rastin e mbrojtjes së detyruar, nëse heqja dorë bëhet qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë për të drejtën e të pandehurit në mbrojtje. Heqja dorë duhet bërë me shkrim dhe duhet nënshkruar nga i pandehuri dhe nga organi kompetent që zbaton procedurën, në rastin konkret nga gjyqtari i çështjes, e që në këtë çështje penale nuk është vepruar ashtu siç norma urdhëron, dhe me këtë të pandehurit i është cenuar e drejta në mbrojtje. Për më tepër, në aktgjykimin e shkallës së dytë është konstatuar se “në raste kur i akuzuari e pranon fajësinë, mbrojtja nuk është obligative”, konstatim ky i cili nuk i përket situatës konkrete dhe nuk ekziston ndonjë dispozitë ligjore e cila përcakton se nëse i pandehuri e pranon fajësinë mbrojtja nuk është e detyruar.

Këto janë shkaqet për të cilat Gjykata Supreme, në mbështetje të nenit 438. par. 1.pika 1.2.të KPK-së, anulojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të Apelit dhe çështjen ia ktheju për rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme,  
Pml. nr. 23/2015, Datë 01.02.2015)*



*Pml. 24/2015  
Datë 24.02.2015*

## **Llojet e ekspertizave të kryesit me çrregullime mendore-neni 508 të KPPRK**

*Në procedurën penale ku përfshihen kryesit me çrregullime mendore caktohen: ekspertiza për të konstatuar nëse në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zoogëluar*

*mendore ose ekspertiza për të konstatuar nëse i pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin.*

### **Nga arsyetimi**

Me aktvendimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Krimeve të Rënda P.nr. 29/2014 të datës 10.09.2014 është vendosur që i pandehuri D. A. është i paaftë për t'iu nënshtruar gjykimin, të pushohet procedura penale kundër tij për shkak të veprës penale vrasje e rënd nga neni 179 par. 1 pika 1.3 të KPRK për shkak të paaftësisë për t'iu nënshtruar gjykimin gjatë procedurës, për shkak të sëmundjes së përhershme mendore dhe që pas marrjes së formës së prerë të aktvendimit, shkresat e lëndës t'i dërgohen Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me qëllim të pranimit të të akuzuarit në ndonjë institucion të kujdesit shëndetësor, në pajtim me ligjin në fuqi të procedurës jashtkontestimore.

Një prej pretendimeve në kërkesën e mbrojtës për ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit është se se gjykata nuk ka kërkuar mendim nga eksperti nëse i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka vuajtur nga sëmurja mendore edhe pse neni 508 par. 7 të KPPRK e obligon gjykatën që nga eksperti të kërkojë të dhëna për kohëzgjatjen e sëmurjes së të pandehurit, si fakt vendimtar për vazhdimin e procedurës penale, pretendim ky për të cilin u konstatua se nuk është i bazuar.

Sipas dispozitës së nenit 508 të KPPRK, te kapitulli i procedurës penale ku përfshihen kryesit me çrregullime mendore, në çdo kohë mund të caktohen dy lloje të ekspertizave:

- për të konstatuar nëse në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore; ose
- për të konstatuar nëse i pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin.

Në rastin konkret del se është caktuar ekspertiza për të konstatuar nëse i pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin, pra sipas nenit 508



par. 1.2 të KPPRK. Ekipi i mjekëve të QKUK i përbërë nga neuropsikiatri, psikiatri dhe psikologu në konstatimin e vet ka theksuar se te i pandehuri konstatohet sëmundje e Parkinsonit, sindrom organik, dëmtim i rënd i proceseve kognitive dhe emocionale, ai nuk e kupton qëllimin e ekzaminimit, komunikimi me te është i pamundur, fizikisht sistemi lokomotor i dekompenzuar, është mjaft i lodhur, për shkak të ndryshimeve organike të kësaj sëmundjeje, deteriorimit organik të personalitetit, senilitetit-dobësimi fizik dhe me e rëndësishmja-dëmtimi i rënd i gjykimit, orientimit, inteligjencës, koncentrimin, aftësisë së kontrollit të veprimeve të tij, nuk është i aftë të përballojë gjykimin dhe deponimet e tij eventuale do të jenë jo valide. Në raportin shtesë, ekspertet kanë precizuar se fjala është për një sëmurje të karakterit të përhershëm.

Andaj, ekspertët kanë dhënë konstatimin dhe mendimin e vet lidhur me aftësinë e të pandehurit për të përballuar gjykimin, sipas nenit 508 par. 1.2 të KPPRK që është diç tërësisht tjetër nga ajo që kërkohet në bazë të nenit 508 par. 1.1 të KPPRK-për gjendjen e tij mendore në kohën e kryerjes së veprës penale (llogaritshmëria), për çka pretendimi në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë i cili thirret në dispozitën e nenit 508 par. 1 pika 1 të KPPRK nuk ka qenë objekt i aktvendimeve të atakuara dhe si i tillë nuk është i bazuar.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme  
Pml. 24/2015, Datë 24.02.2015.)*



*Pzd. nr. 69/2014  
Datë 11.07.2014*

### **Personi i autorizuar për ushtrimin e kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit-neni 429 par. 1 të KPPRK**

*Kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund ta paraqes Prokurori publik kur procedura është zbatuar me kërkesën e tij, i dënuari dhe mbrojtësi i tij.*

## Nga arsyetimi

Me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Pejë P. nr. 226/2012 të datës 12.12.2013. i dënuari Q. B. është shpallur fajtor për veprat penale mashtrimi nga neni 261 par. 1 të KPRK dhe kanosje nga neni 161 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK dhe është gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 13 (trembëdhjetë) muajve.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur babai i të dënuarit.

Sipas dispozitës së nenit 429 par. 1 të KPPRK kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund ta paraqes Prokurori publik kur procedura është zbatuar me kërkesën e tij, i dënuari dhe mbrojtësi i tij.

Siç rezulton nga shkresat e lëndës, kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk e ka paraqitur i dënuari e as personat tjerë nga dispozita e lartë përmendur, por babai i të dënuarit, edhe pse në fund të kërkesës shkruan se paraqitësi i kërkesës është i dënuari, por më tutje shihet se “për” të dënuarin kërkesën e ka nënshkruar babai i tij.

Pasi që kërkesa nuk ishte e lejuar me ligj, në bazë të nenit 431 par. 4 lidhur me nenin 430 par. 1 të KPPRK u vendos si në dispozitiv.

*(Aktgjykim i Gjykatës Supreme  
Pzd. nr. 69/2014, Datë 11.07.2014)*



*Pml. nr. 240/2014*

*Datë 10.12.2014*

### **Hudhja e ankesës si të palejueshme - neni 400 i KPPRK-s**

*Kur gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit i ka tejkalua limitet e marrëveshjes të arritur në mes të përfaqësuesit të akuzës të pandehurit dhe mbrojt-*

*tësi të tij, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë për shkak të vendimit për dënimin (neni 233 par. 13 i KPPRK).*

### **Nga arsyetimi**

Me të drejtë ceket në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit, se gjykata e shkallës së dytë, ka cenuar të drejtat e të akuzuarit në fazën e ankimimit, ngase në kundërshtim me ligjin përkatësisht nenin 400 të KPPK-s , ka hedhur ankesën si të palejuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti i për Krime të Rënda P.nr. 376/2013 datë 22 janar 2014 i dënuari N.B, është shpallur fajtor për veprën penale marrja e rryshfetit nga neni 421 par. 1 të KPRK, dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj, në të cilin dënim është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 8.11.2013 deri më 27.11.2013 si dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 2.000 (dymijë) €, të cilat dënime do të ekzekutohen pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dënuarit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i ushtrimit të detyrës apo veprimtarisë, në kohëzgjatje prej tri (3) vitesh, në bazë të nenit 62 par. 1.2 nën par. 2.3 të KPRK.

Nga shkresat e lëndës rezulton se është arritur marrëveshje në mes organit të akuzës, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, në harmoni me dispozitat që rregullojnë procedurat alternative - negocimit të marrëveshjes (neni 384 par. 2 nën par. 2.1 dhe 2.2, dhe neni 383 par. 1 nën par. 1.4, të KPPK). Marrëveshja kishte këtë përmbajtje; I pandehuri pranoi fajësinë për të gjitha pikat e akuzës dhe me këtë rast palët u dakorduan që të akuzuar dhe t'i shqiptohet dënim burgimi brenda kufijve prej 6 muaj deri në 1 vit, dënimi me gjobë brenda kufijve prej 1.500-2.000 € dhe dënimi plotësues - ndalimi i ushtrimit të detyrës në kohëzgjatje prej 2-3 vite.

Bazuar në dënimin plotësues që ka shqiptuar Gjykata e shkallës së parë, rezulton se janë tejkaluar limitet e marrëveshjes së arritur në mes të palëve në procedurë, ngase palët ishin dakorduar për shq-

iptimin e dënimit plotësues, ndalimi i ushtrimit të detyrës në kohëzgjatje prej 2-3 vite, pjesë e marrëveshjes nuk ishte ndalimi i veprimtarisë.

Sipas nenit 233 par. 13. të KPPK, kur gjykata shqipton dënim jashtë kufijve të marrëveshjes, pala në dëm të cilës është shqiptuar dënimi ka të drejtë ankese vetëm për vendimin për dënimin, ndërsa u tha më sipër gjykata i kishte tejkaluar limëte e marrëveshjes, duke i ndaluar të akuzuarit edhe ushtrimin e veprimtarisë e cila nuk ishte pjesë e marr veshjes, veprimtaria dhe detyra janë dy dënime të ndryshme plotësuese, palët u morën veshë vetëm për një dënim plotësues - ndalimin e ushtrimit të detyrës jo edhe të veprimtarisë. Nga kjo qartë rezulton se ankesa e mbrojtësi të të pandehurit në rrethana të tilla ishte e lejueshme sipas ligjit. Pra Gjykata e Apelit në kundërshtim me ligjin, ka hedhur ankesën si të palejuar në çka me të drejtë tërheqë vërejtjen mbrojtësi.

Këto janë shkaqet për të cilat Gjykata Supreme, në mbështetje të nenit 438 par. 1 pika 1.2 të KPRK-s, anuloi aktvendimin e Gjykatës së Apelit dhe çështjen ia ktheu po asaj gjykate për rigjykim

(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme  
Pml. nr. 240/2014, date 10.12.2014.)



*Pml. nr. 239/2014*

*Datë 24 12.2014*

### **Shkelje esenciale të dispozitave te procedures penale - neni 384. KPPRK**

*I. Gjykata ka tejkaluar akuzën kur ka ndryshuar përshkrimin faktik edhe pse nuk e ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale.*

*II. Dispozitivi del të jetë i paqartë kur cilësimi juridik nuk është kompatibil me përshkrimin faktik dhe kur në dispozitio janë futur fakte të pavërtetuara për tej çdo dyshimi.*

*III. Dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin, nëse në dispozitio janë*

*futur elementet e vrasjes së privilegjuar ndërsa në arsyetim bëhet fjalë për vrasje të rëndomtë.*

### **Nga arsjetimi**

Me të drejtë ceket në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të akuzuarit, se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e që ato juridikisht i bën të paqëndrueshme.

Sipas dispozitivit të aktakuzës, prokurori i shtetit e ngarkon të akuzuarin për veprën penale të vrasjes, të parashikuar nga neni 179 dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK.

Gjykata e shkallës së parë e ndryshon dispozitivin e aktakuzës dhe i shton edhe këto fjali: “V. e ofendon rëndë të akuzuarin, sipas të gjitha gjasave!!! me fjalë ofenduese të cilat tani i akuzuari nuk mund t’i përmend!!!, ndër të tjera edhe `A. çikën e ke krejt budallicë, e ishalla e gjen një budalla si vet e martohet”, edhe pse e pranon cilësimin juridik të prokurorit të shtetit.

Aktgjykimi rezulton të jetë i paligjshëm për këto arsye:

Së pari aktgjykimi është i paligjshëm për arsye se gjykata e shkallës së parë, përkundër faktit se pranon cilësimin juridik të veprës penale të parashtruar nga përfaqësuesi i akuzës, ndërton një dispozitiv tjetër nga ai i akuzës, duke shtuar togë-fjalësh dhe shprehjesh që i përgjigjen veprës penale të vrasjes në gjendje të afektit mendorë siç janë: “V. e ofendon rëndë të akuzuarin, sipas të gjitha gjasave!!! me fjalë ofenduese të cilat tani i akuzuari nuk mund t’i përmend!!!, ndër të tjera edhe `A. çikën e ke krejt budallicë, e ishalla e gjen një budallë si vet e martohet”, edhe pse këto konstatime nuk mbështeten në asnjë provë, përpos në thëniet e të akuzuarit, d.m.th., atë që e thotë në mbrojtje i akuzuarit, e pranon si të provuar gjykata, me këtë ka bërë tejkalimin objektiv të aktakuzës (nuk është e qartë se pse i ka futur këto fjalë në dispozitiv, kur ka pranuar cilësimin juridik nga akuza???)

Së dyti është i paligjshëm edhe për faktin se, nëse gjykata e shkallës së parë, ka gjetur se i akuzuari para se të kryejë vrasjen është “fyer rëndë nga i ndjeri” është dashur që vrasjen ta cilësojë si vrasje në gjendje të afekti mendor , ngase një nga shkaqet që një vepër penale e bënë të privilegjuar “vrasje në gjendje të afekti mendor” është edhe fakti se i akuzuari është sjellë në gjendje të tronditjes së forte psikike , pa fajin e tij nga fyerja e rend që i ndjeri i ka bërë atij, kjo e bënë të paqartë dispozitivin e aktgjykimit.

Pastaj, aktgjykim del të jetë i paligjshëm dhe i paqartë, për faktin se gjykata e shkallës së parë e ndryshon dispozitivin e aktakuzës me rrethana që i përgjigjen vrasjes në gjendje të afektit mendor, për të cilat fakte nuk është i sigurt se ekzistojnë, ngase përdorë shprehjen “sipas të gjitha gjasave!!!!” që nënkupton “ me sa duket, ndoshta, mund t’i ketë thanë etj!!!!.” Në të drejtën penale, vlen parimi “in dubio pro reo” dhe sipas këtij parimi, një fakt relevant konsiderohet se ekziston vetëm atëherë kur nuk ka ngelur asnjë mëdyshje për ekzistimin e tij.

Është i paligjshëm, ngase gjykata e shkallës së parë, sa i përket llogaritshmërisë së të akuzuarit, konstaton se ai veprën penale e kreu “në gjendje të përgjegjësive esencialisht të zvogëluar” (neni 18. par. 2. të KPK) edhe pse këtë nuk e thotë eksperti, ai përdorë shprehjet “nuk jam i sigurt 100 % se i pandehuri ka qenë në gjendje të afektit mendor, se ka pasur mundësi të ketë qenë në gjendje të tronditjes të rëndë mendore etj. !!!!”.

Neni 18. par. 2. të KPRK, aplikohet vetëm atëherë kur shkalla e përgjegjësive penale ka qenë e zvogëluar esencialisht, e jo çdo përgjegjësi e zvogëluar, pastaj duhet dalluar përgjegjësinë e zvogëluar nga tronditja e fortë psikike, ngase deficitet në shkallën e përgjegjësive mund të jenë pasojë e sëmundjeve të përhershme, të përkohshme, çrregullimeve psikike, apo ngecje në zhvillimin psikik, ndërsa tronditja e fortë psikike, që e karakterizon vrasjen në gjendje të afekti mendor, nuk është pasojë e këtyre sëmundjeve, por pasojë e rrethanave konkrete, kur kryesi vihet në këtë gjendje, pa fajin e tij, për shkak të sulmit, fyerjes së rëndë apo keqtrajtimet që i bënë viktima atij. Është fakt natyrorë se çdo krijesë e

lindur njerëzore, konsiderohet e aftë mendërisht, por ky supozim natyror është i rrëzueshëm, dhe gjykata kryesin e veprës penale e dërgon në observim psikiatrik, kur gjatë procedurës paraqiten dyshime në përgjegjshmërinë e tij. Në rastin konkret nuk është e qartë se për ç'arsye i akuzuari iu nënshtrua ekzaminimit psikiatrik; për shkak të dyshimeve se i akuzuari mund të kishte probleme në sferën bio-psikike-qendrat psiko-motorike; apo për diçka tjetër.

Është i paligjshëm për arsye se, për faktet vendimtare që kanë të bëjnë me personalitetin e të akuzuarit, nuk vërtetohen me prova të sigurta, por vetëm supozohen, gjykata te të dhënat gjenerale përdor shprehjen “kinse i padënuar!!!” (kjo rrethanë duhet vërtetuar ngase behët fjalë për fakte relevante- për personalitetin e kryesit të veprës penale, që ka ndikim në rastin e matjes së dënimit).

Këto janë shkaqet për të cilat Gjykata Supreme, në mbështetje të nenit 438 par. 1 pika 1.2 të KPPRK-s, anuloi aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë dhe atë të Apelit dhe çështjen ia ktheu për rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ,  
Pml. nr. 239/2014, 24.12.2014.)



*Pml. nr. 240/2014*

*Datë 24.12.2014*

## **1. Llojet e vendimeve që merren lidhur me parashkrimin e ndjekjes penale**

### **2. Tregtia e palejuar apo ushtrimi arbitrar i të drejtave?**

*1. Kur është arritur afati parashkrimit, gjykata merr aktgjykim refuzues nëse parashkrimin e ka vërtetuar në shqyrtim gjyqësor, apo aktvendim për hedhjen e parashkrimit nëse, parashkrimi është arritur para shqyrtimit gjyqësor, e jo aktgjykim lirues.*

*2. Kur i akuzuari ka tentuar që sendet që atij i ishin konfiskuar nga tregtia e palejuar t'i marr nga depoja ku ishin vendosur ato, nuk bëhet fjalë për veprën penale të vjedhjes së rëndë ,por për veprën penale ushtrimi arbitrarë i të drejtave nga neni 326 të KPK-s*

### **Nga arsytimi**

Mbrojtësi me kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, ka pretenduar se aktgjykimi është i përfshirë me shkelle esenciale të dispozitave të procedurës penale (pa i konkretizuar ato), dhe sipas vlerlësimit të tij gjykata edhe në rastin e parë edhe në rastin e dytë do duhej të merrte vendim meritor aktgjykim lirues dhe të akuzuarit t'ia kthente sendet e konfiskuara.

I. Të pabazuara janë pretendimet e mbrojtësit në kërkesë, se gjykata do duhej të merr aktgjykim lirues, ngase në momentin kur arrihet afati i parashkrimit qoftë relativ apo absolut, gjykata është e detyruar ta pushojnë procedurën penale jashtë shqyrtimit gjyqësor, përkatësisht ta refuzojnë akuzën në shqyrtimin gjyqësor(procedura përfundon për shkaqe procedurale).

II. Aktgjykimi sa i përket konfiskimit të sendeve për tani është i paligjshëm për arsye si në vijim:

Nga shkresat e lëndës rezulton se i pandehuri Sh.B., nga prokurori publik ishte akuzuar për dy vepra penale; tregti e palejuar, e parashikuar nga neni 116 par. 4. lidhur me par. 1 të LPK; dhe për veprë penale vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 135 par. 2 lidhur me par. 1. të LPK, për faktin se kishte tentuar që arbitrarisht t'i marr sendet e tija nga depoja ku po ruheshin pas konfiskimit!.. Për veprën penale tregtia e palejuar është refuzuar akuza, ndërsa për veprën penale të vjedhjes është hedhë akuza edhe në rastin e parë edhe në rastin e dytë për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Gjykata e shkallë së parë me rastin e hedhjes së akuzës, të akuzuarit i ka konfiskuar sendet si produkt i veprës penale të vjedhjes!!!. Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata e shkallës së parë fare nuk e



ka arsyetuar vendimin për konfiskimin e dobisë pasuror dhe në arsyetimin e saj shumë të shkurtër (faqe 3. pasuesi i fundit) vetëm ka theksuar se me qenë se i akuzuari “ka tentuar t’i vjedhë sendet”!!!, për këtë arsye ju kanë konfiskuar ato!!!.

Tipari qenësorë i veprës penale të vjedhjes, është marrja e sendit të huaj të luajtshëm me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme. Në rastin konkret i akuzuari ka tentuar ta marr sendet e tija të cilat ai i ka blerë (edhe pse ai nuk kishte leje përkatëse për tregti), jo sendet e huaja. Në rrethana të tilla bëhet fjalë për veprën penale të vetëgjyqësisë, të parashikuar nga neni 195 par. 1 të LPK-s, tani neni 326 të KPRK e jo për vjedhje, siç gabimisht përfaqësuesi i akuzës i ka cilësuar këto veprime

Konform nenit 489 të KPPK, që ishte në fuqi kur ishte kryer vepra penale (dhe ky Kod duhet aplikuar), ndaj të akuzuari detyrimisht konfiskohen (bëhet fjalë për normë imperative) sendet që janë produkte i veprës penale edhe kur procedura penale nuk ka përfunduar me aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor kur ekziston rreziku se mund të përdoren për vepër penale ose kur kjo është në interes të sigurisë publike për arsye morale. Në rastet konkret sendet që i janë konfiskuar të akuzuarit rezultojnë nga tregtia e ndaluar e jo nga vjedhja, siç gabimisht ka konstatuar gjykata e shkallës së parë dhe në relacion me tregtinë e ndaluar duhet shqyrtuar mundësinë e konfiskimit të sendeve, e jo në bazën e veprës penale të vjedhjes e cila u tha më sipër nuk ka ekzistuar. Këto janë arsyet që kushtëzuan anulimin e pjesshëm të aktvendimit të atakuar me kërkesë për mbrojtje të ligjshëmërisë.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme,  
Pml. nr. 240/2014, datë 24.12.2014.)*

## II. KODI PENAL

*Pml. nr. 10/2015*

*Datë 05.12.2015*

### **Shkelja e ligjit penal - neni 385. par. 5. të KPK**

*Kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore.*

### **Nga arsyetimi**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm P.nr. 211/2010 të datës 18.09.2014. i dënuari T. A. është shpallur fajtor për veprën penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 317. par. 2. lidhur me par. 1. të KPK dhe është gjykuar me dënim me kusht me të cilin i është përcaktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve i cili nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj nuk kryen vepër tjetër penale.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1. nr. 1358/2014 të datës 11.11.2014. aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar vetëm përkitazi me vendimin për dënimin ashtu që të dënuarit i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

Aktgjykimi në fjalë nuk atakohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale por për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkelje kjo e cila, sipas të dënuarit, konsiston në faktin se vendimi për dënim është marrë pa vlerësim adekuat të rrethanave të rasisht konkret, sepse intenziteti i rrezikshmërisë shoqërore dhe shkalla e përgjegjësisë penale nuk i përkasin nivelit të avansuar dhe rrethanat të cilat gjykata i ka vlerësuar si rënduese nuk i përgjigjen dinamikës dhe rrethanave të ngjarjes kritike.

Konform dispozitës së nenit 385 par. 5 të KPK kur është fjala për vendimin për dënimin, shkëlje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së dytë ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë për këtë vepër penale lartësia e së cilit po ashtu është brenda minimumin dhe maksimumit të dënim të cilin ligji e parasheh, që do të thotë se ka shqiptuar dënim duke mos i tejkaluar kompetencat ligjore.

Pretendimi në kërkesë se dënimi është shqiptuar me vlerësim jo adekuat të rrethanave të rastit konkret nuk paraqet shkëlje të ligjit penal e as që është bazë për ushtrimin e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme  
Pml. nr. 10/2015, datë 05.12.2015)*



*Pml. nr. 220/2014*

*Datë 19 nëntor 2014*

### **Vrasje e rëndë nga neni 147. pika. 9. të KPK**

*Fakti se në mes të kryesit (orasësit) dhe familjes së tij, kishte konflikte-armiqësi me të ndjerin dhe familjen së tij, vetvetiu nuk do të thotë se vrasja është kryer nga motivi i hakmarrjes së paskrupullt, të parashikuar nga neni 147. pika 9 të KPK.*

### **Nga arsyetimi**

Me të drejtë ceket në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësve, se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë

shkeljen e ligjit penal në dëm të akuzuarit A.K., kur kanë konstatuar se në veprime e tij qëndrojnë elementët e veprës penale vrasje e rëndë, të parashikuar nga neni 147 par. 1 pika 9 të KPRK. Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, ky cilësim juridik nuk është i drejtë.

Nga shkresat e çështjes rezulton se, tani i ndjeri, është privuar nga jeta me datë 27.6.2009 rreth orës 16:20 minuta në vendin e quajtur "K." Komuna e H. E. Po atë ditë i dënuari A. K., së bashku me dëshmitarin E. B. kanë shkuar në malet e fshatit K., të pajisur me pushkë të gjuetisë dhe në momentin kur këta ndahen në drejtime të ndryshme, i dënuari A. e vëren, tani të ndjerin S. L., duke ecur në rrugë të malit dhe, nga distanca prej 18 m. shtie njëherë në drejtim të tij nga pushka e gjuetisë të tipit "doublebarrel" kal. 16 mm, dhe e qëllon në anën e djathtë të gjoksit, në pjesën e përparme të djathtë mbi nënsqetullën e djathtë, dhe si pasojë e dëmtimeve është shkaktuar gjakderdhja e që ka pasur për pasojë vdekjen e menjëhershme të viktimës. Në rrethana si ishte zhvilluar ngjarja dhe motivet që i kishin paraprirë vrasjes, nuk rezulton se kemi të bëjmë me vrasje nga hakmarrja e paskrupullt. Gjykata e shkallës së parë, gabimisht i vlerësoi faktet, përkitazi me motivin dhe ky vlerësim i gabuar ka rezultuar me aplikimin e gabuar të ligjit në dëm të të akuzuarit (ngase vrasja është cilësuar si vrasje e kualifikuara me motive nga hakmarrja e paskrupullt) në çka, me të drejtë, tërheqin vërejtjen mbrojtësit, për arsytet si në vijim:

Rrethanë kualifikuese e kësaj forme të vrasjes paraqet fakti se vrasja është kryer nga hakmarrja e paskrupullt. Për ekzistimin e kualifikimit të këtillë të veprës penale, ligdhënësi nuk e konsideron të domosdoshme ekzistimin e çfarëdo hakmarrjeje si motivi i kryerjes së veprës penale të vrasjes, por kërkon një kualitet të veçantë të hakmarrjes, përkatësisht paskrupull sinë e saj. Kjo për faktin se hakmarrja vetvetiu nuk paraqet motiv të tillë negativ të veprës për ta cilësuar çdo vrasje nga hakmarrja si vrasje të kualifikuar. Në situata të tilla, hakmarrja si motiv i kryerjes së veprës penale të vrasjes, shqyrtohet në kuadër të rrethanave lehtësuese dhe rënduese, pa mundësi interferimi në kualifikimin e veprës. Mirëpo, nëse hakmarrja merr primesa të hakmarrjes së paskrupullt, cilësimi juridik i veprës ndryshon dhe merr formë të rëndë-kualifikuese.

Ekzistimi i hakmarrjes së paskrupullt është çështje faktike e cila nuk mund të vërtetohet në bazë të kritereve fikse të përcaktuara më parë (formulë mekanike), por që ekzistimi apo mos ekzistimi i saj, vlerësohet në kuadër të gjitha rrethanave objektive dhe subjektive që e kanë përcjellë kryerjen e vrasjes konkrete, me ç'rast, bazë fillestare për të vlerësuar paskrupullsinë e hakmarrjes, duhet të jenë dispozitat ligjore dhe normat morale të shoqërisë së caktuar.

Për të vlerësuar një hakmarrje si të paskrupullt nuk është vendimtar vetëm kriteri se e keqja që i është shkaktuar viktimës është më e madhe se e keqja që më herët i ishte shkaktuar kryesit apo familjes së tij nga ana e të vrarit, por vendimtare është që vrasja e cila kryhet për motive hakmarrëse, të kryhet ndaj atij personi dhe në rrethana të tilla që veprimet e kryesit i bëjnë haptas të paskrupullta (vrasja nga hakmarrja është kryer ndaj personit të tretë i cili nuk ka lidhje me të keqen e shkaktuar më herët për të cilën po kryhet hakmarrja, ndaj personit i cili është gjykuar apo liruar nga akuza, përkatësisht kur vrasja nga hakmarrja është kryer pas kalimit të një kohe të gjatë nga shkaktimi i të keqes, kur objektivisht hakmarrja më nuk do të mund të pritej etj). Tani në rastin konkret nuk rezulton se janë përmbushur kriteret që u elaboruan më parë, për ta vlerësuar vrasjen të kryer nga hakmarrja e paskrupullt. Nuk është kontestuese se në mes të dënuarit, tani të ndjerit dhe familjes së tij kishte konflikte (verbale edhe fizike), por këto konflikte në mes tyre nuk kishin prodhuar pasoja eventuale për asnjërën palë (nuk kishte ndonjë te keqe që do duhej të kthehej me një të keqe më të madhe), ata me ndërmjetësimin e njerëzve i kishin tejkaluar këto mosmarrëveshje dhe ishin pajtuar.

Pas secilës vrasje qëndron një motiv që e ka nxitë kryesin të kryejë vrasjen (jo çdo motiv i vrasjes konsiderohet hakmarrje). Në rastin konkret, rezulton se vrasjes i kanë paraprirë konfliktet që kishin mes vete i dënuari dhe i ndjeri, përkatësisht familjet e tyre, d.m.th., në situatën e tillë, fare nuk bëhet fjalë për vrasje nga hakmarrja, aq më pak nga hakmarrja e paskrupullt, siç gabimisht ka gjetur gjykata e shkalës së parë, dhe të cilin kualifikim e ka pranuar edhe Gjykata e Apelit. Mënyra e kryerjes së veprës penale dhe tendencat e të dënuarit që këtë vrasje ta hedhë në terrenin e pakujdesisë (si vrasje në lajthitje, gjatë

gjahut) tregojnë një dozë paskrupullsie të dënuarit, por në rrethana të tilla, nuk bëhet fjalë për hakmarrje.

(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme,  
Pml. nr. 220/2014 më 19 nëntor 2014)



Pml. nr. 249/2014

Datë 31.12.2014

### **Vepra penale e mashtrimit nga neni 261 par.2 i KPRK-s**

*Vepra penale e mashtrimit nga neni 261.par.2.të KPK-s, është kryer vetëm po qe se vlera e dëmit që i është shkaktuar të dëmtuarit tejkalon shumën prej 15000 €.*

#### **Nga arsyetimi**

Me të drejtë ceket në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të akuzuarit, se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e që ato juridikisht i bën të paqëndrueshëm.

Sipas dispozitivit të aktakuzës , prokurori i shtetit e ngarkon të akuzuarin për veprën penale të mashtrimit, të parashikuar nga neni 161 par. të KPRK-s, pa i theksuar elementet e veprës penale në dispozitiv.

Gjykata pa asnjë ndërhyrje e pranon një ndërtim të tillë të aktakuzës, pa i përmbajtur elementet që paraqesin strukturën (anatominë) e kësaj vepre penale. Ky aktgjykimi me formë dhe strukturë të tillë është i vështirë për t'u vlerësuar, dhe jo vetëm nga "arsyetimi", por edhe nga dispozitivi nuk mund fare të kuptosh se për çka bëhet fjalë. As nga dispozitivi i aktakuzës nuk mund të kuptohet qartë se cilat ishin veprimet mashtruese të të akuzuarit dhe kush është dëmtuar dhe në çmas është dëmtuar. Si në dispozitiv të aktgjykimit ashtu edhe në dispozitiv të aktakuzës përshkruhen transaksionet bankare, pagesa në një llogari pastaj tërheqja nga ajo llogari dhe vendosja në një llogari tjetër, mirëpo nuk janë konkretizuar qartë

veprimet - elementet e veprës penale të mashtrimit; në ç'drejtimit ishte mashtruar e dëmtuara, në dëm të cilës pasuri kishte vepruar dhe sa ishte dëmi i shkaktuar personave tjerë me këto veprime.

Veprën penale të mashtrimit nga paragrafi 1. i nenit 261 e kryhen kushdo që me qëllim për t'i sjellë vetes apo personit tjetër ndonjë dobi pasurore e mashtron ose e sjell personin tjetër në lajthim me anë të paraqitjes së rreme apo duke i fshehur faktet dhe me këtë e shtytë personin e tillë që të veprojë apo të mos veprojë në dëm të pasurisë së tij ose të pasurisë së ndonjë personi tjetër. Ndërsa vepra penale mund të kualifikohet sipas paragrafit 2. të neni 261, nëse dëmi i shkaktuar të dëmtuarit tejkalon shumën prej 15000 euro.

Gjykata e shkallës së parë por edhe përfaqësuesi i akuzës, veprën penale e cilëson sipas paragrafit 2. dhe përdorin shprehjen "dëm substancial", të cilën shprehje nuk e ka përdorë ligjdhënësi, nuk është element esencial i këtij paragrafi "dëmi substancial" por vetëm dëmi që kalon 15000 € d.m.th. në situatën e tillë dilet jashtë kornizës ligjore, duke e ndërtuar arbitrarisht një pasojë "dëmin substancial" të cilën pasoj nuk e parasheh fare norma ligjore. Me këtë veprim zgjerohet zona inkriminuese me elemente shtesë të cilat norma nuk i përmban, e që është në kundërshtim me parimin e legalitetit.

Vepra penale mund të cilësohet sipas paragrafit 2. vetëm atëherë kur lartësia e dëmit që i është shkaktuar të dëmtuarit me veprimet mashtruese të të akuzuarit tejkalon shumën prej 15000 €, dhe pa u vërtetuar kjo lartësi e dëmit nuk mund vepra penale të cilësohet sipas këtij paragrafi.

Te vepra penale me natyrë mashtruese duhet plotësohen kumulativisht dy kritere, pa të cilat nuk ka mashtrim. Së pari kryesi me prezantimin e rrejtshëm apo duke i fshehë faktet e ve në lajthim personin tjetër dhe si pasojë e këtij lajthimi ai vepron në dëme të pasurisë së vet apo të pasurisë së personit tjetër.

Roli mbrojtës i të drejtës penale është fragmentar dhe i mbron vetëm ato të drejta të domosdoshme për individin dhe shoqërinë të cilat

nuk janë të mbrojtura me degët tjera të së drejtës dhe jo çdo veprim i kundërligjshëm njëkohësisht është edhe vepër penale, nëse nuk i përmban edhe rrezikshmërinë (komponente materiale të kundërligjshmërisë) dhe elementet tjera të përcaktuara me ligj.

Nga ky aktgjykim për tani nuk rezulton se me cilat veprime i akuzuari e ka vënë në lajthim të dëmtuarën, (me prezantimin e rrejtshëm apo duke i fshehë faktet), pastaj nuk ka asnjë të dhënë në ç’ drejtim e dëmtuara për shkak të këtij lajthimi veproi në dëme të pasurisë së personave tjerë (kush janë ata persona, ata persona do duhej të deklarohen për dëmin që u është shkaktuar atyre) dhe në çka konsiston dëmi dhe lartësinë e saktë të dëmit. Dëmi duhet të jetë real i matshëm i kapshëm i pjesëtueshëm e jo “dëm substancial”, (këtë shprehje e kanë ndërtuar prokuroria dhe gjykata, nuk e parasheh norma ligjore!..).

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e vëna në pahë, veçmas duhet të vërtetoj se cilat ishin veprimet mashtruese të akuzuarit, kënd i kishte mashtruar, në dëme të pasurisë së kujt kishte vepruar i dëmtuar dhe sa ishte vlera e dëmit që ishte shkaktuar në këtë rast e më pas të marr vendim të drejt në këtë çështje penalo juridike.

Këto janë shkaqet për të cilat Gjykata Supreme, në mbështetje të nenit 438 par. 1 pika 1.2 të KPRK-s, anuloi aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë dhe atë të Apelit dhe çështjen ia ktheu për rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme,  
Pml. nr. 249/2014, më 31.12.2014)*



*Pml. nr. 67/2015  
Datë 09.07.2015*

**Tejkalimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme, nga neni 146.lidhur me nenin 12. par. 3. dhe 4. të KPRK-s- Bashkim veprash penale, të parashikuar nga neni 80 par. 1. të KPRK.**



*Fakti se i ndjeri është konfliktuar me të akuzuarin, (e ka fyer dhe shtyrë atë), nuk nënkupton sulm në kuptim të mbrojtjes së nevojshme, as tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, nëse ngjarjen që i ka paraprirë vrasjes, nuk e ka karakterizuar asnjë nga rrethanat që kërkohen të mbrojtja e nevojshme përkatësisht të tejkalimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme.*

*Kur i akuzuari me armë që e mbante me leje ka privuar nga jeta dikë, në rrethana të tilla vepra penale e përdorimit të armës, të parashikuar nga neni 328. par. 2. të KPRK-s, është konsumuar me veprën penale të vrasjes.*

### **Nga arsyetimi**

Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin P. nr. 10/2013 të datës 30.6.2014, të akuzuarin A. B. e ka shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale vrasje në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme nga neni 146 lidhur me nenin 8 par. 3 dhe 4 të KPRK dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 vitesh, në të cilin i ka llogaritur kohën e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 11.07.2012 e deri më 30.06.2014. I ka shqiptuar dënimin plotësues konfiskimin e armës "Glllok" si mjet i kryerjes së veprës penale. Të akuzuarin e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPRK.

Gjykata e Apelit e Kosovës në procedurën ankimore, me aktgjykimin PAKR. nr. 492/2014 të datës 30.10.2014 i ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, të dëmtuarve F dhe I. G., si dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, av. N.Q. kurse aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për krime të rënda, P.nr. 10/2013 të datës 30.6.2014. e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

1. Prokurori i Shtetit të Kosovës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par. 1 pika 2 lidhur me nenin 384 par. 1 lidhur me nenin 370 par. 7 të KPPRK, si dhe shkeljes

së Ligjit penal nga neni 432 par. 1 pika 1 të KPPRK me propozim që kërkesa të aprovohet dhe të konstatohet se Gjykata Themelore në Prizren me aktgjykimin, P.nr. 10/2013 të datës 30.6.2014, dhe Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PAKR. nr. 492/2014 të datës 30.10.2014 kanë bërë shkelje të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 par. 1 pika 2 të KPPRK dhe shkelje të Ligjit penal nga neni 432 par. 1 pika 1 të KPPRK.

2. Mbrojtësi i të dënuarit A. B., av. N.Q. për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljes së Ligjit penal në dëm të akuzuarit, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për krime të rënda, P. nr. 10/2013 i datës 30.6.2014 të ndryshohet në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 364 par. 1 nënpar. 1.1 të KPPRK dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, kurse aktgjykimin e Gjykatës së apelit të Kosovës, PAKR. nr. 492/2014 të datës 30.10.2014 në kuptim të nenit 438 par. nënpar. 1.2 ta anulojë si dhe të ndërpritet ekzekutimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

3. E dëmtuara F. G. për shkak të shkeljes së Ligjit penal, shkeljes esenciale të Ligjit të procedurës penale si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pa ndonjë propozim konkret.

### Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par. 1 lidhur me nenin 436 par. 1 të KPPRK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuara në kërkesa, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Prokurori i Shtetit sa i përket veprës penale të vrasjes, të parashikuar nga neni 146 lidhur me nenin 8 par. 3 dhe 4 të KPK-s (pjesa gjykuese), është e bazuar, lidhur me pjesën liruese e pabazuar, e mbrojtësit të dënuarit e pabazuar, ndërsa ajo e të dëmtuarës e pa lejuar.

## A. Bazueshmëria e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë lidhur me pjesën gjykuuese

Nuk del të jetë kontestuese fakti se ditën kritike në mes të patrullës së policisë, në përbërjen e të cilës ishte edhe i dënuari dhe një grup qytetarësh në mesin e të cilëve ishte edhe i ndjeri, ishte shkaktuar një konflikt banal (për t'i mbushur shishet me ujë) së pari verbal e pastaj kishte degraduar edhe në përleshje fizike në mes tyre. Nuk është kontestuese se akter kryesor i këtij konflikti ishte tani i ndjeri (ai e kishte provokuar dhe filluar debatin me policët), me tej del jo kontestuese fakti se të dënuarit i është tërhequr vërejtja se do t'i zbrazën shishet e mbushura me ujë, i dënuari është fyer dhe sharë nga qytetarët e më i zëshmi në mesin e qytetarëve të përfshirë në këtë konflikt ishte i ndjeri , pastaj nga i ndjeri është goditur me duar në supe. Nga ky konflikt banal është krijuar një situatë e nderë, objekt sharje dhe kacafytje nuk ishte vetëm i dënuari por edhe policët tjerë (të cilët gjithashtu ishin të armatosur), mirëpo asnjëri nga qytetarët duke përfshirë edhe tani të ndjerin nuk kishte armë të zjarra apo të ftohta sikundër dhe mjete tjera për t'i sulmuar policët (këto rrethana nuk janë kontestuese).

Në rrethana të tilla siç është zhvilluar ngjarja (zhvillimi i ngjarjes nuk kontestohet nga askush) nuk është përmbushur asnjë konditë ligjorë që kërkohet me ligj për tu cilësuar veprimi i të dënuarit si tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme, siç gabimisht ka gjetur gjykata e shkallës së parë, nga se nuk kishte sulm të intensiteti të tillë që ka rrezikuar integritetin trupor apo jetën e të dënuarit e as të kolegëve të tij që ishin në shoqërim me të, e që do impononte një mbrojtje të tillë ekstreme me përdorimin e armës siç ka vepruar i dënuari. Veprimet e të ndjerit dhe të qytetarëve të tjerë që ishin në shoqërim me të ndjerin ishin të pajustificueshme, provokuese dhe me një dozë të lartë arrogante karshi uniformave policore, por jo të natyrës së tillë që të justifikonin përdorimin e armës, aq më parë kur në këtë konflikt ishin të përfshirë policët të cilët posedonin edhe shkathtësi profesionale, pastaj edhe pajisje tjera defansive (sprej paralizues, shkop, kllapa etj.) edhe nën supozimin se edhe qytetarët tjerë po i sulmonin dhe nuk po mund ta shmangin sulmin, kanë pas mundësi të zgjidhni forma tjera alternative e jo të përdorin armën, po del se ata ranë pre e provokime-

ve të çastit . Sido që të jetë në rastin konkret nuk duhet anashkaluar veprimet e të ndjerit i cili provokoi konfliktin me pasoja fatale për të, mirëpo veprimet e t'ia eventualisht do mund të vlerësoheshin në kuadër të rrethanave të vrasjet e privilegjua dhe me rastin e matjes së dënimit. Veprimet e tani të ndjerit nuk kishin karakter të sulmit që kërkohet për mbrojtje të nevojshme, siç gabimisht ka konkluduar gjykata e shkallës së parë , atëherë në rrethana të tilla (mungesa e një sulmi me natyrë të tillë) nuk mund të bëhet fjalë as për tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme.

Nga arsyet e parashtruara më lartë, qartë rezulton se aktgjykimi në pjesën gjyquese është i përfshirë me shkelje të ligjit penal, të parashikuara nga neni 385. pika 1.4. të KPPK-s.

B. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e prokurorit të Shtetit për pjesën liruese është e pabazuar.

Nuk është kontestuese se i dënuari nuk ka pas arsye ligjore për ta përdor armën , pasi që sipas nenit 27 par. 1 të Ligjit për policinë Ligji nr. 04/L-076 zyrtari policor është i autorizuar të posedojë dhe ta bartë armën zyrtare të zjarrtë të lejuar nga policia dhe ta përdorë vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për ta arritur objektivin ligjor të policisë, kur përdorimi i saj është në proporcion me shkallën e rrezikut dhe seriozitetin e veprës penale, dhe vetëm nëse konsiderohet se me përdorimin e mjeteve më të vogla të forcës nuk do të arrihen objektivat legjitime të policisë. Mirëpo nuk është i mundur bashkimi i veprës penale të vrasjes me përdorimin e armës kur nga përdorimi i armës është shkaktuar vdekja e dikujt, dmth, në rastin konkret përdorimi i armës është konsumuar me veprën penale të vrasjes. Është i mundur bashkimi i veprës penale të vrasjes dhe armë mbajtjes pa leje, por jo edhe i vrasjes dhe përdorim i armës kur me përdorim është shkaktuar edhe vrasja. Në situatën kur përdorimi i armës ka shkaktuar pasojën konkrete, çfarëdo qoftë ajo (ka dëmtuar apo rrezikuar të mirën juridike) atëherë përdorimi është konsumuar me veprën konkrete që është realizuar në raste të tilla. Kryesi do mund të përgjigjej për posedim pa leje të armës (nëse e mban pa leje) dhe veprës penale konkrete që ka shkak-

tuar me përdorimin e armës, por jo edhe për alternativën tjetër që e parasheh norma “përdorimin e armës”. Nga arsyet e parashtruara më lartë rezulton e pabazuar kërkesa e prokurorit të shtetit se me aktgjykim e shkallës së parë është shkelë ligji në favor të pandehurit, kur ai është liruar nga akuza për veprën penale përdorimi i armës.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Pml. nr. 67/2015, datë 9.07.2015)*

### III. DREJTËSIA PËR TË MITUR - procedurë penale -

APM. nr. 10/2012

Datë 18.07.2012

#### **Dispozitivi i aktvendimit për shqiptimin e masës edukuese-neni 73 par. 3 të KDM**

*Dispozitivi i aktvendimit i marr në procedurën ndaj të miturit me të cilin shqiptohet masa edukuese, nuk përmban përshkrimin faktik të veprës penale e as cilësimin juridik të saj por këto jepen në arsyetim.*

#### **Nga arsyetimi**

Me aktvendimin e Gjykatës së qarkut në Gjilan PM.nr.1/2012 të datës 25.04.2012 ndaj të miturit V. S. për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPRK, është shqiptuar masa edukuese e dërgimit në institucionin edukativo korrektues në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilën masë i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 30.12.2011 deri më datën 10.02.2012 (edhe pse sipas nenit 73 të KPRK, paraburgimi nuk llogaritet në masën edukuese). Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale bijnë në barë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të miturit, avokati M. M. nga Gj., për shkak të masës së shqiptuar me propozim që i njëjti të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit, Gjykata Supreme, me rastin e kësaj ankesë konstatojë aktvendimi i shkallës së parë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par. 1 pika 12 të KPPRK lidhur me nenin 5 të KDM.

Aktvendimi nuk përmban arsye për faktet vendimtare.

Konform dispozitës së nenit 73 par.3 të KDM, arsyetimi i aktvendimit me të cilin të miturit i është shqiptuar masa edukuese, përmban përshkrimin e veprës penale dhe rrethanat të cilat e arsyetojnë shqiptimin e masës edukuese.

Mirëpo, në rastin konkret, aktvendimi nuk përmban përshkrimin faktik të veprës penale - kohën dhe vendin e ngjarjes dhe veprimet inkriminuese e të miturit, ashtu që nuk kuptohet se për çka i mituri është gjykuar, cilat janë veprimet konkrete të tij dhe që një arsyetim me këtë mangësi e bënë aktvendimin e shkallës së parë të pakuptueshëm dhe juridikisht të paqëndrueshëm. Kjo aq më tepër kur dihet se nëse të miturit i shqiptohet masa edukuese, përshkrimi i veprës penale nuk jepet as në dispozitiv, ashtu që nuk mund të kuptohet se cilat kanë qenë veprimet konkrete inkriminuese e të miturit dhe rrethanat tjera, siç janë pasoja e shkaktuar por edhe rrethanat tjera që ndikojnë në marrjen e vendimit të ligjshëm, gjegjësisht për aplikimin e drejt të ligjit material. Shkelja e lartë përshkruar (bashkë me ca shkelje tjera) kushtëzoi anulimin e aktvendimit të shkallës së parë.

*(Aktvendimi i Gjykatës Supreme,  
APM. nr. 10/2012, Datë 18.07.2012]*



*APM. 17/2012  
Datë 08.11.2012*

### **Kushtet ligjore për shqiptimin e dënimit ndaj ekzekutorit të mitur-neni 33 të Kodit të drejtësisë për të mitur**

*Për të shqiptuar dënimin me burgim për të mitur, duhet të plotësohen të gjitha kushtet nga neni 33. të Kodit të drejtësisë për të mitur, në mënyrë kumulative.*

### **Nga arsyetimi**

Me aktgjykimin e Gjykatës së qarkut në Pejë PM. nr. 11/2008 të datës 03.07.2012 i mituri A.J. është shpallur përgjegjës për veprat penale

vrasje e rënd në tentativë nga neni 147 pika 11 lidhur me nenin 20 të KPK dhe mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPRK, dhe është gjykuar me dënim burgimi për të mitur në kohëzgjatje prej 14 (katërmëdhjetë) muajve, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 28.05.2008. deri më datën 16.07.2008. Të miturit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues i marrjes së armës si mjet me të cilin është kryer vepra penale. Është vendosur që i mituri të lirohet nga obligimi i pagimit të shpenzimeve të procedurës penale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të miturit, avokati H. Ç. nga D., për shkak të vendimin për sanksionin penal, me propozim që aktgjykimi të ndryshohet ashtu që të miturit të shqiptohet një dënim me i butë.

Gjetjet e Gjykatës Supreme janë si në vijim:

Kodi i drejtësisë për të mitur e as Kodi i procedurës penale i Kosovës, nuk parashohin institucionin e “shpalljes përgjegjës” të ekzekutorit të veprës penale, ashtu që me faktin se i mituri është shpallur përgjegjës, dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe kjo paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403 par. 1 pika 12 të KPPRK dhe për pasojë pat anulimin e aktgjykimit të shkallës së parë sipas detyrës zyrtare.

Për të shqiptuar dënimin me burgim për të mitur, duhet plotësohen të gjitha kushtet nga neni 33 të Kodit të drejtësisë për të mitur, në mënyrë kumulative. Këto kushte janë që i mituri, në kohën e kryerjes së veprës penale të ketë arritur moshën 16 vjeçare, vepra penale të jetë e dënueshme me mbi 5 vjet burgim dhe që shqiptimi i masës edukuese nuk do të ishte adekuat për shkak të peshës së veprës penale, pasojave të saj dhe shkallës së përgjegjësisë penale të miturit. Andaj, edhe në rast se janë plotësuar kushtet përkitazi me moshën e të miturit, pasojën e shkaktuar dhe shkallën e përgjegjësisë penale të tij, ky dënim shqiptohet vetëm nëse shqiptimi i masës edukuese nuk do të ishte adekuat. Në rastin konkret, në aktgjykimin e shkallës së parë nuk janë dhënë arsyet për atë se a qëndrojnë të gjitha këto elemente të



cilat ligji i kërkon, ashtu që mungesa e arsyeve për këtë fakt relevant paraqet shkelje të lartë përmendur të dispozitave të procedurës penale dhe aktgjykimin e bënë ligjrisht të paqëndrueshëm.

*(Aktvendimi i Gjykatës Supreme,  
APM. 17/2012, Datë 08.11.2012)*



**Praktika gjyqësore e  
EULEX-it**



## I. PROCEDURË PENALE

*PML-KZZ. 145/2014*

*Datë 08.10.2014*

**Afati për ushtrimin e mjetit juridik rrjedh nga dita e dorëzimit të shkresës të pandehurit. Neni 189 paragrafi 3 i KPPRK-së, neni 478 paragrafi 4 i KPPRK-së, neni 445 paragrafi 1 i KPPRK-së**

### Nga arsyetimi

Është marr vendim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit më 4 korrik 2014 kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN1. 1215/2014, të datës 27 qershor 2014, është e bazuar. Me këtë aktvendim Gjykata e Apelit ka bërë shkelje të ligjit penal, neneve 189 paragrafit 3 dhe 478 paragrafit 4 të KPP-së, kur ka pranuar ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit kundër urdhrorit mbi vazhdimin e paraburgimit si të paraqitur me kohë.

Faktet dhe çështja e lëndës

3.2 Kolegji vëren se aktvendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake ... i datës 18 qershor 2014, më të cilin është pranuar kërkesa e prokurorit dhe është urdhëruar vazhdimi i paraburgimit, i është dorëzuar të pandehurit më 19 qershor 2014 dhe avokatit mbrojtës më 23 qershor 2014. Avokati mbrojtës ...ka paraqitur ankesë më 24 2014 në emër të pandehurit S.. Vetë i pandehuri nuk ka paraqitur ankesë.

3.3 Gjykata e Apelit ka konsideruar se ankesa është paraqitur me kohë, por e ka refuzuar si të pabazuar.

3.4. Prandaj, çështja në këtë lëndë është: A ka qenë ankesa në emër të pandehurit S. nga avokati i tij mbrojtës e paraqitur me kohë duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura.'

## Vlerësimi

3.9 Së pari, kolegji i Gjykatës Supreme thekson se rregullat e përcaktuara në nenet 189 paragrafin 3 dhe 478 paragrafin 4 të KPP-së janë të qarta: afati për paraqitjen e ankesës kundër aktvendimit mbi caktimin e paraburgimit është 24 orë, dhe rrjedh nga data kur aktvendimi i është dorëzuar të pandehurit. Për më tepër, neni 445 paragrafi 1 i KPP-së fuqizon natyrën absolute të këtij afati kohor’

‘3.13 ... Kolegji i Gjykatës Supreme gjen se në këtë lëndë, avokati mbrojtës ka paraqitur ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 18 qershor 2014 pas skadimit të afatit të përcaktuar kohor për paraqitjen e ankesës. Asgjë nuk jep indikacione se i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës kanë qenë të penguar që në mënyrë efektive ta përdorin të drejtën e tyre në ankesë brenda afatit kohor’.

‘3.14 ... Kolegji i Gjykatës Supreme gjen se nuk është e hapur për Gjykatën e Apelit që ta zëvendësojë legjislacionin e formuluar në mënyrë të saktë dhe të qartë me një shpikje të tyre’.

*Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës,  
PML-KZZ. 145/2014 , 8 tetor 2014)*



*PML.-KZZ. 1/2014*

*Datë 7.05.2014*

**Krime të luftës të kryera nga UÇK-ja- nenit 3 të KGj (Konventa e Gjenevës) - Krimet e kryera në shtetin fqinj - neni 3 KGj**

### **Nga arsyetimi**

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës K në emër të pandehurit R, nga avokati mbrojtës Q në emër të pandehurit R, kundër aktgjykimeve të (atëherë) Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 29 korrik 2011 (për R) dhe 13 tetor 2011 (për R),

dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 11 shtator 2013, refuzohen si të pabazuara. Aktgjykimet e lartpërmendura nuk ndryshohen në bazë të këtyre kërkesave.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës H në emër të pandehurit G kundër aktgjykimit të (atëherë) Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 29 korrik 2011 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 11 shtator 2013, pranohet pjesërisht. Aktgjykimi i (atëherë) Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 29 korrik 2011 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 11 shtator 2013, ndryshohen për pjesën e G, si në vijim:

...

Pjesa e mbetur e kërkesës refuzohet si e pabazuar.

'3.9 ... Gjykata Supreme fillimisht thekson se në formulimin e nenit të përbashkët 3 të KGj-së nuk ekziston asnjë kusht që vepra/t penale të ndodhin në zonën territoriale të konfliktit në zhvillim e sipër ose në zonën nën kontrollin e njëres palë në konflikt.

Së dyti, formulimi i cituar në nenin e përbashkët 3 të KGj-së qartë pohon se aktet janë të ndaluara 'në çdo vend dhe në çdo kohë'. Së treti, i tërë qëllimi i KGJ-së përkrah një interpretim të gjerë në çështjen e zbatimit të tij. Prandaj, përfundimi është se obligimet e palëve në konflikt nuk kufizohen në zonë territoriale specifike, por vlejnë për të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me konfliktin, kudo që ndodhin.

Tani është me rëndësi lidhja në mes akteve të pretenduara të të akuzuarve dhe konfliktit të armatosur. Nëse lidhja nuk dëshmohet, atëherë nuk janë plotësuar elementet e krimeve të luftës kundër popullsisë civile (Neni 142 KPRSFJ).

Gjykata e Qarkut i ka dhënë arsyet për vërtetimin e ekzistimit të lidhjes (...). Gjykata Supreme vëren se argumentet e paraqitura (kryerësit duke qenë pjesëtarë të UÇK-së, supozimi se viktimat kishin simpati për palën kundërshtarë ose se pala kundërshtarë kishte bashkëpunuar me ta, veprat e pretenduara ishin kryer për shkak të kësaj simpatie

të supozuara, ekzistimi dhe qëllimi i kampeve të UÇK-së në Kukës dhe në Cahan) janë relevante dhe në këto fakte mund të mbështetet ekzistimi i lidhjes. Nuk ka asnjë dyshim se veprat kanë ndodhur në lidhje me konfliktin e armatosur.

*Aktgjykimi i Gjykatës Supreme,  
PML.-KZZ. 1/2014, 7 maj 2014)*



## II. KODI PENAL

*PML-KZZ. 83/2014*

*Datë 31.07.2014*

### **Krim i organizuar në bashkim dhe krimi bazë - Nenet 71 dhe 274 të KPPK-së**

#### **Nga arsyetimi**

‘Nëse vepra penale e Krimit të organizuar duhet të absorbojë veprën penale të Pastrimit të parave

o. Shumica e kolegjit është e mendimit se qëndrimi i Gjykatës Supreme përkitazi me këtë është se, kur Krimi i organizuar dhe vepra penale bazë të dyja janë përcaktuar në ligj, duhet të ketë vetëm një dënim për Krim të organizuar në lidhje me veprën penale bazë. Në këtë rast i pandehuri P. duhet të dënohet për Krim të organizuar në lidhje me Pastrimin e parave, sikurse ka menduar Gjykata e Apelit.

p. Në mbështetje të kësaj, Gjykata Supreme citon gjetjen në lëndën nr. Ap-Kz 61/2012 në aktgjykimin e datës 2 tetor 2012. Në paragrafin 48, Gjykata Supreme ka theksuar se, ‘Formulimi i përdorur në tërë nenin 274 të KPK-së në mënyrë të qartë përcakton se kryerja e veprës penale bazë është element përbërës i veprës penale Krim i organizuar.’ Në këtë parim të jurisprudencës është mbështetur Gjykata e Apelit në këtë lëndë dhe Gjykata Supreme nuk sheh asnjë arsye që të mos pajtohet me këtë vlerësim’.

Andaj, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga prokurorja e shtetit kundër aktgjykimin të Gjykatës së Apelit PAKR 4/2013 më 23 shtator 2013, refuzohet si e pabazuar

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme,  
PML-KZZ. 83/2014, 31 korrik 2014)*

PML-KZZ. 161/2014

Datë 19.08.2014

**Imuniteti i deputetit të Kuvendit Kombëtar nga arrestimi dhe pasojat e shkeljes; res judicata efekti lidhur me aktvendimin (f.11, 14, par 9, 17)- Neni 173 paragrafi 3, 187 paragrafi 1, neni 192 i KPP-së, neni 75 paragrafi 2 i Kushtetutës së Kosovës.**

### **Nga arsyetimi**

*(Prokuroria nuk mund ta anashkalojë/ turbullojë aktvendimin për lirim të pandehurit nga paraburgimi dhe shqiptimin e masës më të lehtë me anë të një urdhër arresti të ri, duke u bazuar në rrethanat e njëjta të parashkruara në kërkesën për paraburgim të refuzuar më parë (f. 12, 14, par 11, 18); rëndësia e sigurisë ligjore në të gjitha vendimet me ndikim në lirinë e të pandehurit (par 18).*

1. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga i pandehuri R. pranohet.
2. Aktvendimi i Gjykatës Themelore i datës 21 qershor 2014 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit i datës 25 qershor 2014 përkritazi me të pandehurin R. janë të pavlefshme.
3. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit i datës 19 qershor 2014 në lidhje me të pandehurin R. mbetet në fuqi deri në skadimin e tij më 4 shtator 2014, ose deri në ndryshimin apo anulimin e tij në përputhje me ligjin
4. Aktvendimi i Gjykatës Themelore i datës 18 korrik 2014 dhe Aktvendimi i Gjykatës së Apelit i datës 24 korrik 2014, të cilët kanë pasuar aktvendimet e cekura nën pikën 2 përkritazi me të pandehurin R. janë të pavlefshme. Masat e caktuara kundër tij me këto aktvendime janë ligjërisht të paefektshme dhe nuk do të zbatohen ndaj tij.

5. ...

## 'i. Historia e procedurës

5 shkurt 2014 - i pandehurin është arrestuar. I pandehuri R. në kohën e arrestimit ishte Deputet i Kuvendit.

6 shkurt 2014 - Është caktuar paraburgimi

5 mars 2014 - Paraburgimi është vazhduar

7 maj 2014 - Kuvendi i Kosovës është shpërbërë

4 qershor 2014 - Paraburgimi është vazhduar deri më 20 korrik 2014

19 qershor 2014 - Gjykata e Apelit, duke vendosur në lidhje me ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit R., ka urdhëruar lirim të menjëhershëm të pandehurit nga paraburgimi. Ka gjetur se arrestimi dhe paraburgimi janë caktuar në mënyrë të kundërligjshme. Kjo për shkak se në kohën e arrestimit i pandehuri ka qenë Deputet i Kuvendit të Kosovës dhe nuk ishte kërkuar pëlqimi nga ai organ sipas nenit 75 (2) të Kushtetutës së Kosovës.

20 qershor 2014 - Pas lirit, i pandehuri R. është arrestuar përsëri nga Prokurori Special i cili rrjedhimisht ka paraqitur kërkesë të re për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit.

21 qershor 2014 - Gjyqtari i procedurës paraprake ka caktuar një muaj paraburgim ndaj të pandehurit.

25 qershor 2014 - Gjykata e Apelit ka refuzuar ankesën e paraqitur në emër të pandehurit R. si të pabazuar dhe ka vërtetuar aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake të datës 21 qershor 2014

18 korrik 2014 - Gjykata Themelore në Prishtinë ka ndërprerë masën e paraburgimit në lidhje me të pandehurin R., dhe e ka zëvendësuar atë me arrest shtëpiak

18. Prandaj ky kolegji gjen se masat e shqiptuara nga Gjykata e Apelit

më 19 qershor 2014 kundër të pandehurit R ishin në fuqi dhe prokurori si dhe gjyqtari i procedurës paraprake dhe Gjykata e Apelit nuk mund t'i shpërfill. Kërkohet të paraqiten rrethana dhe fakte të reja për ta zëvendësua masën, dhe këto nuk janë paraqitur. Prandaj, aktvendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake i datës 21 qershor 2014 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit i datës 25 qershor 2014 kanë bërë shkëlqje të fuqisë juridike të aktvendimit të datës 19 qershor 2014 dhe duhet patjetër të konsiderohet i paligjshëm. Kur kemi të bëjmë me privim të lirisë është veçanërisht me rëndësi të plotësohet parimi i përgjithshëm i sigurisë juridike. Prandaj është thelbësore që të përcaktohen qartë kushtet për privimin e lirisë sipas ligjit vendor dhe që vetë ligji të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij si dhe pasojat e vendimit në zbatimin e tyre. Përndryshe, do të shkelej parimi i respektimit të zbatimit të ligjit, i sigurisë juridike dhe i parashikueshmërisë.

19. Kolegji i Gjykatës Supreme është i ndërgjegjshëm se aktvendimi i Gjykatës Themelore i datës 18 korrik 2014 aktvendimi i Gjykatës së Apelit i datës 24 korrik 2014, që kolegji i konsideron si të paligjshme dhe prandaj si të pavlefshme, nuk janë brenda kufijve të shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë. Megjithatë, nëse Gjykata Supreme nuk ka ndërmarrë veprim në lidhje me këto aktvendime atëherë i pandehuri do të ishte ligjërisht i detyruar t'u bindet dy masave të veçanta njëkohësisht. Shqetësimi i kolegjit është se respektimi i njëres masë mund të qojë deri te shkelja e masës tjetër. Kjo do të ishte shkëlqje e të drejtave të të pandehurit për të ditur se çka pritet nga ai. Nëse këto aktvendime Gjykata Supreme i lë ashtu si janë, atëherë i pandehuri R do të jenë në situatë të pafavorshme, që është krejtësisht e padëshirueshme. Pasi u konstatua se aktvendime e datave 21 qershor dhe 25 qershor 2014 janë të paligjshme, kolegji gjen se edhe aktvendimet e 18 dhe 24 korrikut 2014 janë të pavlefshme, dhe se nuk kanë asnjë fuqi juridike, dhe nuk mund të zbatohen ligjërisht ndaj të pandehurit R.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës,  
PML-KZZ. 161/2014, 19 gusht 2014)*

*PML.-KZZ. 177/2014*

*Datë 03.09.2014*

**Terrorizmi; Shteti Islamik (SHI) - Dyshim i bazuar, i arsyetuar kënaqshëm nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit.- Neni 135 paragrafët 1 dhe 4, 143 paragrafi 2 i KPRK-së<sup>1</sup>**

### **Nga arsyetimi**

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur në emër të të pandehurit refuzohet si e pabazuar.

Kolegji i Gjykatës Supreme ka vendosur në seancë siç përcaktohet me nenin 435 paragrafin 1 të KPP-së<sup>2</sup>.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme por e pabazuar.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur nga personi i autorizuar dhe brenda afatit të përcaktuar ligjor, në përputhje me nenin 433 paragrafin 1 dhe 2 të KPK-së.

Në pajtim me nenin 436 paragrafin 1 Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore që pretendohen me kërkesë.

Gjykata Supreme është e kënaqur se aktvendimet e kundërshtuara i plotësojnë kushtet ligjore për vërtetimin e nivelit të dyshimit të bazuar se i pandehuri T ka kryer veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist në kundërshtim të nenit 143 paragrafit 2 të KPK-së. Gjersa të dy aktvendimet, ai i Gjykatës Themelore në Ferizaj PPRKR. 22/2014, i datës 25 korrik 2014, (i korrigjuar me aktvendimin për korrigjimin e gabimit teknik, të datës 29 korrik 2014), dhe ai i Gjykatës së Apelit PN1. 1476/2014, i datës 2 gusht 2014, që vërtetojnë vendimin

---

1 Ligji Nr. 04/L-082, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19, 13 korrik 2012

2 Ligji Nr. 04/L-123, i lëshuar më 13 dhjetor 2012, i nxjerrë më 21 dhjetor 2012, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 37, 28 dhjetor 2012

e lartpërmendur, si të vetme nuk provojnë në masë të madhe, por më shumë i referohen vendimeve të mëparshme, dy aktvendimeve të tjera të kundërshtuara të Gjykatës Themelore të datës 16 korrik 2014 dhe të atij të Gjykatës së Apelit të datës 25 korrik 2014, dhe me vërtetimin e aktvendimit të Gjykatës Themelore kanë argumentuar pikën e kundërshtuar në thellësi, bindshëm dhe ligjërisht saktë.

Të dy aktvendimet kanë shtjelluar se shprehja “grup terrorist” dhe “terrorizëm” janë të definuar me nenin 135 paragrafin 4 dhe 1 të KPK-së dhe se vlerësimi nëse një grup i plotëson kriteret e dispozitave të përmendura është i rezervuar për gjykatën kompetente. Neni 135 paragrafi 1 i KPK-së në veçanti e cilëson veprimin me qëllim.

“... që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare ...”  
si terrorizëm.

Prandaj i pandehuri gabon kur argumenton se Kodi Penal i Kosovës i përjashton strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të shteteve të tjera. Logjika prapa përfshirjes së institucioneve të huaja në mbrojtje është - siç është sqaruar drejt në aktvendimin e Gjykatës Themelore PPRKR. 22/2014, të datës 16 korrik 2014, në faqen 13, paragrafin 5 të versionit në gjuhën angleze - niveli i lartë i rrezikut si pasojë e planifikimit ose e kryerjes së këtyre akteve dhe për shkak të vetë natyrës së tyre. Ky rrezik shtrihet edhe në institucionet vendore të Kosovës, pasi që historia ka treguar se grupet terroriste që operojnë jashtë shtetit si dhe personat që marrin pjesë në grupe të tilla kanë tendencë që shpesh t'i zgjerojnë aktivitetet e tyre kundër institucioneve dhe strukturave vendore.

Në rastin konkret të grupit radikal - islamik ISIS (Shteti Islamik) i pandehuri dyshohet për pjesëmarrje, është shumë e dukshme nga agjenda e saj politike dhe nga metodat e saj se kërcënimi nuk është i kufizuar në shtetin e Sirisë. Ky grup është duke e përhapur në rrafsh ndërkombëtar idenë e themelimit të një shteti të unifikuar Islamik për të gjithë Myslimanët përmes dhunës dhe ndryshimit të kufijve ekzistues. Është e qa-

rtë se kjo agjendë paraqet kërcënim mjaft konkret edhe për strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të shtetit laik të Kosovës, që sipas nenit 8 të Kushtetutës së saj:

“... është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.”

Dyshimi i bazuar po ashtu përfshin edhe mens rea e të pandehurit. Është e parëndësishme se vetë i pandehuri e konsideron qëllimin e grupit si të drejtë dhe legjitim. Ai ishte shumë i vetëdijshëm se ishte duke marrë pjesë në grup që ka për qëllim kryerjen e akteve terroriste, siç renditen në nenin 135 paragrafin 1 të KPK-së.

Gjykata Themelore e Ferizajt si dhe Gjykata e Apelit në aktvendimet e tyre të kundërshtuara me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kanë bërë vlerësim të plotë të fakteve dhe të provave të paraqitura nga prokurori i shtetit në lidhje me veprën e përmendur penale dhe kanë ardhur në përfundim të drejtë se ekziston dyshimi i bazuar kundër të pandehurit. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se aktvendimet e kundërshtuara në këtë aspekt nuk përmbajnë gabime juridike.

Për arsytet e lartpërmendura, Gjykata Supreme vendos lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si në dispozitiv.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme,  
PML.-KZZ. 177/2014, 3 shtator 2014)*





**Praktika gjyqësore**  
**CIVILE**



## I. PROCEDURË KONTESTIMORE

Rev. nr. 302/2013

Datë 6.1.2014

### **Shkelje thelbësore të dispozitave të Procedurës Kontestimore - Dispozitivi i Aktgjykimit - neni 182 .2 LPK**

*Në qoftë se gjykata në dispozitiv të aktgjykimit të saj urdhëron të paditurin që paditësit t'ia dorëzojë pjesën e ngastrës kontestuese në dimensione dhe kufinje sipas skicës së ekspertit të gjeodezisë, bënë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n), pasi që një vendim i tillë nuk mund të përmbarohet.*

#### **Nga arsyetimi**

Në rastin konkret, në bazë të përmbajtjes së dispozitivit të aktgjykimit, gjykata e shkallës së dytë duke ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe janë të detyruar të paditurit që paditësit t'ia kthejnë në posedim dhe disponim të lirë pjesët nga ngastrat kadastrale P-71611042-00146-2, e cila gjendet në vendin e quajtur "Sello", me kulturë arë e klasit të IV-të të evidentuar në certifikatën e pronësisë UL-71611942-0022 Z.K. Kliqinë, Komuna e Pejës si pronë e paditësit dhe atë: i padituri i parë sipërfaqen prej 0.03,00 ha dhe i padituri i dytë sipërfaqen prej 0.12.85 ha me kufijtë dhe anët e paraqitura si në raportin e ekspertit të gjeodezisë. Raporti i ekspertit të gjeodezisë SH.K. nga data e daljes në vendshikim më 30.5.2011, është pjesë përbërëse e aktgjykimit me interes të përmbarimit të tij.

Sipas vlerësimit të gjykatës së revizionit, aktgjykimi i shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika (n) të LPK-së e kjo qëndron në faktin se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë është i pakuptueshëm përkatësisht i pa përmbarueshëm, ngase dispozitivi i aktgjykimit me të cilin detyrohen të paditurit t'ia kthejnë paditësit në posedim pjesët nga ngastra P-71611042-00146-2, duhet të jetë qartë i

përcaktuar ashtu që t'i përmbajë masat dhe kufijtë. Meqë dispozitivi i aktgjykimit të goditur nuk përmban masat dhe kufinj të pjesëve të ngastrave kadastrale, me të cilën të paditurit janë të detyruar t'i dorëzojnë paditësit, nuk mund të identifikohet dhe për këtë arsye aktgjykimi është i pakuptueshëm dhe praktikisht i papërmbarueshëm. Konstatimi i gjykatës së shkallës së dytë, se pjesë përbërëse e aktgjykimit është raporti i ekspertit të gjeodezisë, dispozitivin e bën të pakuptueshëm dhe të papërmbarueshëm pasi që dispozitivi i aktgjykimit në kuptim të nenit 160 të LPK-së duhet të përmbajë të gjitha elementet sipas dispozitës së cekur.

Gjykata e shkallës së parë duhet t'i mënjanojë të metat e sipërpërmendura, ta bëjë identifikimin e ngastrave kontestuese, duke përcaktuar kufinj të cilat në mënyrë të qartë duhet të shënohen në dispozitiv të aktgjykimit.

*(Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 302/2013 datë 6.1.2014)*



*E. Rev. nr. 43/2014  
Datë 22.9.2014*

### **Lejushmëria e Revizionit - regresimi dëmit - neni 508 LPK**

*Me dispozitën e nenit 508 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashikohet që revizioni nuk lejohet në kontestet tregtare në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesë e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk kalon shumë prej 10.000 €.*

### **Nga arsyetimi**

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.169/2013 datë 28.4.2014, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë - Departamenti Ekonomik, C. nr. 577/2012 datë 11.9.2013, me të cilin në pjesën

e I të dispozitivit është aprovuar kërkesëpadia e paditëses dhe është obliguar e paditura, që paditëses të ia paguaj në emër të regresimit të dëmit shumën e mjeteve prej 6.952,88 €, së bashku me kamatën sipas normës vjetore prej 20% e cila do të llogaritet nga datë 31.8.2009, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, ndërsa me pjesën II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditëses t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.056,00 €, në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga shkresat e lëndës del se vlera e kontestit në padinë e paditëses të dorëzuar në gjykatë më datë 22.9.2011 është 7.143,71 €, ndërsa e njëjta vlerë është zbritur në shumë prej 6.952,88 €, me parashtrësën për precizimin e lartësisë së kërkesëpadiisë të datës 13.9.2013, ndërsa me aktgjykimin e formës së prerë të goditur me revizion vlera e kontestit është caktuar në shumë prej 6.952,88 €.

Me dispozitën e nenit 508 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), parashikohet që revizioni nuk lejohet në kontestet tregtare në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesë e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk kalon shumën prej 10.000 €.

Duke pasur parasysh faktin se vlera e objektit të kontestit në këtë çështje kontestimore është caktuar në shumë prej 6.952,88 €, me parashtrësën e paditëses të datës 13.9.2013, dhe e njëjta është aprovuar me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës së shkallës së parë, del se lartësia e përcaktuar e kërkesë padisë nuk kalon shumën e paraparë me dispozitën e nenit 508 të LPK-së, çka do të thotë se sipas kësaj dispozite revizioni në këtë çështje juridike nuk është i lejuar dhe si i tillë u deshtë të hidhet poshtë.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 221 lidhur me nenin 505 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
E. Rev. nr. 43/2014, më 22.9.2014)*

Rev. nr. 11/2015

Datë 2.4.2015

## **Mungesa e interesit juridik - neni 2 par. 4 Ligji mbi Procedurën Kontestimore**

*Pala duhet të ketë interes juridik për padinë dhe veprimet procedurale tjera që mund të kryhen në procedurë.*

### **Nga arsyetimi**

Nga shkresat e lëndës del se paditësi të e paditura ka qenë në marrëdhënie pune - i caktuar në detyrat e punës drejtor i "Agrokosova Holding". Me vendimin e administratorit datë 17.4.2008 është suspenduar nga puna dhe detyrat e punës. Me vendimin e të paditurës datë 22.4.2008 bashkë- administratori ka shfuqizuar si të pabazuar dhe të kundërligjshëm vendimin e datës 17.4.2008, për suspendim nga puna dhe detyrat e punës për paditësin. Paditësi me padi i është drejtuar gjykatës që të anulojë vendimin e datës 17.7.2008 mbi suspendimin nga puna dhe t'ia njohë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulët është i drejt dhe i bazuar në ligj, ngase paditësi kërkon anulimin e një vendimi i cili është shfuqizuar nga e paditura, ndërsa me nenin 2 par. 4 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore është paraparë se pala duhet të ketë interes juridik për padinë dhe veprimet procedurale tjera që mund të kryhen në procedurë.

Gjykata Supreme e Kosovës , shqyrtoi pretendimin e cekur në revizion se paditësi edhe përkundër shfuqizimit të vendimit për suspendim nga puna ende nuk është kthyer në punë , për shkak të mosmarrëveshjeve në mes aksionarëve, por e njëjta nuk patë ndikim për të vendosur ndryshe, ngase Ligji mbi Procedurën Kontestimore (neni 1) cakton rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhënia juridiko - civile të personave fizikë dhe juridikë, ndërsa në rastin konkret objekt i kontestit është një aktvendim i shfuqizuar nga e paditura dhe çështja sipas padisë së

paraqitur nuk mund të trajtohet si kontestimore në mes palëve. Një person nuk mundet të shfrytëzoi gjykatën për interesat e veta personale, por çështja e paraqitur pran gjykatës duhet të jetë një çështje që ndërlidhet me një të drejtë të paraparë me lig që kërkohet nga pala dhe që është shkelur, ndërsa si pasojë juridike e shkeljes së parimit të ekzistimit të interesit juridik padia duhet të hedhet poshtë si e palejuar.

Në rastin konkret, paditësi nuk ka kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tij para organit kompetent tek e paditura, që e njëjta të veproi sipas vendimit të saj me të cilin është shfuqizuar vendimi për suspendim nga puna, andaj gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore kur kanë gjetur se padia duhet të hedhet si e palejuar. Gjykata Supreme e Kosovës, thëniet e revizionit i vlerësoi si të pabazuara se aktvendimet e gjykatave të instancës më të ulët, janë marrë me shkelje procedurale, përkatësisht me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, sepse në fakt nuk kemi të bëjmë me zbatimin e të drejtës materiale, kur padia hidhet për shkak të mungesës së prezumimeve procedurale për paraqitjen e padisë, përkatësisht zhvillimin e procedurës.

*(Aktvendim i Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 11/2015, Më 2.4.2015)*

## II. MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

Rev. nr. 246/2010

datë 21.02.2013

**E drejta e përparësisë së blerjes - Deponimi i shumës në lartësinë e çmimit të shitblerjes - neni 19 të Ligjit mbi qarkullimin e paluajtshmërive, (Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 45/1, 29/86 dhe 8/88)**

*Titullarit të përparësisë së blerjes së paluajtshmërisë të cilit nuk i bëhet oferta me shkrim, mund të kerkojë nga gjykata me padi që kontrata mbi shitblerjen të anulohet dhe atij t'iu shitet paluajtshmëria sipas kushteve të njëjta. Mirëpo, titullari i së drejtës së përparësisë së blerjes ka për obligim që brenda afatit të paraqitjes së padisë, për shkak të cenimit të përparësisë së blerjes, të gjykata në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme, të deponojë shumën në lartësinë e çmimit të shitblerjes.*

### Nga arsytimi

Paditësit janë pronarë të paluajtshmërive 691/2, 692/3 dhe pjesës së paluajtshmërisë 745/5, të cilat pjesërisht kufizohen me paluajtshmëri 691/2, 693/3, 734/5, 749/10, 750/1, 750/2 dhe 751, të cilat i padituri i parë M.L. ka shitur të paditurit të dytë A.K. në bazë të kontratës së shitblerjes së vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Istog Br.nr. 427/04 datë 15.3.2004. Meqenëse paluajtshmëritë të cilat kanë qenë objekt i kontratës mbi shitblerjen lidhur në mes të paditurve janë me kulturë tokë bujqësore dhe kufizohen me paluajtshmëritë e paditësve, paditësit pretendojnë se kanë të drejtën e përparësisë së blerjes.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, në vendosjen në këtë çështje juridike, gjykatat e instancës më të ulët, në mënyrë të drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale, kur është konstatuar se në bazë të nenit 19 të Ligjit mbi qarkullimin e paluajtshmërive, (Gazeta zyrtare e Kosovës nr. 45/1, 29/86 dhe 8/88) e aplikueshme në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 është parashikuar: "Se bartësi i të drejtës së pronësisë i cili ka ndërmend të shesë tokën bujqësore, ka për detyrë që më parë me shkrim t'ia ofrojë organizatës së punës së bashkuar



e cila merret me prodhim bujqësor në territorin e komunës në të cilën gjendet toka dhe bujkut - poseduesit fqinjë, ndërsa sipas nenit 26 par. 2 të Ligjit në fjalë është përcaktuar se në qoftë se nuk bëhet oferta në kuptim të nenit 19 të këtij Ligji personi i cili ka të drejtën e përparësisë së blerjes mundet me padri te gjykata të kërkojë që kontrata e shitjes të anulohet dhe atë të shitet pasuria e paluajtshme me kushtet e njëjta. Sipas par. 4 të nenit në fjalë, paditësit kanë për detyrim që brenda afatit për paraqitjen e padisë për shkak të shkeljes së përparësisë së blerjes, te gjykata në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme, të deponojnë shumën në lartësinë e çmimit të blerjes.

Paditësit kushtin thelbësor, mbi deponimin e çmimit të shitblerjes nuk e kanë përmbushur dhe pavarësisht nga fakti se kanë të drejtën e përparësisë së blerjes, nuk mund të kërkojnë anulimin e kontratës së shitblerjes lidhur në mes të paditurit të parë M.L. dhe të paditurit të dytë A.K..

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 246/2010 datë 21.02.2013)*



*Rev. nr. 145/2012  
Datë 13.1.2014*

## **Dëmi jomaterial në emër të frikës së përjetuar - Neni 200 të LMD 224 par 1 të LPK**

*Gjykata me rastin e caktimit të dëmit jomaterial për frikë të pësuar të paditësit, duhet të angazhojë ekspertin neuropsikiatër për të dhënë mendimin profesional lidhur me intensitetin dhe kohë zgjatjen e frikës.*

### **Nga arsyetimi**

Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dëmit jomaterial në emër të frikës së përjetuar, te paditësi ka angazhuar ekspertin neurokirurg i cili ka dhënë mendimin e tij për intensitetin e frikës së përjetuar dhe kohëzgjatjen e saj, të cilën e ka pësuar paditësi për shkak

të aksidentit të komunikacionit të shkaktuar nga i siguruari i të paditurit KS "Sigal".

Gjykata e shkallës së dytë, në këtë pjesë aktgjykimin e shkallës së parë e vërteton dhe e pranon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës lidhur me dëmin jomaterial në formë të frikës, nuk pranon vlerësimet e gjykatave të instancës së më të ulët, nga arsyeja se gjykata e shkallës së parë lidhur me dëmin jomaterial e në emër të frikës, nuk është deklaruar eksperti neuropsikiatër, por për këtë është deklaruar eksperti ortoped-traumatolog dhe kirurg, të cilët nuk i përkasin lëmive përkatëse për këtë lloj dëmi jomaterial. Vërtetimi i shpërblimit jomaterial dhe caktimi i shpërblimit për këtë formë të dëmit jomaterial, përfaqësojnë zbatimin e së drejtës materiale.

Gjykata e shkallës së parë duhet në rigjykim t'i mënjanojë përveç tjerash dhe të caktojë ekspertin neuropsikiatër i cili do të jep mendimin e intensitetit të frikës së përjetuar dhe kohëzgjatjen e saj tek paditësi e pastaj të caktojë shumën e dëmit jomaterial në emër të frikës së përjetuar.

*(Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 145/2012 datë 13.1.2014)*



*Rev. 265/2011  
datë 11.03.2013*

### **Lidhja kauzale në mes të veprimeve dhe dëmit të shkaktuar - neni 173 LMD**

*Detyrimi për shpërblimin e dëmit duhet të përmbajë prezumimet siç është: dëmi i shkaktuar, veprimi i kundërligjshëm, lidhja shkakore (kauzale) në mes të veprimit dhe dëmit të shkaktuar dhe pasoja.*

## Nga arsyetimi

Gjykata e shkallës së parë aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, e bazon në faktin se për shkak të ndërprerjeve të shpeshta të rrymës elektrike, paditësit i është dëmtuar aparatura për fotografim e cila ka qenë e importuar, dhe mirëmbajtjen e së cilës e ka bërë firma Sllovene "Meditrade" e cila firmë ka bërë sanimin e prishjes të kësaj aparature, sipas urdhrit të punës dhe faturës dhe se ky sanim ka kushtuar 8.588,00 €.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se për dëmin e shkaktuar paditësit është përgjegjës e paditura dhe e obligon që paditësit në emër të shpërblimit dëmit t'i paguaj shumën prej 8.588,00 €, Lartësinë e dëmit gjykata e shkallës së parë e vërteton në bazë urdhërit të punës dhe faturës së lëshuar nga firma "Meditrade", nga Sllovenia.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurë ankimore ka pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për të cilat arsye ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata e Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e këtyre faktike, ka gjetur se qëndrimi i tillë juridik i gjykatave të instancës ma të ulët nuk mund të pranohet si e drejtë dhe i ligjshëm, nga se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, mbi gjendjen e vërtetuar faktike, gabimisht është aplikuar e drejta materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Kjo nga se aparatura e paditësit është prishur në muajin shkurt të vitit 2004, si pasojë e mos furnizimit në rregullt me rrymë elektrike. Paditësi për prishjen e kësaj aparature nuk ka lajmëruar tek e paditura dhe nuk ka bërë sigurimin e provave në procedurë jokontestimore, në mënyrë që nëpërmjet ekspertit përkatës profesional do të vërtetonte se prishja e aparaturës së paditësit a ka qenë si pasojë e mos furnizimit të rregullt me energji elektrike, përkatësisht se ekziston lidhja shkakore (kauzale) në mes të dëmit të shkaktuar dhe veprimeve ose mosveprimeve të paditurës Fakti prishjes së aparaturës së paditësit është mbështetur në faturën e firmës së lartpërmendur, gjë që nuk mjafton për të vërtetuar plotësisht faktet e vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështje juridike.

Për faktet se nga shkresat e lëndës dhe provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se nuk është vërtetuar në mënyrë të sigurt lidhja shkjajkore në mes të veprimeve të paditurës dhe dëmit të shkaktuar, rezulton se e paditura nuk mund të jetë përgjegjëse për shpërblimin e dëmit paditësit.

*(Aktgjykim Gjykata Supreme e Kosovës  
Rev. 265/2011 datë 11.03.2013)*



*Rev. nr. 124/2014  
Datë 13.5.2014*

### **Kontratë për mbajtjen e përrjetshme - neni 26 i LMD**

*Palë në kontratën për mbajtjen e përrjetshme si ushqimmarrës dhe ushqimdhënës mund të jetë çdo person fizik i cili e ka zotësinë për të lidhur kontratën sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës civile dhe nuk është e kufizuar vetëm në personat në gjini ndërmjet tyre apo personat që kanë detyrim të ndërsjellë.*

### **Nga arsyetimi**

Gjykata Supreme e Kosovës, revizionin e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK, vetëm në pjesën e tij të goditur dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitës së procedurës kontestimore që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësuesin e rregullt.

Pretendimin e cekur në revizion se e paditura të gjitha të mirat të cilat i ka përfitur në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përrjetshme, burojnë nga veprat penale sipas aktgjykimit penal P. nr. 86/12, (i cili aktgjykim është dorëzuar së bashku me revizionin) Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase palë në kontratën për mbajtjen e përrjetshme si ushqimmarrës dhe ushqimdhënës mund të jetë çdo person fizik i cili e ka zotësinë për të lidhur kontratën sipas rregullave

të përgjithshme të së drejtës civile dhe nuk është e kufizuar vetëm në personat në gjini ndërmjet tyre apo personat që kanë detyrim të ndërsjellë. Andaj, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate të revizionit fakti se është zhvilluar procedurë penale, lidhur me anulimin e martesës së ushqimmarrësit dhe këtu të paditurës si ushqimdhënëse (ngase të njëjtit martesën e kanë lidhur para organeve paralele), nuk është bazë juridike për anulimin e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme, sepse nuk është kusht ligjor që të njëjtit të jenë bashkëshort. Kjo Gjykatë shton se palët kontraktuese janë marrë vesh mbi pjesët përbërëse esenciale të kontratës (neni 26 i LMD), duke e deklaruar vullnetin e tyre lirisht dhe seriozisht, në atë mënyrë që kontratën e kanë legalizuar në Gjykatë, sipas procedurës së paraparë ligjore, andaj pretendimi i cekur në revizion se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar është i pabazuar.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 124/2014, Më 13.5.2014)*



*Rev. nr. 145/2010  
Datë 22.8.2011*

### **Lidhja e kontratës nga personi i paautorizuar - neni 103 dhe 88.1 LMD**

*Kontrata e shitblerjes është nule në kuptim të nenit 103 lidhur me nenin 88 par. 1 të LMD-së nëse është lidhur nga personi i pa autorizuar*

#### **Nga arsyetimi**

Në procedurë të zhvilluar është vërtetuar fakti se me datën 21.9.2004, është lidhur kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, në mes M.D. në njëren anë, si shitës, të cilën ka përfaqësuar me autorizim N.M., avokat nga R. - Republika e Malit të Zi, me të paditurin si blerës, e cila kontratë është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë më datë 6.10.2004 me shenjë Vr. nr. 4514/2004, për çmim të kontraktuar prej 27.300,00 €. Nga provat e administruara është vërtetuar se au-

torizimi nuk ka qenë i nënshkruar nga paditësi dhe si i tillë është i falsifikuar.

Gjykata e shkallës së parë, në gjendjen e vërtetuar faktike ka gjetur se kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Vr.nr.4514/2004 datë 6.10.12004, është absolutisht nule dhe të njëjtën e ka anuluar.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe ka refuzuar ankesën e të paditurit si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, në gjendjen e vërtetuar faktike, në mënyrë të drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykatat e instancës më të ulët kanë vlerësuar drejtë se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për anulimin e kontratës së shitblerjes, pasi që kontrata në fjalë është lidhur me personin e pa-autorizuar. Paditësi nuk ka dhënë autorizim për avokatin M. D. që ka lidhë kontratën e shitblerjes në emër të paditësit dhe e njëjta është vërtetuar në gjykatë. Nga vërtetimi i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë nr. 205-1-161/06 datë 10.3.2005, është vërtetuar se fotokopja e letërnjoftimit në emër të paditësit është falsifikuar dhe se nuk është nënshkruar dhe vulosur nga ana e punëtorëve të autorizuar të këtij Sekretariati. Kontrata në fjalë është lidhur në kundërshtim me dispozitat e nenit 88 par. 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve dhe e njëjta është nule në kuptim të nenit 103 par. 1 të LMD-së.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev. nr. 145/2010 datë 22.8.2011)*



*E. Rev. nr. 22/2013*

*Datë 13.11.2013*

## **Kontratë për punët shtesë - 630, 633, 634 të LMD-së.**

*Për çdo largim nga projekti i ndërtimeve, respektivisht nga punimet e kontraktuara zbatuesi duhet të ketë pëlqimin shkresor të porositësit. Ai nuk mund të kërkojë asnjë ngritje të shpërblimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e tillë.*

### **Nga arsyetimi**

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë drejt kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar. Kjo ngase sipas dispozitës së nenit 633 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, thuhet se për çdo largim nga projekti i ndërtimeve, respektivisht nga punimet e kontraktuara zbatuesi duhet të ketë pëlqimin shkresor të porositësit. Ai nuk mund të kërkojë asnjë ngritje të shpërblimit të kontraktuar për punimet që i ka kryer pa pëlqimin e tillë. Paditësja po ashtu nuk ka ofruar asnjë provë se punët shtesë të kryera jashtë kontratës paraqesin punime urgjente të paparashikuara në kuptim të nenit 634 të LMD, ngase punët shtesë të cilat i ka kryer paditësja nuk paraqesin punë urgjente nga neni i lartcekur.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë përmbajnë arsyet e mjaftuara për faktet relevante për gjykimin e drejt të kësaj çështje juridike të pranueshme edhe për këtë Gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet në revizionin e paditëses se gjykatat e instancës më të ulët aktgjykimet e tyre i mbështesin në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga neni 630 dhe neni 633 të LMD, ngase në rastin konkret është dashur që të aplikohet dispozita e nenit 73 të LMD, si ligj në aplikim në kohën e kryerjes së punimeve, sipas së cilës është parapara se kur është ekzekutuar kontrata të cilës i mungon forma e paraparë me ligj, nëse palët

kontraktuese kanë kryer në tërësi ose pjesën më të madhe obligimet kontraktore kontrata është e vlefshme, po ashtu këto aktgjykime janë marrë me aplikimin e gabueshëm të së drejtës materiale ngase sipas nenit 34 pika (iii) i Ligjit nr. 2003/17 mbi Prokurimin Publik në Kosovë, është paraparë se ekzekutimi i punimeve shtesë dhe punimeve të ngjashme të cilat janë të mbuluara me një kontratë, mund t'i kryen i njëjti kontraktor nëse punët shtesë nuk tejkalojnë 10%, të vlerës së kontratës bazë, sepse sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë aplikuar të drejtën materiale dhe atë dispozitat e nenit 633 dhe 634 të LMD, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me kontratën e ndërtimit në kuptim të nenit 630, sipas së cilit nen në paragrafin 2 është paraparë se kontrata e ndërtimit duhet të lidhet në formë shkresore, prandaj janë të pabazuara thëniet e paditëses në revizion se në rastin konkret është dashur të aplikohen dispozitat e nenit 73 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

*(Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës  
E. Rev. nr. 22/2013, më 13.11.2013)*



### III. E DREJTA E PUNËS

Rev. nr. 53/2013

Datë 19.6.2013

#### **Afati për mbrojtje gjyqësore në kontestet e punës -nenit 103 të Ligjit mbi drejtat themelore nga marrëdhënia e punës (Fletorja Zyrtare e RSFJ 60/1986**

*Në qoftë se punëtorit nuk i është dhënë mundësia për mbrojtje interne për të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës, nuk mund të mohohet e drejta për mbrojtje gjyqësore, për shkak se padia është paraqitur pas afatit të përcaktuar me ligj.*

#### **Nga arsyetimi**

Paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura Hekurudhat e Kosovës, në vendin e punës arkëtar i mallrave dhe se me profesion është Komerçant transportues. E paditura me njoftimin e saj nr. 90 të datës 7.2.2001, ka larguar paditësin nga puna. Kundër këtij njoftimi paditësi ka bërë kundërshtim me datë 8.5.2001, ndërsa padinë e ka paraqitur gjykatës më 30.5.2001.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se padia e paditësit është e pasafatshme në kuptim të nenit 103 të Ligjit mbi drejtat themelore nga marrëdhënia e punës (Fletorja Zyrtare e RSFJ 60/1986) e cila ka qenë e aplikueshme sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24.

Gjykata e shkallës së dytë në vendosje lidhur me ankesën e paditësit, ka pranuar në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke refuzuar ankesën e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vlerësuar si të bazuara thëniet e revizionit të paditësit se ai nuk është njoftuar personalisht mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Në bazë të njoftimit të paditësit me nr. 90 datë 7.2.2001 kanë qenë të obliguar udhëheqësit e reparteve të informojnë punëtorët dhe t'i përgatisin vendimet e nevojshme, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka prova se paditësit i është dorë-

zuar njoftimi në fjalë. Duke u nisur nga fakti se paditësit nuk i është dhene mundësia për përdorimin e mjetit efektiv brenda organizatës, të njëjtit i është cenuar e drejta elementare për ankim efektiv, e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës neni 32 dhe neni 13 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Meqenëse paditësit i është marrë e drejta për ankim brenda punëdhënësit, të njëjtit nuk mund t'i mohohet mbrojtja gjyqësore dhe se gjykata e shkallës së parë lidhur me padinë e paditësit duhet të vendosë meritorisht.

*(Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 53/2013 datë 19.6.2013)*



*Rev. nr. 230/2014*

*Datë 03.11.2014*

**Bazë ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për pjesëmarrje në zgjedhje- neni 28.4 të Urdhërësës Administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNIMI-kut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civilë të Kosovës.**

*Nëpunësit civilë mund të paraqesin kandidaturën për ndonjë funksin të zgjedhur publik, por ata duhet të marrin pushim pa pagesë nga Shërbimi civil, i cili fillon nga data kur ata publikisht i shpallin kandidaturat e tyre. Nëse nuk zgjidhet, nëpunësi civil ka të drejtë të kthehet në punën e tij apo të saj në Shërbimin civil brenda një (1) jave nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.*

**Nga arsyetimi**

Nga shkresat e lëndës del se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura si ushtruese e shefit të personelit në administratën komunale të Komunës së Rahovecit dhe ka kandiduar për deputete për Asamblenë Komunale të Rahovecit në zgjedhjet lokale të 15 nëntor 2009. Për shkak të pjesëmarrjes në zgjedhjet lokale me aktvendimin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, nr. 01/nr.1060 të datës 14.10.2009 i është ndërprerë marrëdhënia e punës . Kundër këtij aktvendimi pa-

ditësja ka ushtruar ankesë Komisionit për ankesa dhe parashtresa të paditurës më 13.11.2009, por nuk ka marrë përgjigje. Pas kësaj paditësja është ankuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbyesve Civilë të Kosovës, më 01.2.2010, e cila me aktvendimin e saj A 02(16) 2010 të datës 25.2.2010 ka refuzuar ankesën e paditëses si të pabazuar. Paditësja në zgjedhjet lokale të nëntorit 2009 nuk është zgjedhur si delegate në Asamblenë Komunale të Rahovecit. E paditura vendimin e saj mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditëses e bazon në nenin 28.3. të Urdhëresës Administrative 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civilë të Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave ka vërtetuar se paditëses pa bazë ligjore i është ndërprerë marrëdhënia e punës pasi që e njëjta nuk është zgjedh si deputete dhe është dashtë të kthehet në detyrat e punës në kuptim të nenit 28.4 të Urdhëresës Administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNIMI-kut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civilë të Kosovës dhe anulon vendimin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit nr. 1060 të datës 14.10.2010 dhe obligon të paditurën që paditëses t'ia kompensojë të ardhurat personale të porealizuara nga data e largimit nga vendi i punës në shumë prej 10.272,00 €.

Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar par. 4 të nenit 28 të Urdhëresës Administrative 2003/2 nga arsyeja se paditësja si ushtruese e detyrës shefit të personelit në Administratën komunale të Rahovecit, ka kandiduar për këshilltare në Asamblenë Komunale të Rahovecit në zgjedhjet lokale më 15.11.2009 dhe e njëjta nuk është zgjedhur si këshilltare komunale. Paditëses gjatë paraqitjes së kandidaturës së saj i takon pushimi pa pagesë i cili fillon nga data kur ka shpallur kandidaturën e saj, meqenëse nuk është zgjedhur si këshilltare në Ansamblenë Komunale të Rahovecit, e njëjta është dashtë të kthehet në punën e saj në shërbimin civil brenda 1 jave nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve e jo t'i pushojë marrëdhënia e punës, prandaj gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar nenin 28 par. 4 të Urdhëresës në fjalë.

*(Aktgjykimi Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 230/2014 më 03.11.2014)*

Rev. nr. 9/2014

Datë 06.3.2014

## **Ndërrprerja e marrdhënies së punës - afati i padisë - neni 83 të Ligjit themelor mbi marrëdhëniet e punës (Fletorja zyrtare 60/89 të RSFJ-së**

*Punëtori që nuk është i kënaqur me vendimin përfundimtar të organit kompetent të organizatës, në qoftë se nuk merr vendim në afatin prej 30 ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës apo kundërshtimit, punëtori ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtje gjyqësore për të drejtat e tija nga marrëdhënia e punës.*

### **Nga arsyetimi**

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatave të instancës më të ulët, del se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura, në de-tyrat e punës "Recepcionist në konviktin" e studentëve në Prishtinë. Me vendimin e të paditurës nr. 386/2 të datës 5.12.2000, paditësit i ndërpritet marrëdhënia e punës, për shkak të mungesës më shumë se 5 ditë nga puna. Kundër këtij aktvendimi paditësi ka paraqitur kundërshtim, e paditura nuk ka vendosur lidhur me kundërshtimin e paditësit. Paditësi me padi të parashtruar gjykatës kërkon mbrojtje gjyqësore për drejtat e tija nga marrëdhënia e punës.

Gjykata e shkallës së parë refuzon kërkesëpadinë e paditësit për arsyë se paditësi nuk ka lajmëruar të paditurën 48 orë përpara se do të mungojë nga puna për shkaqe shëndetësore dhe nuk ka paraqitur arsyetimin e mungesës nga puna dhe nuk ka shenja mjekësore.

Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurë të vendosjes sipas ankesës së paditësit e prishë vendimin e shkallës së parë dhe hedhë si të pasafatshme padinë e paditësit, nga arsyeja se vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit, i është dorëzuar më 6.12.2000, të cilën e ka kundërshtuar paditësi me 20.12.2000, për të cilën nuk është përgjigjur e paditura, ndërsa paditësi padinë e ka parashtruar gjykatës më 29.1.2001 jasht afatit prej 15 ditësh sipas dispozitës së

nenit 181 par. 1 të Ligjit për punën e bashkuar (Gazeta zyrtare e RS-FJ-së 11/1988).

Gjykata Supreme e Kosovës, një velrësim të tillë të Gjykatës së Apelit nuk mund ta pranojë nga arsyeja se sipas dispozitës së nenit 92 të Ligjit për të drejtat themelore nga marrëdhënia e punës (Fletorja zyrtare e RSFJ 60/89) e cila ka qenë e aplikueshme në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, është përcaktuar se me datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji pushojnë të vlejné kapitulli IV dhe V i pjesës së dytë të Ligjit mbi punën e bashkuar nga neni 161 deri në nenin 226 dhe 670, dhe ky Ligj ka hyrë në fuqi më 15.10.1989. Prandaj gjykata e shkallës së dytë ka aplikuar dispozitën e nenit 181.1 të Ligjit mbi punën e bashkuar, të cilat dispozita nuk kanë qenë në fuqi. Në rastin konkret afati i paraqitjes së padisë duhet të llogaritet sipas neni 83 të Ligjit themelor mbi marrëdhëniet e punës (Fletorja zyrtare 60/89 të RSFJ-së), i cili ka qenë në fuqi dhe i aplikueshëm, ku është përcaktuar që punëtori që nuk është i kënaqur me vendimin përfundimtar të organit kompetent të organizatës, në qoftë se nuk merr vendim në afatin prej 30 ditësh, nga dita e parashtrimit të kërkesës apo kundërshtimit, punëtori ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh të kërkojë mbrojtje gjyqësore për të drejtat e tija nga marrëdhënia e punës.

Paditësi vendimin e të paditurës nr. 386/2 datës 5.12.2000, ka pranuar më 06.12.2000, kundërshtimin ka paraqitur më 20.12.2000, ku e paditura ka qenë e obliguar të përgjigjet në afat prej 30 ditësh deri më 20.1.2001, ndërsa paditësi pas kësaj dite në afat prej 15 ditësh ka qenë obliguar të kërkojë mbrojtje gjyqësore për të drejtat e tija nga marrëdhënia e punës deri më 05.02.2001, ndërsa padinë e ka paraqitur më 29.1.2001, në afat ligjor.

Prandaj Gjykata e Apelit e Kosovës duhet të shqyrtojë ankesën e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe të vendosë në mënyrë meritore lidhur me ankesën e paditësit.

*(Aktvendimi Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev. nr. 9/2014 më 06.3.2014)*

Rev. nr. 348/2014

Datë 29.12.2014

## **Kompensimi i Pagave - Ndryshimi i aktgjytimeve të instancave më të ulta - nenit 224.1 të LPK-së**

*Paditësit nuk i takon e drejta për kompensimin e pagave, në qoftë se vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit në bazë të vendimit të gjykatës ka qenë i ligjshëm.*

### **Nga arsyetimi**

Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët drejt dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike që ka të bëjë me faktet vendimtare për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, por në një gjendje të tillë faktike sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar ngase me shkresat e lëndës si dhe në përgjigjen në padi e paditura e ka njoftuar gjykatën e shkallës së parë dhe atë ankimore se kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë kanë paraqitur mjetin juridik-revizionin ngase baza e kërkesëpadiisë ka qenë kontestuese.

Nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 564/2008 datë 10.6.2011, i cili gjendet në shkresat e lëndës del se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë Ac.nr. 171/2008 datë 3.9.2008 dhe ai i Gjykatës Komunale Prishtinë, CI.nr. 96/2006 datë 11.4.2007 janë ndryshuar ashtu që është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për anulimin e aktvendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës si e pabazuar. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi si të bazuara thëniet e revizionit të t' paditurës se baza e kërkesëpadiisë së paditësit për kompensimin e pagave tani nuk ekziston ngase e njëjta me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr. 564/2008 datë 10.6.2011, është refuzuar si e pabazuar, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës duke vepruar në kuptim të nenit 224.1 të LPK-së, ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, ashtu që kërkesëpadiinë e paditësit e refuzoi si të pabazuar, sepse vendimi i të paditurës mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme,

ka qenë i ligjshëm, prandaj paditësit nuk i takon kompensimi i të ardhurave personale për periudhën e kërkuar sipas kerkesëpadisë, meqë nuk ka bazë juridike.

(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev.nr. 348/204, më 29.12.2014)



Rev. nr. 243/2014

Datë 04.11.2014

### **Kompensimi i dëmit për humbjen e të ardhurave personale - neni 155 LMD - neni 186 LMD.**

*Në kuptim të nenit 155 të LMD, dëmi është pakësim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i shtimit të pasurisë së tij (fitim i munguar). Në kuptim të nenit 158 të LMD, fajsia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia. Kurse, në kuptim të nenit 186 të LMD, detyrimi i kompensimit të dëmit, konsiderohet se rrjedh për pagesë prej momentit të shkaktimit të dëmit.*

### **Nga arsyetimi**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja kishte pas të themeluar marrëdhënie pune në Shoqatën e zjarrfikësve në Komunën e Prishtinës, që nga viti 1983 ku fillimisht kishte punuar si sekretare teknike dhe llogaritare, e më vonë si daktilografe, deri me fillimin e Luftës në Kosovë në vitin 1999, mirëpo pas përfundimit të kësaj lufte e njëjta nuk është përfshi në procesin e punës tek e paditura. Me aktgjykimin e Gjykatës Komonale në Prishtinë C.nr. 283/03 të datës 24.09.2007, është vërtetuar se paditësja, tani tek e paditura ka cilësinë e punëtore në kohë të pa caktuar me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, dhe është detyruar e paditura që paditësen ta kthejë në punë dhe detyra ku më parë kishte punuar apo në punë e detyra të ngjashme në afat prej 8 ditësh nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. E paditura, me kontratën e punës 01.nr.112-787 të datës 11.02.2008, pa-

ditësen e kishte pranuar në punë në Drejtoratin për mbrojtje civile dhe emergjente, si telefoniste, me pagë mujore prej 163 €. Mirëpo, për periudhën kaluese, e paditura, paditëses nuk i kishte kompensuar të ardhurat e humbura personale.

Paditësja me padi të paraqitur në gjykatë ka kërkuar të ardhurat e humbura personale prej datës 01.07.1999 kur e paditura ka filluar të funksionoj dhe punoj, e deri më datën e kthimit të saj në punë me kontratën e lartë përmendur të punës.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranoj si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët lidhur me pranimin e kërkesëpadisë së paditëses për kompensimin e të ardhurave personale të humbura përkitazi me periudhën kohore prej 01.07.1999 e deri më datën 11.02.2008 kur paditësja ka filluar të punoj tek e paditura, nga se aktgjykimet e këtyre gjykatave në këtë pjesë janë të përfshira me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Në kuptim të nenit 155 të LMD, dëmi është pakësim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe parandalimi i shtimit të pasurisë së tij (fitim i munguar). Në kuptim të nenit 158 të LMD, fajsia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia. Kurse, në kuptim të nenit 186 të LMD, detyrimi i kompensimit të dëmit, konsiderohet se rrjedh për pagesë prej momentit të shkaktimit të dëmit. Pas analizimit të këtyre dispozitave ligjore, dhe gjendjes së fakteve në këtë çështje juridike, Gjykata Supreme, vlerëson se është e pa bazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditëses për kompensimin e të ardhurave personale mujore prej datës 01.07.1999 e deri në ditën e përfshirjes së paditëses në punë tek e paditura, më datën 11.02.2008, kjo nga se në dispozitivin e aktgjykimet të plotfuqishëm të Gjykatës Komonale në Prishtinë C.nr. 283/03 të datës 24.09.2007 për të cilin pretendohet se paraqet bazë juridike që paditëses ti kompensohen të ardhurat e humbura personale për periudhën e lartë përmendur, nuk është precizuar se prej cilit moment, apo prej cilës ditë paditësja ka cilësinë e punëtores në kohë të pa caktuar tek e paditura, kështu që sipas këtij aktgjykimi nuk dihet as prej cilës datë paditësja ka të drejtë në të ardhura personale. Pasi që është jo kontestuese se



paditësja pas vitit 1999 për arsye të ndryshme nuk ka pas të themeluar marrëdhënie pune tek e paditura, në njëjërën anë, kurse në anën tjetër aktgjykimi i lartë përmendur nuk e obligon të paditurën për kompensim të ardhurave personale për periudhën kontestuese, Gjykata Supreme, vlerëson se nuk ekziston lidhja kauzale në mes të dëmit të paditëses dhe fajësisë së të paditurës për kompensimin e këtij dëmi, andaj për arsye të mungesës së bazës juridike, është e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses që të detyrohet e paditura që paditëses të ia kompensoj të ardhurat personale për periudhën e lartë përmendur, dhe për këtë arsye aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët në këtë pjesë u ndryshuan dhe kërkesëpadia e paditëses për këtë pjesë u refuzua si e pa bazuar.

Mirëpo, sa i përket periudhës, kur sipas aktgjyimit të lartë përmendur, e paditura është obliguar që paditësen ta kthej në punë, e cila datë korrespondon me tetë ditë pas plotfuqishmërisë së atij aktgjykimi (07.12.2007), dhe deri në ditën kur paditësja është përfshirë në procesin e punës tek e paditura, Gjykata Supreme vlerëson se në kuptim të nenit 186 të LMD, paditësja ka të drejtë në të ardhurat e humbura personale, të cilat paraqesin dëm për paditësen, me që e paditura nuk ka vepruar me kohë sipas këtij aktgjykimi, andaj deri në ditën kur paditësja është përfshirë në procesin e punës, është e obliguar që të ia paguajë të ardhurat e humbura personale, si fitim i humbur i cili fitim me bazë juridike është pritur po të ia fillonte punës menjëherë. Lartësia mujore e të ardhurave të humbura personale është e vërtetuar me ekspertizë financiare, dhe si e tillë nuk është kontestuese në mes palëve, andaj të njëjtën lartësi edhe Gjykata Supreme ia pranoi paditëses në tërësi si në pjesën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Lartësinë e shpenzimeve procedurale të vërtetuar nga ana e gjykatave të instancës më të ulët, Gjykata Supreme e pranoi si të bazuar në ligj, andaj me rastin e ndryshimit të aktgjykimeve e detyroi të paditurën që të njëjtën lartësi të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguajë.

*(Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev. nr. 243/2014 datë 04.11.2014)*

Rev. nr. 99/2015

Datë 15.04.2015

## **Anulimi i Konkursit - interesi juridik për paraqitjen e padisë - Shkelje e dispozitave të nenit 182.1 lidhur me nenin 2.4 të LPK**

*Nuk mund të kërkohet anulimin e vendimit, i cili vendim paraprakisht është anuluar nga ana e të paditurës.*

### **Nga arsyetimi**

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura më datën 22 korrik 2011, në gazetën ditore "Epoka e Re", ka shpallur konkursin për plotësimin e vendeve të lira të punës 05.nr.643/2011, në të cilin, ka kërkuar një edukatore në Shkollën Fillore në lagjen nr. VIII në Gjilan. Në këtë konkurs janë përcaktuar saktësisht kushtet e konkursit, diploma, kopja e letërnjoftimit, certifikata për trajnimet e kryera, vërtetimi mbi përvojën e punës si dhe dëshmi të tjera. Paditësja, ka aplikuar sipas këtij konkursi për vendin e lartpërmendur të punës, për të cilin vend pune ka aplikuar edhe kandidatja M. K., janë intervistuar që të dyja, dhe pas kësaj, e paditura me vendimin 04. nr. 721/2011 datë 31.08.2011, për vendin e lartcekur të punës, ka përzgjedhur kandidatën konkurrese M. K., e jo paditësen. E pakënaqur me këtë vendim, paditësja ka paraqitur ankesë në Komisionin komunal për shqyrtimin e ankesave, i themeluar me vendimin e Kryetarit të Komunës së paditur, në përbërje prej 3 anëtarëve, i cili komision, me vendimin 05-61-34864, datë 11.10.2011, e aprovon pjesërisht ankesën e paditëses, ashtu që anulon vendimin e lartpërmendur me të cilin është përzgjedhur kandidatja M. K. e jo paditësja, dhe obligon Drejtorinë komunale të arsimit në Gjilan, që në afat prej 15 ditësh të rishpall konkursin për të njëjtin vend pune, edukatore në Shkollën Fillore në lagjen nr. VIII në Gjilan, dhe të bëjë rizgjedhjen sipas kritereve të përcaktuara në konkurs dhe në përputhje me normativin 19/2009. Sipas ankesës së paditëses, Departamenti i Inspekcioni-Inspektori Komunal i Arsimit në Gjilan, me vendimin nr. 146/2011 datë 03.11.2011, ka lënë në fuqi vendimin e Komisionit komunal për shqyrtimin e ankesave, mirëpo e paditura nuk ka rishpallur konkursin, kështu që e përzgjedhura M.K. ka vazh-

duar të punojë në vendin e kontestuar të punës. Padiësja, me padinë e paraqitur ka kërkuar që sërish të anulohet i njëjti konkurs, dhe që të ri shpallet i njëjti konkurs për të njëjtin vend pune.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me pranimin si të bazuar të kërkesëpadiës së padiësit, për shkak se aktgjykimet e këtyre gjykatave janë të përfshira me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 2.4 të LPK, të cilat shkelje kanë të bëjnë me atë se padiësja nuk ka interes juridik për padinë e paraqitur, andaj nuk kanë qenë të plotësuar kushtet procedurale për vazhdimin e procedurës në këtë çështje juridike.

Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se mungon interesi juridik për paraqitjen e padisë së padiëses, nga se ajo kërkon anulimin e vendimit të paditurës, i cili vendim paraprakisht është anuluar nga ana e të paditurës. Ligji për procedurën kontestimore në nenin 1 cakton rregullat procedurale në bazë të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidh kontestet nga marrëdhënia juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, ndërsa në rastin konkret objekt i kontestit është një vendim i shfuqizuar nga ana e të paditurës, dhe çështja sipas padisë së paraqitur nuk mund të trajtohet si kontestimore në mes palëve. Një person, nuk mund të shfrytëzojë gjykatën për interesat e veta personale, por çështja e paraqitur në gjykatë duhet të jetë një çështje që ndërlidhet me një të drejtë të paraparë me ligj, që kërkohet nga pala dhe që është shkelur, andaj si pasojë juridike e shkeljes së parimit të ekzistimit të interesit juridik, padia duhet të hedhet poshtë si e palejuar.

Për këto arsye, gjykata e revizionit gjen se edhe e drejta materiale gabimisht është zbatuar nga ana e gjykatave të shkallës së më të ulët, kjo nga se për shkak të mungesës së kushteve procedurale për paraqitjen e padisë, padinë e padiëses nuk e kanë hedhur si të palejueshme.

*(Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 99/2015 datë 15.04.2015)*

## IV. E DREJTA FAMILJARE

*Rev. nr. 5/2012*

*Datë 4.2.2013*

### **Besimi i fëmijëve - neni 141 par. 1 të Ligjit për familjen dhe nenit 3 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës (e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB datë 20.11.1989)**

*Me rastin e vendosjes lidhur me besimin e fëmijëve të mitur gjykata nisët nga interesi i fëmijës. Nëse mendon se është e nevojshme, gjykata merr parasysht edhe mendimin e ekspertëve sipas rrethanave të rastit.*

#### **Nga arsyetimi**

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, nga gjykatat e instancës më të ulët, është vërtetuar fakti se ndërgjyqësit kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore dhe se nga kjo bashkësi kanë një fëmijë të përbashkët, këtu të miturin A.B. i lindur më 8.9.2010. Kjo bashkësi jashtëmartesore në mes të ndërgjyqësve ka zgjatur gjerë më 30.9.2011. Fëmiju i mitur A.B. ka mbetur nën kujdesin e prindërve të paditësit. Raportet në mes të ndërgjyqësve janë acaruar për shkak të dhunës që ka përdorur i padituri ndaj paditëses, ku janë përfshirë edhe prindërit e të paditurit.

Gjykata e shkallës së parë ia beson fëmijun e mitur paditëses-të ëmës duke marrë parasysht interesin e fëmijës të mitur dhe lidhjen emocionale të fëmijut me të ëmën.

Gjykata e qarkut në procedurë të vendosjes në ankesën e paditurit lidhur me besimin e fëmijut të mitur, refuzon ankesën dhe vërteton aktgjykimin e shkallës së parë dhe pranon në tërësi vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët në gjendjen e vërtetuar faktike në mënyrë të drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale.

Me rastin e vendosjes lidhur me besimin e fëmijëve të mitur, gjykata nisat nga interesi i fëmijës, nëse mendon se është e nevojshme gjykata merr parasysh edhe mendimin e ekspertit përkatës sipas rrethanave të rastit. Pra, gjykata zgjedh mënyrën e përshtatshme për hetimin e rrethanave, që janë me rëndësi për zhvillimin e drejtë, psikik dhe fizik dhe për edukimin e fëmiut. Parësor është interesi i fëmijëve, duke u nisur nga ajo se me nenin 3 të Konventës për të Drejtat e fëmijës (të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 20.11.1989), të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të marra qoftë nga institucionet publike ose private interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsideratë mbizotëruese. Sipas nenit 8 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës për ruajtjen e identitetit të tij, duke përfshirë shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 5/2012 datë 4.2.2013)*



*Rev. nr. 371/2014  
Datë 14.1.2015*

### **Besimi i Fëmiut- Kontakti me Gjyshërit- Neni 128. 4dhe neni 137.2 i Ligjit për familje të Kosovës - neni 3 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve**

*Ndalimit dhe evitimi i kontaktit në mes të gjyshës dhe nipit, do të ndikonte në izolimin e fëmijës me gjyshen dhe rrethin e personave në lidhje të gjakut.*

*Kontakti personal i fëmiut të mitur me gjyshen ka bazën në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës dhe atë neni 3 par. 1 ku është përcaktuar “se në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët, marrë qoftë nga institucionet publike ose private të përkujdesjes shoqërore, nga gjykata, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderueshëm dhe mbizotërues.*

## Nga asyetimi

Ligji për familjet e Kosovës, në nenin 137.2 përcakton se të drejtën prindore e ushtrojnë të dy prindërit bashkërisht dhe me marrëveshje. Mirëpo, në disa raste kjo i takon njërit prind. Rrethanat kur e drejta prindore i takon njërit prind, i përcakton neni 37.3 të Ligjit në fjalë dhe se njëra prej rrethanave është kur njëri prind ka vdekur. Dispozita e Ligjit për familjet e Kosovës, nuk ka dispozitë që lejon kontaktin e fëmijëve me personat tjerë përveç prindërve, por nuk kanë as dispozita që e ndalojnë një të drejtë që gjyshet mund të kenë kontakte me nipa apo mbesa, edhe nëse njëri prind ushtron të drejtën prindore.

Për zhvillimin psikofizik e me qëllim të zhvillimit, fortësimit të dashurisë, emocioneve, mirë rritjes dhe edukimit dhe rrjedhimisht në kontinuitet në interesin e fëmijëve është edhe mbajtja e kontakteve me gjyshën e tij, dhe kjo është e natyrshme. Para ndalimit dhe evitimi i kontaktit në mes të gjyshës dhe nipit, do të ndikonte në izolimin e fëmijës me gjyshen dhe rrethin e personave në lidhje të gjakut.

Gjykata Supreme vlerëson se mbajtja e kontaktit me gjyshen që përfaqëson një kontakt të gjinisë së gjakut, është në interes vital në radhe të parë të fëmijës madje edhe të gjyshes. Kontakti personal i fëmijut të mitur me gjyshen ka bazën në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës dhe atë neni 3 par. 1 ku është përcaktuar “se në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijët, marrë qoftë nga institucionet publike ose private të përkujdesjes shoqërore, nga gjykata, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderueshëm dhe mbizotërues. Konventa në fjalë është e aplikueshme në bazë të nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prandaj, thëniet e revizionit se nuk ka bazë ligjore për kontaktin personal fëmijut të mitur me gjyshen, janë të pabazuara.

*(Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev. nr. 371/2014 datë 14.1.2015)*

Rev. nr. 388/2014

Datë 19.1.2015

## **Pagesa e alimentacionit - mbajtja ushqimor - neni 298 i Ligjit për Familjen i Kosovës**

*Bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje financiare, i cili nuk është i aftë të punojë ose që për arsye tjera nuk mund të punësohet, ka të drejtë në mbajtje financiare nga bashkëshorti tjetër në proporcion me mundësitë e tij financiare.*

*Bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqimi nga bashkëshorti tjetër për deri sa ai do të kujdeset dhe e mban fëmijën e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punojë.*

### **Nga arsyetimi**

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesë-padisë së paditëses si ish bashkëshorte, si të bazuar ngase sipas dispozitës së nenit 298 të Ligjit për Familjen i Kosovës, është paraparë se bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje financiare, i cili nuk është i aftë të punojë ose që për arsye tjera nuk mund të punësohet, ka të drejtë në mbajtje financiare nga bashkëshorti tjetër në proporcion me mundësitë e tij financiare, ndërsa sipas nenit 299 të 'njëti ligj është paraparë se bashkëshorti i ndarë mund të kërkojë ushqimi nga bashkëshorti tjetër për deri sa ai do të kujdeset dhe e mban fëmijën e përbashkët dhe për këtë arsye i bëhet e pamundur të punojë.

Gjykata e shkallës së parë gjatë procedurës ka vërtetuar faktin se paditësja nuk ka mundësi të punësohet pasi që të njëjtës i janë dhënë në ruajtje kujdes dhe edukim fëmijët e moshës së mitur, të cilët kërkojnë një përkujdesje dhe përkushtim të shtuar rreth kryerjes së këtyre obligimeve, se e njëjta është e papunësuar dhe e njëjta në bazë të shkresave të lëndës dhe atë të raportit të Qendrës për Punë Sociale në Suharekë, merr ndihmë sociale mujore në lartësi prej 60€, për shkak të mbajtjes dhe kujdesit të fëmijëve të mitur.

Gjykata Supreme e Kosovës, i vlerësoi si të pabazuara thëniet e revizionit të t'paditurit se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, kur ka refuzuar ankesën e të paditurit në pjesën që ka të bëjë me ushqimin e paditëses ngase i padituri përpos shumës së paguar në emër të alimentacionit për fëmijët e mitur prej 300 €, dhe në emër të ushqimisë për paditësen në lartësi prej 200 €, ai paguan paditëses për çdo muaj nga 200 €, në emër të qirasë, ashtu që shumat e caktuara janë në vlerë totale prej 700 €, në muaj, e cila vlerë është mbi çdo standard jetësor në Kosovë, se gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë marrë për bazë faktin se i padituri tani është mbajtës edhe i dy fëmijëve tjerë dhe se gjendja ekonomike e të paditurit nuk mund të përballojë që paditëses t'i paguaj edhe shumën e caktuar por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, ngase i padituri sipas aktgjykimit të formës së pretë të Gjykatës Themelore Ferizaj, paguan për dy fëmijët e mitur 300 € në muaj, ndërsa për paditësen në emër të ushqimisë 200 €, në muaj, deri sa të ekzistojnë kushtet për një pagesë të tillë ndërsa shuma e paguar prej 200 €, në emër të qirasë, është shumë e cila është caktuar me aktvendim mbi urdhër mbrojtjen i cili aktvendim ka karakter të përkohshëm sepse ai është aprovuar nga data 9.1.2014 i cili përfundon më datë 15.1.2015, se lartësia e shumës së aprovuar në emër të ushqimisë për paditësen është në proporcion me të ardhurat mujore që realizon paditësi në shumë prej 3.473,54 CHF, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses për caktimin e ushqimisë është e bazuar.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev. nr. 388/2014, më 19.1.2015)*



*Rev. nr. 300/2013*

*Datë 04.02.2014*

**Ushqimia - paaftësia psikike ose mentale - neni 301 - Ligji për Familjen i Kosovës Nr. 2004/32**



*Bashkëshorti i shkurorezuar mund të bëjë kërkesë për ushqimi nga bashkëshorti tjetër nëse në momentin e shkurorezimit, mbarimit të kujdesit dhe mbajtjes së fëmijët, dhe përfundimit të kushteve të parashikuara në nenin 302 të këtij ligji, ai/ajo nuk mund të pranohet në marrëdhënie të punës për shkak të sëmundjes, paaftësisë apo të metave tjera psikike apo mentale.*

### **Nga arsytimi**

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta të cilat kishin me kontestua ligjshmërinë e aktgjykimit, lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me rastin e aprovimit si të pabazuar kërkesës së të paditurës lidhur me caktimin e ushqimis, kjo nga se, më dispozitën e nenit 301 të Ligjit për Familjen i Kosovës Nr. 2004/32, 20 janar 2006, është paraparë që bashkëshorti i shkurorezuar mund të bëjë kërkesë për ushqimi nga bashkëshorti tjetër nëse në momentin e shkurorezimit, mbarimit të kujdesit dhe mbajtjes së fëmijët, dhe përfundimit të kushteve të parashikuara në nenin 302 të këtij ligji, ai/ajo nuk mund të pranohet në marrëdhënie të punës për shkak të sëmundjes, paaftësisë apo të metave tjera psikike apo mentale. Në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore nga dispozita e nenit 301 të Ligjit mbi Familjen i Kosovës, që të paditurës ti pranohet e drejta në ushqimi për shkak se nga ana e ekspertit të psikiatrisë Dr. A.C., është konstatuar se e paditura për shkak të gjendjes psikike nuk është koshiente për veprimet e saja, kështu që me aktvendimin e Gjykatës Komonale në Viti, Ndr. Nr. 37/2010 të dt. 20.04.2012, të paditurës i është marrë përkohësisht zotësia e veprimit dhe si pasojë e kësaj QPS në Viti me aktvendimin e dt. 05.12.2011, të paditurës i ka caktuar kujdestarin e përkohshëm -punëtorin social nga QPS. Si pasojë e gjendjes shëndetësore e paditura nuk është në gjendje të punoj, dhe për rrjedhojë i takon e drejta në ushqimi, ashtu si drejtë kanë vlerësuar gjykatat e instancës më të ulët kur kanë pranuar kërkesën e të paditurës për ushqimi. Prandaj janë të pabazuara thëniet në revizion lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Thëniet në revizion se gjykata e shkallës së dytë, nuk i ka vlerësuar faktet relevante që kanë të bëjnë me zgjedhjen e drejtë të kësaj çështje juridike për faktin se paditësi nuk ka obligim ligjor për dhënien e

ushqimisë për ishë bashkëshorten me të cilën është shkurorëzuar e cila jetën me ndihma sociale, kjo gjykatë i vlerësoj si irelevante, për arsyet të dhëna nga kjo Gjykatë. Po ashtu janë të papranueshme thëniet në revizion se paditësi nuk ka mundësi materiale për të paguar në emër të ushqimisë shumën prej 100 €, pas që të dhënat e tilla janë kundërthënje me të dhënat në padi dhe në seancat e mbajtura pranë gjykatës së shkallës së parë. Prandaj janë të pa bazuar thëniet në revizion lidhur me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev. nr. 300/2013, datë 04.02.2014)*

## DHUNA NË FAMILJE

*Rev. nr. 123/2014*

*Datë 24.04.2014*

### **Urdhëri mbrojtës - neni 1.2 nënparagrafi 1.2.11 dhe neni 11 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.**

*Hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesa e personit tjetër, kualifikohet si dhunë në familje.*

*Në kontestet e dhunës në familje nuk aplikohen dispozitat e Ligjit mbi Familjen i Kosovës.*

### **Nga arsyetimi**

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktvendimi i goditur, nuk përmban të meta të cilat kishin me kontestuar ligjshmërinë e aktvendimit lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, me rastin e aprovimit të kërkesë së pales mbrojtëse si të bazuar, kjo nga se, për arsyet e dhëna nga gjykatat e instancës më të ulët, por edhe sipas vlerësimit të gjykatës të revizionit, gjykatat e instancës më të ulët drejt kanë zbatuar dispozitën e nenin 1.2 nënparagrafi 1.2.11 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Kjo dispozitë përcakton saktë se hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesa e personit tjetër, kualifikohet si dhunë në familje. Gjykata e shkallës së parë drejtë i ka kualifikuar veprimet e pales përgjegjëse si dhunë në familje, pasi që pala përgjegjëse nuk e ka lejuar që palën mbrojtëse të hyjë dhe të vendoset në shtëpi, ku kanë bashkjetuar me palën përgjegjëse dhe ka larguar të njejtën me forcë duke ftuar policinë që të bëjë një gjë të tillë.

Për faktin se kanë ndryshuar rrethanat pas rrastit të dhunës në familje, dhe pales mbrojtëse i është bërë e pa mundur që të kthehet në shtëpinë ku kanë bashkjetuar me palën përgjegjëse, pasi që ajo shtëpi është e vëllaut të pales përgjegjëse A. K., dhe pala përgjegjëse tani jeton në P., Gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 11 par 1 nënpar. 1.2 Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në

Familje, ku është përcaktuar se krahas rasteve të përcaktuar në nenin 4-10, gjykata mund të shqiptoj kryesit të dhunës, të paguan qëranë e banesës ose alimentacionin për palën mbrojtëse dhe fëmijën. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit dhe gjykimit të qeras mujore drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat, se shumica mujore prej 150 €, për palën mbrojtëse dhe fëmijën e mitur duhet të paguhet në mënyrë që të njëjtave ti mundësohet të gjejnë banim dhe hapësirë adekuate të banimit, për shkak se nuk ka mundësi të kthehet në shtëpi. Shuma e gjykuar është e mjaftueshëm për të paguar qeran mujore palës mbrojtëse në mënyrë që e njëjta së bashku me fëmijën e mitur të ketë minimum të mirqenjes sociale dhe të banimit. Mirqenja e fëmijës nënkupton rritjen e tij brenda familjes gjithmonë kur ajo është e mundur pastaj edukimin, shkollimin dhe pregaditjen e tij për t'u aftësuar në jetë si dhe në komunitetin ku jeton edhe më gjer.

Gjatë caktimit të pagesës të alimentacionit për palën mbrojtëse dhe fëmijën e mitur S.K., në shumë të përgjithshme mujore prej 300 €, ka vlerësuar të gjitha faktet relevante, është marrë parasysh gjendjen financiare e palës mbrojtëse se nuk punon, se vet pala përgjegjëse ka deklatuar se është i gatëshëm që për vajzën e tij të mitur të kontribuoj në ushqimi aq sa vlerëson gjykata. Moshë e fëmijës së mitur që kërkon angazhim shtesë për kujdesin e saj, çka vështëron edhe punësimin e rregullt të palës mbrojtëse. Dhënia e alimentacionit bashkëshortit të ndarë dhe fëmijës nga ana e prindërve, ka të bëjë me sigurimin e mbajtjes, kujdesit të nevojshëm për mirqenjen e fëmijës dhe bashkëshortit të ndarë.

*(Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 123/2014, datë 24.04.2014)*

## V. E DREJTA EKONOMIKE

*Ae. nr. 179/2010*

*Datë 2.2.2012*

**Kërkesa për kthimin e mjeteve financiare nga banka inicuese - të paguara sipas urdhëresës së paditësit- Reference Ligjore Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/26 mbi transaksionin e pagesave.**

*Paditësi nuk mund të kërkojë kthimin e mjeteve të deponuara nga banka inicuese, në qoftë se banka si i paditur ka realizuar transaksionin e destinuar për transfer të parave në konton e përfituesit të mjeteve edhe në qoftë se mjetet janë bllokuar në bankën destinuese.*

### **Nga arsytimi**

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, paditësi gjatë vitit 2008 nëpërmjet Bankës Ekonomike, filiala në Mitrovicë ka transferuar shumën prej 30.810 USD, në llogari të një biznesi në Kinë. Banka ndërmjetësuese ka qenë Banka LHB në Gjermani, ndërsa banka destinuese ka qenë Standard Charterit Bank në NEW York. Mjetet e paguara nga paditësi, kanë qenë të destinuara firmës kineze Chei Ye dhe janë bllokuar nga banka Standard Charterit Bank në NEW York për shkak se ndaj firmës kineze zhvillohen hetimet.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, kërkesa e paditësit për kthimin e mjeteve nga e paditura si bankë inicuese, është e pabazuar, pasi që e paditura ka realizuar transaksionin e destinuar për transfer të parave në shumë prej 30.810 USD, ka arritur në kontën e përfituesit të mjeteve, dhe se mjetet janë të bllokuara në bankën destinuese në New York dhe se këto mjete paditësi nuk i shfrytëzon.

Në këtë gjendje të vërtetuar faktike në mënyrë të drejtë janë aplikuar dispozitat materiale kur kërkesëpadia e paditësit është refuzuar.

Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/26 mbi transaksionin e pagesave është përcaktuar se transferi është kryer kur paguhet në bankën

destinuuese. Një transfer i brendshëm i kredisë, te banka destinuuese është paguar kur debiton llogarinë e iniciatorit, e barte në vlerën e shumës së urdhërpagesës. Në rastin konkret pagesa është bërë sipas urdhëresës së paditësit nga e paditura, si bankë inicuese, nëpërmjet bankës ndërmjetësuese, Bankë LHB në Gjermani, në bankën destinuuese Standard Charterit Bank në New York. Nga kjo del se është kryer transferi kur paguhet nga banka destinuuese. E paditura ka kryer detyrimin me bartjen e mjeteve në bankën destinuuese. Pretendimet e paditësit se i takon fitimi i humbur , janë të pabazuara nga fakti se këto mjete nuk i shfrytëzon paditësi, por mjetet janë të deponuara në Bankën destinuuese në New York.

*(Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës  
Ae. nr. 179/2010 datë 2.2.2012)*

## VI. E DREJTA PRONËSORE

*Rev. nr. 364/2014*

*Datë 6.1.2015*

**Shfrytëzimi i përhershëm i palujtshmërisë- sipërfaqja e parcelës ndërtimore për ndërtim individual - nenin 7 al. 5 të Ligjit mbi Tokën Ndërtimore të Kosovës “Gz. zyrtare e KSAK, nr. 14/80 datë 17.4.1980**

*Organi komunal nuk ka mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të tokës ndërtimore përtej maksimumit të përcaktuar me ligj.*

### **Nga arsyetimi**

Nga shkresat e lëndës del se e paditura me aktvendimin 04 nr. 353-15 datë 2.8.1972, ka ndarë katër troje për punëtorët e organeve të punëve të brendshme, në mesin e të cilëve ka qenë edhe bashkëshorti i paditëses, tani i ndjeri M.K., të cilit i është dhënë në shfrytëzim të përhershëm pllaci nr. 404 në sipërfaqe prej 0.08,17 ha, në vendin e quajtur “Sogja”. Në bazë të lejes së ndërtimit bashkëshorti i paditëses ka ndërtuar shtëpinë përdhese, në të cilën ka jetuar me bashkëshorten e tij - këtu paditësen dhe tre fëmijët e tyre. Me kërkesën e paditëses që të rritet sipërfaqja e cekur më lart, kryetari i Komunës së Suharekës me aktvendimin nr. 460-93/93 datë 8.7.1993 dhe kontratën mbi ndryshimin dhe plotësimin e pjesës së kontratës Vr. nr. 976/87, tani paditëses i është dhënë në shfrytëzim edhe pllaci nr. 77 dhe një pjesë e pllacit nr. 73, kështu që tani sipërfaqja e tërësishme e paluajtshmërisë dhënë në shfrytëzim të përhershëm arrin në 0.17,68 ha. Pllaci nr. 77 është evidentuar si pasuri shoqërore e Kuvendit Komunal, dhe me aktvendimin 01 nr. 685 datë 28.10.2009 i është ndarë Shoqatës të Kryqit të Kuq - Dega në Suharekë, për të cilën i është lëshuar edhe leja urbanistike.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se organi komunal nuk ka mundur që paditëses t’ia bartë të drejtën e shfrytëzimit të tokës ndërtimore përtej maksimumit të përcaktuar me ligj. Ka konkluduar se anekset e mëvonshme të kontratave janë të pavlefshme, jo valide pasi

që ndarja e tokës ndërtimore nuk është bërë sipas procedurës së përcaktuar me ligj, andaj ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës në tërësi ka aprovuar gjetjet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke konstatuar se parcela ndërtimore në sipërfaqe prej 0.08,39 ha, nuk është kontestuar nga e paditura dhe për këtë pjesë paditësja ka tërhequr kërkesëpadinë, por lidhur me pjesën e kërkesëpadisë kontestuese ka aprovuar vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetim se asnjë ligj nuk ka efekt prapaveprues, ndërsa raportet juridiko-civile në kontestin konkret janë krijuar derisa ishte në fuqi Ligji mbi Tokën Ndërtimore i KSAK.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë drejt e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për çka ka dhënë arsye, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e ligjit material, ngase, me nenin 7 al. 5 të Ligjit mbi Tokën Ndërtimore të Kosovës “Gz. zyrtare e KSAK, nr. 14/80 datë 17.4.1980”, është përcaktuar se sipërfaqja e parcelës ndërtimore për ndërtim individual në rajonet urbane të qytetit dhe vendbanimeve me karakter qyteti nuk mund të jetë më e vogël se 3 ari dhe më e madhe se 10 ari, ndërsa me Ligjin mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Tokën Ndërtimore “Gz. zyrtare e KSAK, nr. 42/86 datë 18.10.1986” me nenin 2 është përcaktuar se sipërfaqja e parcelës ndërtimore për ndërtimin individual banesor mund të ketë në qytete - vendbanime me karakter qyteti sipërfaqen prej 300 m<sup>2</sup> deri në 400 m<sup>2</sup>, ndërsa në vendbanimet rurale në të cilat popullata nuk merret me bujqësi si profesion primar prej 400 m<sup>2</sup> deri në 500 m<sup>2</sup>.

*(Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 364/2014, Më 6.1.2015)*



Rev. nr. 254/2012

Datë 12.2.2014

## **Vërtetimi i të drejtës së pronësisë në bazë të shitblerjes dhe mbajtjes - nenit 20 par. 1 dhe neni 32 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore**

*Për të fituar të drejtën e pronësisë në sendin e paluajjtshëm në bazë të punës juridike, sipas nenit 32 të LMTHJP, duhet të plotësohen këto prezumime: që të ekzistojë kontrata juridikisht e vlefshme (iustus titulus), e drejta e pronësisë e paraardhësit, mënyra e dorëzimit të sendit dhe regjistrimi në librat publike të tokës.*

### **Nga arsyetimi**

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, gjykata e shkallës së dytë drejt e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për çka ka dhënë arsye, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Kjo Gjykatë shton se: sipas dispozitës së nenit 20 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore është parashikuar se e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe në bazë të trashëgimisë, prandaj gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë drejt e kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se paditësi nuk mund të jetë pronar i sipërfaqes prej 0.19,36 ha, të ngastrës kadastrale të lartpërmendur në bazë të kontratës mbi shitblerjen dhe në bazë të mbajtjes, se ai me asnjë provë përkatëse nuk e ka vërtetuar të drejtën e pronësisë që është pronar i paluajjtshmërisë kontestuese.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, për të fituar të drejtën e pronësisë në sendin e paluajjtshëm në bazë të punës juridike, sipas nenit 32 të LMTHJP, duhet të plotësohen këto prezumime: që të ekzistojë kontrata juridikisht e vlefshme (iustus titulus), e drejta e pronësisë e paraardhësit, mënyra e dorëzimit të sendit dhe regjistrimi në librat publike të tokës. Ndërkaq, kontrata e shitblerjes së cilës i referohet paditësi nuk është vërtetuar në gjykatë siç është paraparë me Ligjin e

aplikueshëm për qarkullimin e pasurisë së paluajtshme, (neni 4 par. 2), prandaj sipas kësaj dispozite ligjore kontrata nuk mund të shërbejë si bazë juridike e vlefshme në bazë të cilës mund të fitohet e drejta e pronësisë në pasurinë e paluajtshme e cila është objekt shqyrtimi në këtë kontest. I padituri i parë në cilësinë e shitësit sipas kontratës së cekur mbi shitblerjen e pasurisë, me asnjë provë relevante nuk ka provuar faktin se ai ka qenë pronar i pasurisë kontestuese, e nga ky fakt, me të drejtë gjykatat e instancës më të ulët kanë konstatuar se i njëjti nuk ka pasur bazë ligjore për shitjen apo tjetërsimin e parcelës kontestuese, e në këtë mënyrë nuk ka mund të bartë të drejtat te personi tjetër, për të cilat ai vetë nuk i ka poseduar.

*(Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev. nr. 254/2012, Më 12.2.2014)*



*Rev. nr. 160/2014  
datë 15.korrik 2014*

### **Shqetësim në ushtrimin e drejtës së pronësisë - nenit 42 të Ligjit themelor mbi marrëdhëniet juridiko pronësore (Flet. zyrt. RSFJ 6/80)**

*Vendosja e trafos elektrike dhe tokëzimit në ngastrën e paditësit, pa pëlqimin e paditësit si pronar i sendit ,paditësi si pronar është shqetësuar në shfrytëzimin e sendit të tij dhe i njëjti gëzon mbrojtje gjyqësore për shqetësime në pronën e tij.*

### **Nga arsyetimi**

Nga shkresat e lëndës del se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale 71914013-014337-7 Zona rurale, vendi i quajtur "Mareja, në sipërfaqe prej 520 m<sup>2</sup>, certifikata për të drejtat e patundshmërisë UL-71914013-01040 ZK Bërnice të Epërme -Komuna e Prishtinës. E paditura në vitin 2002, ka vendosur trafon dhe tokëzimin, dhe se paditësi në këtë ngastër ka ndërtesën në të cilën në katin e parë ushtron veprimtari të biznesit

“A. B., ndërsa sipërfaqen në kat e shfrytëzon për banim. Me ndërtimin e trafos paditësi është shqetësuar në ushtrimin e drejtës së pronësisë, pasi që paditësi nuk mund të zgjeroj biznesin si dhe kjo paraqet rrezik për fëmijët e paditësit. Paditësi pretendon se këtë trafo e ka vendosur e paditura pa pëlqim dhe pa leje e tij. Ndërsa paditura pretendon se trafoja është vendosur në parametrat teknik dhe nuk shqetëson paditësin ,prandaj ka provuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se trafoja është vendosur në ngastrën e cila është pronësi e paditësit dhe me vendosjen e trafos, i njejt trazohet (shqetësohet)në shfrytëzimin e të drejtës së pronësisë dhe se paditura nuk ka dëshmi për të drejtën e shfrytëzimit të pjesës ku është vendosur trafoja.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka aprovuar ankesën e të paditurës duke ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit sit ë pabazuar duke vlerësuar se në kohën kurr është vendosur trafoja, paditësi nuk ka qenë pronar i ngastrës në fjalë.

Gjykata Supreme e Kosovës, tani për tani, nuk mund ta pranojë një qëndrimin të tillë juridik te gjykatës së shkallës së dytë, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, për shkak zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjendja faktike ka mbetur pa u vërtetuar në menyrë të plotë dhe se për këtë arsye nuk ka kushte për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, prandaj u desht që të dyja aktgjykimet të prishen dhe lënda të kthehet Gjykatës së Shkallës së parë në rigjykim.

Në bazë të dispozitës së nenit 42 të Ligjit themelor mbi marrëdhëniet juridiko pronësore (Flet. zyrt. RSFJ 6/80) është përcaktuar në qoftë se personi i tretë pa bazë e trazon pronarin ose pronarin e supozuar në mënyrën tjetër e jo ma marrjen e sendit ,pronari apo pronari i supozuar ,mundet me padi të kërkoj që ky trazim të pushoj. Këtë padi ka autorizim të ngritë vetëm pronari i sendit. Paditësi është pronar i ngastrës me nr P-71914013-01437-7, sipas ,çertifikates së pronësisë UL-71914013-01040 ZK Bërnice e Epërme -Komuna e Prishtinës dhe

se e paditura trafon ka vendosur me dimensione 2.20 m x 3.30 m në pjesën verilindore e parcelës. E paditura nuk ka afruar gjykatës asnjë prove lidhur me ligjshmërin e vendosjes se trafos, ndërsa fakti se ka ekzistuar pëlqimi ish pronarit ka mbetur si fakt e pa vërtetuar nga gjykata e shkallës së pare.

Prandaj gjykata e shkallës së parë duhet të vëretoj faktin se në kohën e vendosjes së trafos në ngastrëne tani në pronësi të paditësit, a ka ekzistuar pëlqimi i pronarit të mëparshëm, nga i cili paditësi ka blerë ngastrën nr. P-71914013-01437-7, sipas çertifikates së pronësisë UL-71914013-01040 ZK Bërnice e Epërme - Komuna e Prishtinës dhe duke marrë në pyetje pronarin e mëparshëm në cilësi të dëshmitarit. Gjykata e shkallës së parë duhet të vërtetoj faktin se vendosja e trafos nga ana e paditurit a përmban burim rreziku, sipas nenit 156 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve për paditësin, e që për këtë duhet të deklarohet eksperti përkatës elektroenergjetikës.

*(Aktvendim Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 160/2014, datë 15 korrik 2014)*



*Rev. nr. 242/2014  
Datë 27.10.2014*

**Llogaritja e afatit për ankesë kundër vendimit përfundimtar për shpronësim dhe caktimit të kompensimit për pasurin e shpronësuar neni nenet 11.7, 36.3 dhe nenit 48 të Ligjit mbi shpronësimin e pronës së paluejtshme.**

*Propozuesi - pronar i paluajtshmërisë së shpronësuar, duhet të njoftohet personalisht me vendimin për pronën e shpronësuar dhe ekziston detyrimi i dorëzimit personal nga ana e organit shpronësues. Me mos dorëzim personal cenohet parimi i administrimit të drejtësisë dhe ai i barazisë së armëve që konsiston në pamundësin të shfrytëzimit të ankesës në mënyrë efektive që është si pasojë mosdorëzimit personal të vendimit për caktimin e lartësisës e kompensimit*

## Nga asyetimi

Nga shkresat e lëndës del se propozuesit kanë paraqitur ankesë në Gjykatës Supreme me datën 10.3.2008, kundër vendimit përfundimtar mbi shpronësimin nr. 9/128 të datës 11.6.2010, me të cilën kundërshtojnë shumën e kompensimit të caktuar .Ankesën kanë paraqitur më 10.8.2010.

Gjykata e shkallës së parë ka hedh si të pasafatshëm ankesën e propozuesve sipas nenin 36.3 të Ligjit mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta zyrtare e RK nr. 03/L-139). Në arsyetimin e këtij aktgjykimi thekson se sipas kësaj dispozite ligjore parashikohet që çdo ankesë paraqitet mbrenda afatit prej tridhjetë (30) ditë kalendarike pas hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar të përcaktuar në paragrafin 7. të nenit 11 të këtij ligji. Nëse ankesa paraqitet pas skadimit të këtij afati atëherë ajo do të hedhet nga gjykata. Duke qenë se, në rastin konkret vendimi përfundimtari shpronësimin është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 26.6.2010, ndërsa ankesa nga propozuesi është paraqitur më 10.8.2010, ndaj edhe konsiderohet se ajo nuk është paraqitur brenda afatit ligjor.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore ka pranuar vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe ka refuzuar ankesën e propozuesve si të pabazuar duke vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe duke pranuar në tërësi arsyetimin e dhënë në aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Me dispozitën e nenit 36 par. 3 të Ligjit mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme të Republikës së Kosovës parashikohet se çdo ankesë kundër vendimit përfundimtar duhet të paraqitet brenda afat prej 30 ditësh. Vendimi përfundimtar hynë në fuqi pas shpalljes sipas nenit 11.7. Ndërsa sipas nenit 48 të Ligjit të theksuar shpallja e tije bëhet në Gazetën zyrtare të R. Kosovës ose me publikim tjetër në të gjitha gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Propozuesit në fakt kontestojnë shumën e kompensimit që duhet t'ju paguhet atyre si pronar i pronës së paluajtshme të shpronësuar

dhe atë në bazë të vendimit përfundimtar. Me dispozitën e nenit 31 par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës garantohet mbrojtja e barabartë e drejtave në procedurë para gjykatave, organit tjetër shtetëror dhe bartësve të kompetencave publike. Ndërkaq, me nenin 32 i Kushtetutës garanton se secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj. Me nenin 54 të Kushtetutës, po ashtu parashikohet se çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore të rast të shkeljes ose të mohimit të ndonjë të drejte me Kushtetutë ose ligj si dhe të drejtat me mjete efektive ligjore, nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Gjykata Supreme vëren se konkludimi juridik i gjykatave të instancave më të ultë se ankesa kundër vendimit përfundimtar është paraqitur pas afatit prej 30 ditësh pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë, është i pabazuar i papranueshëm dhe rrjedhimisht i kundërligjshëm, madje edhe bie ndesh me nenin 6 të Konventës Evropiane.

Kjo pikërisht për arsye, se dorëzimi i vendimit përfundimtar i shpronësimit nëpërmjet Gazetës zyrtare të Kosovës në emër propozuesit, Gjykata Supreme vëren se palët nuk janë trajtuar si duhet dhe në mënyrë të barabartë në këtë procedurë, ndaj dhe është shkelur e drejta në gjykim të drejtë e cila garantohet me nenin 31. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Duke qen se, propozuesit nuk ishin njoftuar personalisht mbi vendimin për caktimin e lartësisë së kompensimit për pronën e shpronësuar dhe në këtë mënyrë me ç' rast është shkelur neni 6.1. të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore që përcakton që çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga gjykata e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, e cila duhet të vendosë për mosmarrëveshjet në lidhje me drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile. Parimi i gjykimit të drejtë, një aspekt nënkupton edhe barazinë e armëve, e cila shprehet në të drejtën e palëve për të pasur njohuri dhe për të komentuar provat e paraqitura apo vërejtjet e parashtruara. Propozuesit nuk kanë mund

të ushtrojnë të drejtat e tyre për gjykim të drejtë pa dhënë mundësi të dorëzohet personalisht vendimi përfundimtar me caktimin e kompensimit për pasurinë e tyre të shpronësuar. Me këtë veprim juridik propozuesve ju është bërë edhe shkelja e nenit 13 të Konventës e cila garanton të drejtën për mjet efektiv lidhur me çështjen e propozuesve që ka të bëjnë me caktimin e lartësisë së kompensimit për pronën e paluajtshme.

Vendimet e kundërshtuara janë marr edhe shkelje thelbësore të neni 216.1 të Ligjit të Procedurës jokontestimore. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se në qoftë se pjesëmarrësit në procedurë të eksproprijimit nuk arrin marrëveshje për kompensimin e pronës së paluajtshme të eksproprijuar (shpronësuar) brenda afatit prej 2 muajsh nga data në të cilën ka marrë formë të prerë aktvendimi për eksproprijimi, organi kompetent administrativ dërgon aktvendimin bashkë me të gjitha shkresat e lëndës dhe provat për pagimin e shumës së kompensimit në gjykatën kompetente në territorin e së cilës gjendet prona e paluajtshme e eksproprijuar me qëllim të caktimit të kompensimit. Në këtë rast konkret, duke qen se nuk është arritur marrëveshja për kompensimi për pronën e eksproprijuar brenda afati të caktuar ligjor atëherë, ky organ është dashur t'ia dërgojë vendimin përfundimtar brenda afatit prej 2 muajsh gjykatës kompetente për caktimin e kompensimit.

Duke u bazuar në një gjendje të tillë të çështjes me pa mëdyshje dhe në mënyrë të sigurt rezulton konkludimi juridik se neni 36.3 të Ligjit i pronës së Paluajtshme jo vetëm që është jopreciz, por në kolizionin me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me këtë dispozitë të Konventës parashikohet që ligji nacional i shpronësimit duhet të jetë i qasshëm dhe preciz dhe se ndërhyrja në drejtat pronësore duhet të jetë e bazuar me ligj si dhe duhet jetë masë e fundit për arritjen e qëllimit të paraparë. Për pos kësaj, një ndër postulatet e protokollit 1 të Konventës është e drejta për gjykim të drejte që në vete përfshin edhe barazinë e armeve. Ky parim shprehet në faktin që secili që është pale ne procedure, duhet të ketë mundësinë e arsyeshme për të paraqitur rastin e vet ne kushte që nuk i vënë atë ne pozite substancialit të pafavorshme përballë kundërshtarit të vet.

Duke qen se, vendimi përfundimtar mbi shpronësimin nr. 9/128 të datës 11.6.2010, me të cilën është kundërshtuar shuma e kompensimit të caktuar është dorëzuar me anë publikimit në Gazetën zyrtare edhe pse është akt individual i cili detyrimisht dorëzohet në formë personale. Madje, ky detyrim i dorëzimit personal është parashikuar sipas të gjitha ligjeve procedurale. Kjo për më tepër ngase qytetarët dhe rrjedhimisht propozuesit nuk kanë akses në gazetën zyrtare madje edhe në shumë gazeta të përditshme. Prandaj, Gjykata Supreme gjen se në këtë rast konkret është cenuar jo vetëm parimi i administrimit të drejtësisë por edhe barazia e armëve që konsiston në pamundësinë e shfrytëzimit të ankesës në mënyrë efektive që është si pasojë e mosdorëzimit personal vendimit të theksuar. Me mosdorëzim personal të vendimit preliminar propozuesit janë vënë në pozitë substancialisht të pafavorshme përballë kundërpropozuesit, i cili vet e administron dhe boton gazetën zyrtare.

Rrjedhimisht mbi të mësipërmen, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i mënjanojë të metat e vërejtura nga kjo gjykatë e revizionit, t'i vërtetojë në mënyrë të sigurt të gjitha faktet relevante që kanë të bëjnë me bazën juridike të vlefshmërisë së vendimit të publikuar të theksuar edhe në raport me dispozitat kushtetuese të Kushtetutës së R. Kosovës si dhe Konventës së cituar Evropiane, dhe pastaj të marr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

*(Aktvendimi Gjykatës Supreme të Kosovës  
Rev. nr. 242/2014 më datë 27.10.2014)*



*Rev. nr. 240/2013*

*Datë 04.02.2014*

**Anulimi i kontratës për shitblerje të paluajjtshmerisë dhe vërtetimit të drejtës së pronësisë - disponimi me pjesën ideale të bashkëpronësisë - neni 12 pika 1 dhe neni 13 pika 1 të Ligjit mbi trashëgimin të Republikës së Kosovës**



*Paditësi mundet të disponoj vetëm me pjesën e tij ideale të bashkëpronësisë që i takon në bazë të trashëgimisë e jo edhe me pjesët e bashkëpronarve të tjerë dhe se me kontratën e shitëblerjes nuk mund të cenoj pjesët e bashkëpronësisë të trashëgimtarve tjerë ligjor, dhe se kontrata për pjesën e bashkëpronësisë të trashëgimtarve tjerë ligjor është nule.*

### **Nga arsytimi**

Në gjendjen faktike të vërtetuar kësisoj, gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të gjitha provave ka gjetur se i padituri i parë D.P. nuk është i vetmi trashëgimtar, dhe as i vetmi pronar i katër ngastrave kontestuese, në mesin e të cilave ndodhen dy ngastrat të cilat i njëjti ia ka shitur të paditurit të dytë, kjo nga se i ndjeri A.K. pas vdekjes nuk ka lënë vetëm nipin këtu të paditurin D., por edhe paditësit tjerë si trashëgimtar ligjor, andaj për këtë arsye, dhe për faktin se paditësit tjerë nuk kanë marrë pjesë në shqyrtimin e trashëgimisë së të ndjerit A.K., gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas kërkesëpadisë së paditësve, të njëjtëve iu ka pranuar të drejtën e pronësisë në bazë të trashëgimit në pjesë ideale, të precizuara më afër në dispozitivin e aktgjykimit të saj, duke anuluar paraprakisht kontratën mbi shitblerjen e dy prej këtyre ngastrave kontestuese, të lidhur në mes të paditurit të parë dhe të dytë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore, për të njëjtat shkaqe dhe arsye të dhëna nga gjykata e shkallës së parë, ka refuzuar ankesat e të paditurve dhe ka vërtetuar aktgjykimin e lartpërmendur të gjykatës së shkallës së parë.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme, ka gjetur se një qëndrim i tillë juridik i gjykatave të shkallës më të ulët lidhur me nulimin e plotë të kontratës lëndore për shitblerje, nuk mund të pranohet si drejtë dhe i ligjshëm, nga se, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, mbi gjendjen e tillë faktike, gabimisht është zbatuar e drejta materiale, kur ato kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësve për nulimin e plotë të kësaj kontrate është e bazuar, kjo nga fakti se, i padituri D.P., pjesën e vet trashëgimore prej 9/63 e cila kishte për ti takuar sikur edhe trashëgimtarëve tjerë ligjor, lirisht ka mundur ta disponoj, dhe

të ia shet kujtdoqoftë, andaj për këtë pjesë kjo kontratë nuk mund të anulohet, dhe për këtë arsye, Gjykata Supreme gjen se është e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve për anulimin e plotë të kësaj kontrate.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev.nr. 240/2013 datë 04.02.2014)*

## VII. E DREJTA ADMINISTRATIVE

PLKA-A. nr. 5/2013

Data: 31.03.2014

### **Shtyerja e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ - neni 22 par 2 dhe neni 22 par. 6 i Ligjit mbi Konfliktet Administrative (LKA)**

*Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.*

*Paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni (neni 22 par. 6 LKA)*

### **Nga arsytimi**

Në bazë të përmbajtjes së parashtresës, me vendimin e goditur të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.298/2013 nga 07.10.2013, ka refuzuar ankesën e të paditurit Zyrës së Rregullatorit për Energji, të paraqitur kundër vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative A.nr. 620/2013 më 25.07.2013, me të cilën është miratuar propozimi i paditësit - Korporatës Energjetike të Kosovës dhe është shtyrë ekzekutimi i vendimit të të paditurit Zyrës së Rregullatorit për Energji V-519-2013 më 23.03.2013, deri në aktgjykim të gjykatës sipas padisë së paditësit.

I padituri parashtrroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor pranë Gjykatës Supreme, duke kundërshtuar ligjshmërinë e aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë A.nr. 298/2013 më 07.10.2013 dhe aktvendimin e Gjykatës

Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr. 620/2013 të 25.07.2013.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur që pohimet e bëra në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, sepse neni 22, paragrafi 2 i Ligjit mbi Konfliktet Administrative përcakton se me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Neni 22, paragrafi 6 i Ligjit mbi Konfliktet Administrative përcakton se paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2. të këtij neni.

Duke pasur parasysh dispozitat e lartpërmendura të Ligjit mbi Konfliktet Administrative, Gjykata Supreme e Kosovës pranon konkluzionet e shkallës së dytë si të ligjshme dhe të drejta kur ajo hodhi poshtë si të pabazuar ankesën e të paditurit. Nisur nga ajo çka u cek më sipër, Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e instancës më të ulët në këtë çështje administrative dhe juridike kanë zbatuar drejtë dispozitat e procedurës administrative, dhe se pohimet në kërkesën e të paditurit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabaza, sepse ato nuk ndikojnë në vërtetim të ndryshëm të gjendjes faktike nga ajo që kanë gjetur gjykatat e instancave më të ulëta. Në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të pranuar nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se e drejta materiale është zbatuar siç duhet dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të paditësit.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
PLKA-A. nr. 5/2013 më 31.03.2014)*



PLKA-ARJ. nr. 33/2014

Data: 29.12.2014

**Fillimi i konfliktit administrativ kunder vendimit të organit administrativ – neni 13 par. 1 dhe 2 dhe neni 34 par. 1 pika 1,4 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)**

*Një kontest administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, (neni 13 par 1 LKA) Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar, (neni 13 par. 2 LKA) Gjykata do të hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankesa, kurse ankesa nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur, (neni 34 neni 1pika 1.4 LKA).*

**Nga arsyetimi**

Në bazë të përmbajtjes së parashtresës, me vendimin e goditur të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AP-AA.nr. 220/2014 më 24.07.2014, refuzohet ankesa e paditësit si e pabazuar, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative A.nr. 1263/2011 të 25.03.2014, me të cilën është refuzuar si e papranueshme ankesa e paditësit e parashtruar kundër vendimit të të pandehurit Drejtorisë për Financa dhe Pronë të Komunes së Prishtinës 010.nr. 46-837 më 26.04.2011.

Paditësi parashtroi pranë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. 220/2014 më 24.07.2014.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur që pohimet e bëra në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabazuara, pasi që dispozita e nenit 13 të LKA parasheh që një kontest administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, dhe se

një kontest administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar. Me dispozitën e nenit 34, paragrafi 1, pika 1.4. Ligji parasheh që gjykata do të hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankesa, kurse ankesa nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur.

Duke pasur parasysh dispozitat e lartpërmendura të Ligjit mbi Konfliktet Administrative, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë kur ajo hodhi poshtë ankesën e paditësit si të pabazë dhe e vërtetoi vendimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës - Departamentit për çështjet administrative A.nr. 1263/2011 më 25.03.2014. Duke u nisur nga ato që u ceken më lartë Gjykata Supreme është e mendimit se nuk janë plotësuar kushtet për fillimin e kontestit administrativ gjyqësor, për shkak se paditësi ka paraqitur një ankesë kundër vendimit 010.nr. 46-837 të 26.04.2011 të të pandehurit, Drejtorisë për Financa dhe Pronë të Komunës së Prishtinës, vendim i cili nuk është një akt përfundimtar administrativ në kuptim të nenit 13 të Ligjit mbi Konfliktet Administrative. Kundër vendimit në fjalë të të pandehurit mund të paraqitet ankesa pranë Agjencisë Kadastrale të Kosovës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Akti final administrativ në këtë rast do të jetë akti administrativ i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, kundër të cilit do të mund të iniciohet kontesti administrativ. Bazuar në atë që u cek më sipër, në situatë të tillë faktike, paditësi ka ngritur një padi për inicimin e kontestit administrativ kundër vendimit të shkallës së parë të organit administrativ kundër të cilit ka vend për ankesë në kontestin administrativ, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejt kur ajo refuzoi si të pabazë ankesën e paditësit.

Gjykata Supreme gjeti se gjykata e shkallës së dytë në këtë çështje administrative dhe juridike ka zbatuar drejtë dispozitat e procedurës administrative, dhe se pohimet në kërkesën e të pandehurit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabaza, sepse ato nuk ndikojnë në vërtetim të ndryshëm të gjendjes faktike nga ajo që ka gjetur gjykata e shkallës së dytë. Po ashtu,

Gjykata Supreme ka vlerësuar se e drejta materiale është zbatuar drejtë nga gjykata e shkallës së dytë dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të paditësit.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
PLKA-A. nr. 33/2014 më 29.12.2014)*



*PLKA-ARJ. nr. 17/2014*

*Data: 30.12.2014*

### **Kontest administrativ lidhur mbi tatimin për pronën e paluajtshme – neni 12.1 dhe neni 12.2 I Rregullores 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme**

*Ministria e Ekonomisë dhe Financave nxjerr udhëzim administrativ i cili duhet të përshkruaj standardet e veçanta për vlerësim, sipas të cilave komuna përcakton çmimin e tregut të pasurive të patundshme. Standardet përfshijnë, mes tjerash, të ardhurat që vijnë nga patundshmëritë, shpenzimet e ndërtimit, lokacioni, madhësia dhe gjendja e kësaj patundshmërie ( neni 12.1 Rregullores nr. 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme).*

*Çdo komunë përcakton vlerën e tregut të pronës nën juridiksionin e saj në përputhje me standardet e përcaktuara të parapara me nenin 12.1. Neni 21.2 i Rregullores nr. 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme.*

### **Nga arsyetimi**

Në bazë të përmbajtjes së parashtresës, me vendimin e goditur të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AP-AA.nr.383/2013 më 14.03.2014, është refuzuar si e pabazë ankesa e paditësit H.M. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për çështje administrative A.nr.498/10 më 17.09.2013, me të cilin është refuzuar si e pabazë kërkesa e paditësit për të anuluar vendimin nr. 04-07-11145/2 më 17.09.2009 të të pandehurit - Drejtorisë për Financa dhe Pronë të Komunës së Prishtinës, në lidhje me tatimin mbi pronë.

I pandehuri Gjykatës Supreme i parashtrroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. nr. 383 / 2013 më 14.03.2014.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se me vendimin nr. 04-07-11145/2 më 17.09.2009 të të pandehurit Drejtorisë për Financa dhe Pronë të Komunës së Prishtinës, dhe sipas ankesës së paditësit, është anuluar fatura për përcaktimin e bazës tatimore në pronë për vitet 2008 dhe 2009. Paditësi kundër vendimit të mësipërm të të pandehurit, me ankesë ka iniciuar kontest administrativ. Me vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështjet administrative, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit me të cilën është kërkuar që të anulohet vendimi i të pandehurit në lidhje me tatimin mbi pronë.

Gjykata e shkallës së dytë ka pranuar plotësisht vlerësimin gjyqësor të gjykatës së shkallës së parë dhe ankesën e paditësit H.M. e ka refuzuar si të pabazë.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur që pohimet e paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabaza, pasi që neni 12.1 i Rregullores nr.2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme parasheh që Ministria e Ekonomisë dhe Financave nxjerr udhëzim administrativ i cili duhet të përshkruaj standardet e veçanta për vlerësim, sipas të cilave komuna përcakton çmimin e tregut të pasurive të patundshme. Standardet përfshijnë, mes tjerash, të ardhurat që vijnë nga patundshmëritë, shpenzimet e ndërimit, lokacioni, madhësia dhe gjendja e kësaj patundshmërie. Neni 12.2 i Rregullores në fjalë parasheh që çdo komunë përcakton vlerën e tregut të pronës nën juridiksionin e saj në përputhje me standardet e përcaktuara të parapara me nenin 12.1. Neni 21.2 i Rregullores nr. 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme parasheh që kërkesa e tatimpaguesit për shqyrtim /ankesa/ duhet të bëhet me shkrim brenda 30 /tridhjetë/ ditësh nga pranimi i faturës së tatimit, me dokumentacionin mbështetës të cilën tatimpaguesi dëshiron ta paraqes. Përmes Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, Departamentit të Tatimit në Pronë të datës 26.09.2007, ndalohet çdo



ndryshim retroaktiv ose përjashtim nga tatimi në pronë, përveç për vitin për cilin paraqitet ankesa.

Gjykata Supreme konsideron se borxhi në emër të tatimit në pronë është përcaktuar nga autoritetet përkatëse komunale, dhe që si bazë për përcaktimin e lartësisë së tatimit në pronë është marrë vlera e vetë pronës. Tatimi në pronë për vitin e ardhshëm, për çdo vit të kaluar është përcaktuar në bazë të gjendjes më 31.12. të vitit paraprak. Tatimpaguesi, ka për detyrë që të informojë autoritetin tatimor për çdo ndryshim të mundshëm në lidhje me pronën e paluajtshme deri më 31.12 të vitit aktual kur edhe ka ndodhur ndryshimi, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për ndryshim të pronarit, ndryshimet fizike apo ndryshime të tjera që do të ndikojnë në ndryshimin e lartësisë së tatimit apo ekzistimin e detyrimit për të paguar tatimin mbi pronën e paluajtshme. Padiësi gjatë periudhës së përmendur prej 2003-2007, nuk e ka informuar autoritetin e autorizuar tatimor për ndonjë ndryshim në lidhje me pronën e paluajtshme që është objekt i përcaktimit të tatimit në pronë.

Duke pasur parasysh dispozitat e lartpërmendura të Ligjit mbi pronën e paluajtshme, kjo gjykatë gjeti që gjykata shkallës së dytë ka vepruar drejtë kur ka refuzuar si të pabazë ankesën e padiësit H.M. të paraqitur kundër aktgjykimit A.nr. 498/10 të datës 17.09.2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për çështjet administrative. Duke u nisur nga ajo çka u cek më sipër, Gjykata Supreme gjeti se gjykata e shkallës së dytë në këtë çështje administrative dhe juridike ka zbatuar drejtë dispozitat e procedurës administrative, Ligjit mbi konfliktet administrative dhe Ligjit për tatimin mbi pronën e paluajtshme, dhe se pohimet në kërkesën e të pandehurit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabaza, sepse ato nuk ndikojnë në vërtetim të ndryshëm të gjendjes faktike nga ajo që ka gjetur gjykata e shkallës së dytë. Po ashtu, Gjykata Supreme ka vlerësuar se e drejta materiale është zbatuar drejtë nga gjykata e shkallës së dytë dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të padiësit.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
PLKA-A. nr. 17/2014 më 30.12.2014)*

PLKA-A. nr. 6/2014

Data: 30.09.2014

**Inicimi i procedurës për konfliktin administrativ në rastet kur organi kompetent administrativ nuk ka nxjerrë aktin administrativ në bazë të kërkesës së palës (kontesti “heshtjës së administratës”) neni 8 dhe neni 26 I Ligjit për Konfliktet Administrative (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 4/77)**

*Kontesti administrativ mund të iniciohet edhe kur autoriteti kompetent rreth kërkesës, përkatësisht ankesës së palës nuk ka marrë një vendim të duhur administrativ, sipas kushteve të parashikuara në këtë Ligj, neni 26 (neni 8 Ligji mbi Kontestet Administrative Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 4/77)*

*Nëse organi administrativ i shkallës së dytë brenda 60 ditësh, ose në afat më të shkurtër të përcaktuar nga dispozita e posaçme, dështon që të miratojë një vendim rreth ankesës së palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, dhe nuk arrin ta bëjë këtë edhe brenda një periudhe tjetër prej shtatë (7) ditësh pas kërkesës së përsëritur, pala mund të iniciojë kontestin administrativ si në rastet kur ankesa është refuzuar (neni 26 Ligji mbi Kontestet Administrative Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 4/77)*

### **Nga arsyetimi**

Paditësi i parashtroi kërkesë Gjykatës Supreme të Kosovës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke kundërshtuar ligjshmërinë e vendimit AA. nr. 228/2013 të datës 10.01.2014 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Gjykata e Apelit në Prishtinë me vendimin e saj të kontestuar AA. nr. 228/2013 të datës 10.01.2014, refuzoi si të pabazuar ankesën e N.P.T.P. “PODRIMJA-1”, të paraqitur kundër aktvendimit A. nr. 263/2009 të vitit 11.07.2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje administrative me të cilin është refuzuar si e vonuar kërkesa e paditësit kundër vendimit K.A. nr. 011/2008 të datës 18.04.2008 të të pandehurit - Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale - Këshillit për Ankesa.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur që kërkesa e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësorë është e bazuar, dhe vendosi që të anuloh vendimin AA. nr. 228/2013 të datës 10.01.2014 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë dhe vendimin A. nr. 263/2009 të vitit 11.07.2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i çështjeve administrative, si dhe të detyrojë Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale - Këshillin e lartë për ankesa, që brenda 60 ditësh të marrë një vendim sipas ankesës së paditësit N.P.T.P. "PODRIMJA-1", e paraqitur kundër vendimit K.A. nr. 011/2008 të datës 18.04.2008 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale - Këshillit për ankesa.

Gjykata Supreme konsideron se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materi ale. Në mënyrë të veçantë, me nenin 8 të Ligjit të atëhershëm në fuqi mbi Kontestet Administrative ("Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 4/77"), i zbatueshëm sipas nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, parashihet që kontesti administrativ mund të iniciohet edhe kur autoriteti kompetent rreth kërkesës, përkatësisht ankesës së palës nuk ka marrë një vendim të duhur administrativ, sipas kushteve të parashikuara në këtë Ligj. Neni 26, paragrafi 1 i Ligjit në fjalë parashikon se nëse organi administrativ i shkallës së dytë brenda 60 ditësh, ose në afat më të shkurtër të përcaktuar nga dispozita e posaçme, dështon që të miratoj një vendim rreth ankesës së palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, dhe nuk arrin ta bëjë këtë edhe brenda një periudhe tjetër prej shtatë (7) ditësh pas kërkesës së përsëritur, pala mund të iniciojë kontestin administrativ si në rastet kur ankesa është refuzuar.

Me interpretim të drejtë të nenit 8 të Ligjit në fjalë, del se nga rregulla e parashikuar në nenin 6 paragrafi 1 të të njëjtit Ligj, që një kontest administrativ mund të iniciohet vetëm kundër një akti administrativ, neni 8 parashikon një përjashtim, duke përcaktuar që kontesti administrativ mund të iniciohet edhe kur organi kompetent administrativ nuk ka nxjerrë aktin administrativ në bazë të kërkesës ose ankesës së palës. Qëllimi i kontestit administrativ është që të sigurojë mbrojtje gjyqësore për të drejtat e palëve, kur këto të drejta janë shkelur nga një akt administrativ, dhe sigurimi i ligjshmërisë realizohet përmes vlerësimit të ligjshmërisë së akteve administrative dhe anulimit të

atyre që gjykata i vlerëson si të paligjshme. Me këtë gjithashtu zbatohet edhe kontrolli gjyqësor rreth punës së autoriteteve kompetente për miratimin e akteve administrative. Kontrolli i tillë nuk do të ishte i plotë, e as mbrojtja gjyqësore e të drejtave të palëve nuk do të ishte mjaft efektive, nëse jashtë ndërhyrjes së gjyqit do të mbeteshin raste të tjera kur organi kompetent administrativ nuk ka nxjerrë vendim mbi kërkesën apo ankesën e një pale, kur “heshtë” në vend se të veprojë dhe të marr vendime. Në nenin 8 të Ligjit vetëm parimisht përcaktohet mundësia e inicimit të kontestit administrativ, kur nuk është miratuar akti administrativ, si një përjashtim nga rregulli që një kontest administrativ zhvillohet vetëm kundër një akti administrativ. Lënda e kontestit administrativ në këtë rast nuk është një akt administrativ, sepse ai nuk ekziston, por kontesti administrativ zhvillohet si pasojë e mosmiratimit të vendimit administrativ dhe me qëllim që të merret ai vendim. Në praktikë, ky kontest zakonisht quhet kontest për shkak të “heshtjes së administratës”. Kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë që të zhvillohet ky lloj kontesti, si dhe procedura gjyqësore dhe vendimi që do të merret rreth këtij kontesti, më në hollësi janë të rregulluara në nenin 26, dhe nenin 42, paragrafi 5 të Ligjit mbi Konfliktet Administrative.

Me interpretim të drejtë të nenit 26, paragrafit 1 të Ligjit në fjalë, del se pala ka të drejtë të iniciojë kontest administrativ, kur sipas ankesës së palës kundër vendimit të organit administrativ të shkallës së parë nuk është nxjerrë vendimi nga organi administrativ i shkallës së dytë, duke përcaktuar që pala mund të iniciojë kontest administrativ si në rastet kur ankesa e saj refuzohet. Kërkesa e paditësit për inicimin e një kontesti administrativ është që gjykata t’i urdhëroj të pandehurit - autoritetit administrativ, që të miratoj aktin administrativ dhe të përcaktoj se në çfarë mënyre do ta miratoj atë (neni 42, paragrafi 5 i LKA). Përpos padisë pala është e obliguar që të ofrojë dëshmi se janë plotësuar kushtet procedurale nga neni 26 i LKA. Domethënë, kur pala të paraqesë padi kundër vendimit të organit administrativ të shkallës së parë, organi administrativ i shkallës së dytë është i detyruar që të vendosë dhe t’i dorëzojë palës një vendim brenda afatit prej 60 ditësh nga data e paraqitjes së ankesës, ose edhe brenda një afati më të shkurtër, në qoftë se një afat i tillë është parashikuar me dispozita

të veçanta në këtë procedurë ligjore. Pasi kjo periudhë të ketë kaluar, ndërsa autoritet administrativ i shkallës së dytë nuk arrin të marrë një vendim rreth ankesës, pala është e detyruar që të përsërisë kërkesën e vetë që të vendoset në bazë të ankesës dhe të pres skadimin e afatit prej shtatë ditësh të ardhshme nga paraqitja e kërkesës së përsëritur. Kur edhe ky afat prej shtatë ditësh të ketë kaluar pa sukses, pala mund të parashtojë padi pranë gjykatës. Pala është e detyruar t'ia bashkangjes padisë dëshmitë përkatëse që ka vepruar në këtë mënyrë (kopjet e parashtrësave dhe datat e paraqitjes së parashtrësave të tilla). Padia kundër "heshtjes së administratës" kurrë nuk është e vonuar, sepse as sipas LKA në nenin 26, ku janë të rregulluara kërkesat procedurale për zhvillimin e këtij lloji të kontestit, e as në ndonjë dispozitë tjetër, nuk është përcaktuar asnjë afat përfundimtar deri kur një palë do të kishte të drejtë për të filluar kontest administrativ si pasojë e mosmiratimit të një akti administrativ. Qëndrimi i praktikës gjyqësore është që të mbetet në vullnetin e palëve nëse dhe kur do të paraqesin një padi në pajtim me nenin 26 të LKA. Megjithatë, padia nuk mund të paraqitet para skadimit të afateve nga neni 26 i LKA (60 ditë përkatësisht edhe 7 ditë tjera) gjatë të cilave autoriteti mund të merr një vendim në bazë të kërkesës apo ankesës. Një padi e tillë do të ishte e parakohshme dhe gjykata do ta refuzonte në bazë të nenit 30, paragrafi 1, pika 1 e LKA.

Neni 42, paragrafi 5 i Ligjit në fuqi mbi Konfliktet Administrative ("Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 4/77"), i zbatueshëm sipas nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, parashikon se kur padia është ngritur në bazë të nenit 26 të këtij Ligji, dhe kur gjykata konstaton se ajo është e bazuar, me aktgjykim do të pranojë dhe përkrah padinë dhe do të përcaktoj se në çfarë mënyre organi kompetent administrativ do të nxjerrë vendimin.

*(Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës  
PLKA-A. nr. 6/2014 më 30.09.2014)*



*PLKA-A. nr. 14/2014*

*Data: 24.07.2014*

**Parimi i detyrueshëm i senacave të drejtpërdrejta dhe publike në kontestet administrative - pozita e palës së interesuar, si një palë në një kontest administrativ dhe e drejta për të apeluar – neni 6, neni 21, neni 38 dhe neni 49 I Ligjit mbi Konfliktin Administrativ (LKA)**

*Në kontestet administrative gjykata vendos në bazë të seancës së drejtpërdrejtë dhe publike (neni 6 LKA)*

*Pozitën e palës në kontestin administrativ e ka, mes tjerëve, edhe personi cilit anulimi i aktit të kontestuar administrativ drejtpërdrejt ose tërthorazi i shkakton dëm ( neni 21 LKA)*

*Në kontesteve administrative gjykata vendos në seancë të hapur publike, përmes diskutimit verbal dhe vlerësimit të fakteve ( neni 38 LKA).*

*Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë (në rastin konkret Gjykata e Apelit) mund të bëhet ankimi në gjykatën kompetente (në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës), brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë (neni 49 LKA).*

### **Nga arsyetimi**

Në bazë të përmbajtjes së parashtresës, aktgjyqimit të kontestuar AA.nr. 210/2013 të datës 14.10.2013 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, është refuzuar ankesa e paditësit SHPK “Ndërtimi” e ngritur kundër vendimit të të pandehurit Këshillit të pavarur për revizion A.nr.31/2008-SHD të datës 28.01 .2010, me të cilin është refuzuar si e pabazë ankesa e paditësit e paraqitur kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Doganor të Kosovës.

Paditësi paraqiti pranë kësaj gjykate kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, duke kontestuar ligjshmërinë e vendimit AA. nr. 210/2013 të datës 14.10.2013 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë.

Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur që kërkesa e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e bazuar. Domethënë, shkresat e lëndës tregojnë se me aktgjykimin e kontestuar AA.nr.210/2013 të datës 14.10.2013 të Gjykatës së Apelit në Prishtinë është refuzuar ankesa e paditësit SHPK “Ndërtimi”, e paraqitur kundër vendimit të të pandehurit - Këshillit të pavarur për revizione A.nr. 31/2008-SHD të datës 28.01.2010, me të cilin është refuzuar si e pabazë ankesa e paditësit.

